



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në :

“Gazetari Investigative”

Universiteti i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Blerina Gjerazi
2. Prof.Asoc.Dr. Ilda Kashami

Shtator/ 2025

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Për Programin e studimit Master Profesional në “Gazetari Investigative” ofruar nga
Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti i Tiranës”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në “Gazetari Investigative”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër Nr. 342, datë 17.09.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Urdhër Nr. 110, datë 04.03.2022, program edhe në gjuhën angleze
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër 181, datë 14.06.2023
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	
8	Cikli i studimit:	I dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
10	Kreditet në total (ECTS):	60
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 7 i kornizës kombëtare
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2022-2023 11PAE/4PAK 2023-2024 11PAE/4PAK 2024-2025 11PAE/4PAK
18	Numri i studentëve:	2022-2023 6 studentë 2022-2023 3 studentë 2022-2023 1 studentë
19	Komente / të tjera:	Njësia kryesore ku ofrohet ky program studimi është Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë.

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Master Profesional në “Gazetari Investigative”, i ofruar nga Departamenti i Komunikimit dhe Gazetarisë pranë Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës, është miratuar me Urdhër Nr. 342, datë 17.09.2021, të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Ky program ka një ngarkesë prej 60 kreditesh ECTS dhe zgjat një vit akademik, duke kombinuar në mënyrë të ekuilibruar përmbajtjen teorike me formimin praktik në fushën e gazetarisë investigative.

Programi adreson nevojën e tregut të punës për profesionistë të specializuar në gazetari me fokus në investigimin, duke kontribuar në fuqizimin e një medie të lirë, transparente dhe etike. Në këtë mënyrë, ai merr një rol të rëndësishëm në mbështetjen e zhvillimeve demokratike dhe në avancimin e interesit publik në shoqërinë shqiptare. Nëpërmjet zhvillimit të aftësive analitike, kritike dhe praktike, studentët përgatiten për të hulumtuar dhe raportuar me përgjegjësi në çështje me interes të lartë publik.

Mësimdhënia zhvillohet në kushte bashkëkohore, duke u mbështetur në infrastrukturë të përmirësuar dhe mjete didaktike moderne, të cilat i shërbejnë procesit formues dhe përvojës së drejtpërdrejtë të studentëve me mjedisin mediatik.

Një ndër vlerat themelore të këtij programi është stafi akademik me profil të lartë profesional dhe shkencor, i cili përfshin pedagogë me përvojë në gazetari, komunikim publik dhe kërkime mediatike. Ky staf siguron cilësi të lartë në procesin mësimor dhe mbështet studentët në zhvillimin e kompetencave të nevojshme për të analizuar, prodhuar dhe transmetuar informacion në mënyrë të pavarur dhe të përgjegjshme.

Programi u ofron të diplomuarve një bazë të qëndrueshme për të hyrë në tregun e punës në median e shkruar dhe audiovizive, institucionet publike dhe organizatat jofitimprurëse, si edhe për të ndjekur cikle të mëtejshme studimi në fushën e shkencave të komunikimit, gazetarisë apo studimeve mediatike, nëse dëshirojnë të thellojnë më tej formimin e tyre akademik dhe profesional.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për programin Master Profesional në “Gazetari Investigative” është zhvilluar në përputhje me kuadrin ligjor dhe metodologjinë e përcaktuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), duke synuar të vlerësojë në mënyrë gjithëpërfshirëse cilësinë dhe përputhshmërinë e këtij programi me standardet kombëtare dhe evropiane të arsimit të lartë. Ky proces kishte si synim të analizonte në mënyrë objektive aspektet themelore të funksionimit të programit, përfshirë cilësinë e përmbajtjes akademike, efektivitetin e metodologjive të mësimdhënies, përmbushjen e rezultateve të të nxëniet, si dhe shkallën në të cilën programi i përgjigjet kërkesave të tregut dhe zhvillimeve aktuale në fushën e gazetarisë investigative.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) analizoi me kujdes dokumentacionin zyrtar të ofruar nga institucioni, duke përfshirë raportin e vetëvlerësimit, programet mësimore, informacionin mbi kapacitetet njerëzore dhe akademike, të dhëna statistikore mbi ecurinë e studentëve dhe përfshirjen e tyre në tregun e punës, si dhe informacion mbi infrastrukturën dhe burimet në dispozicion.

Më datat 7 dhe 8 prill 2025, GVJ zhvilloi një vizitë në ambientet e universitetit, gjatë së cilës u organizuan takime konsultative me drejtuesit institucionalë, personelin akademik, studentët e programit, si dhe përfaqësues të strukturave administrative dhe mbështetëse. Qëllimi i këtyre ndërveprimeve ishte të konfirmohej në praktikë koherenca ndërmjet dokumentacionit të paraqitur dhe realitetit institucional, duke u mbështetur edhe në të dhënat e sistemit AMS të ASCAL.

Gjatë vlerësimit, u evidentua një klimë bashkëpunuese dhe e hapur, ku aktorët institucionalë treguan vullnet për dialog dhe reflektim mbi pikat e forta dhe mundësitë për përmirësim të mëtejshëm. Vlerësimi u konsiderua si një mundësi e vlefshme për rishikim strategjik dhe për të rritur më tej standardet e cilësisë në këtë program, në përputhje me praktikatat më të mira ndërkombëtare.

Procesi u orientua nga disa parime themelore:

- Objektiviteti, nëpërmjet vlerësimeve të bazuara në të dhëna të verifikuara;
- Bashkëpunimi, i ndërtuar mbi frymën e dialogut konstruktiv me institucionin pritës;
- Konfidencialiteti, në trajtimin me përgjegjësi të çdo informacioni të siguruar;
- Analiza e plotë dhe gjithëpërfshirëse, e cila mori parasysh të gjitha dimensionet e funksionimit të programit;
- Respektimi i standardeve kombëtare dhe evropiane, për të garantuar cilësi dhe konkurrueshmëri në hapësirën e arsimit të lartë.

MEMO

Drejtuar: AGJENCISË SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË (ASCAL)
Adresa: Rruga e Durrësit Nr. 219, Tiranë

Nga: Grupi i Vlerësimit të Jashtëm
Dr. Blerina Gjerazi
Prof. As. Dr. Ilda Kashami



Lënda: Përcjellja e komenteve përfundimtare mbi Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin Master Profesional “Gazetari Investigative”, ofruar nga Universiteti i Tiranës, Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit

Datë: 29.08.2025

Të Nderuar,

Referuar shkresës Nr. 2220/1 datë 16.07.2025 të Universitetit të Tiranës në të cilën përcillen komentet mbi draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin Master Profesional “Gazetari Investigative”, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm paraqet si më poshtë vlerësimet përfundimtare:

Standardi II.7- Kriteri 4: Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.

Vërejtja e institucionit mbi rëndësinë e përgatitjes cilësore të studentëve është e vlefshme pasi objektivi kryesor i programit lidhet me formimin profesional të tyre dhe aftësinë për të qenë konkurrues në tregun e punës. Megjithatë, për një vlerësim të plotë dhe të balancuar të ndikimit të programit, është e nevojshme që cilësia të shoqërohet edhe me tregues sasiore mbi përfundimin e studimeve dhe progresin akademik. Këta tregues nuk synojnë të minimizojnë cilësinë e përgatitjes, por shërbejnë si indikatorë të rëndësishëm për të matur nëse potenciali i programit po përkthehet në rezultate konkrete.

Një kombinim i të dyja qasjeve si cilësore ashtu edhe sasiore do të ndihmonte jo vetëm në evidentimin e arritjeve të programit, por edhe në identifikimin e hapësirave për përmirësim në drejtim të mbështetjes akademike dhe rritjes së përqindjes së diplomimit.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **pranon komentet e institucionit** dhe tërheq vëmendjen për stimulimin dhe motivimin e studentëve për përfundimin e studimeve, duke pasur parasysh edhe domosdoshmërinë që ka në jetën publike përgatitja e profesionistëve në fushën e gazetarisë investigative.



Standardi III.1- Kriteri 6: Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.

Sqarimi i institucionit se instrumentet e aplikuara nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) vlejnë në mënyrë të njëjtë për të gjitha programet e studimit, si dhe angazhimi i tij që në të ardhmen procesi i sigurimit të cilësisë për programin e studimit Master Profesional në Gazetari Investigative të dokumentohet në mënyrë më të diferencuar në ciklet e ardhshme të vlerësimit, tregojnë përkushtimin institucional për të rritur transparencën, përmirësuar standardet e brendshme të monitorimit dhe siguruar një përafrim më të madh me praktikën më të mira të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë.

Si përfundim, komenti i institucionit **merret në konsideratë dhe pranohet**, por Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nënvizon se NJSBC duhet të shtrihet përtej funksionit raportues, duke u angazhuar në mënyrë më aktive në monitorimin e zbatimit të rekomandimeve, si dhe nxitjen dhe koordinimin e aktiviteteve për zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies. Një angazhim i tillë do të siguronte që roli i NJSBC-së të jetë më i dukshëm, efektiv dhe i matshëm në përmirësimin e proceseve akademike dhe të cilësisë së përgjithshme institucionale.

Standardi IV.3- Kriteri 4: Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.

Institucioni ka sqaruar se, duke qenë se gazetaria investigative është një fushë në zhvillim të vazhdueshëm, pjesa më e madhe e botimeve relevante ofrohet nga organizata të ndryshme dhe nuk mund të përkthehen menjëherë për t'u integruar në fondin e bibliotekës.

Grupi i vlerësimit të jashtëm, edhe në draft-raportin fillestar, ka konkluduar se standardi është realizuar plotësisht. Në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm, është sugjeruar forcimi i mekanizmave të bashkëpunimit ndërmjet departamentit dhe bibliotekës, me qëllim që procesi i përzgjedhjes së literaturës të bëhet më efektiv dhe në përputhje me nevojat akademike.

Standardi VI.2 Kriteri 1: Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.

Institucioni ka paraqitur sqarime lidhur me funksionimin e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), duke theksuar se kjo njësi ka aplikuar instrumentet standarde të monitorimit për të gjithë programet e studimit, përfshirë edhe programin Master Profesional në "Gazetari Investigative". Sipas UT-së, të dhënat e grumbulluara nga NJSBC janë përdorur nga Departamenti

i Gazetarisë dhe Komunikimit për analiza të hollësishme mbi strukturën mësimore, përmbajtjen e moduleve, përvojën e studentëve dhe sfidat që lidhen me regjistrimet dhe diplomimet. Këto analiza janë konsideruar si bazë për vendimmarrje dhe ndërhyrje në funksion të përmirësimit të cilësisë.

Grupi i vlerësimit të jashtëm vlerëson pozitivisht këtë sqarim, i cili tregon ekzistencën e një bashkëpunimi ndërmjet NJSBC dhe departamentit.

Në përfundim, komenti i institucionit **pranohet**.

Standardi VI.3 - Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ka marrë në konsideratë përgjigjen e institucionit, ku argumentohet se janë zhvilluar analiza periodike të programit MP në "Gazetari Investigative" dhe ato pasqyrohen në raportet e vlerësimit të brendshëm për periudhën 2021–2024. Institucioni thekson identifikimin e faktorëve që kanë ndikuar në regjistrimet e ulëta dhe mosdiplomimet, si pengesat institucionale dhe specifikat e tregut të gazetarisë investigative, si dhe ndërmarrjen e masave konkrete për përmirësim (përditësim modulesh, rritje fleksibiliteti për gazetarët aktivë, strategji promovimi).

GVJ vlerëson pozitivisht sqarimin dhe angazhimin e institucionit për reflektim dhe përmirësim të programit. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se përgjigjja nuk duhet të mbetet thjesht përshkruese. Në përgjigjen e institucionit për Standardin VI.3 – Kriteri 1 përmendet se dokumentacioni ndodhet në dosjen e aplikimit. Grupi ka shqyrtuar të gjithë dokumentacionin e paraqitur në sistemin AMS dhe konstatoi se nuk paraqitet një evidencë e qartë që të tregojë analizën, raportimin dhe planin e masave që NJSBC-ja ka rekomanduar dhe koordinuar me mekanizmat përkatës të funksionimit të njësisë për këtë program studimi, duke marrë në konsideratë situatën në të cilën ndodhet. Kjo është thelbësore për të evidentuar në mënyrë analitike realizimin e procesit të sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional.

Është e rëndësishme të theksohet se zbatimi i këtij kriteri nuk duhet të kufizohet vetëm te konstatimi i faktorëve që mund të kenë ndikuar në performancën e programit, por duhet të evidentojë qartë rolin aktiv të NJSBC-së si rekomandues, planifikues dhe ndërmjetësues për adresimin e sfidave dhe krizave, në bashkëpunim me departamentin përkatës. Referimi i përgjithshëm tek dokumentet mbetet teknik dhe nuk zëvendëson nevojën për evidencë të matshme dhe të detajuar mbi ndikimin konkret të masave të ndërmarra dhe punën e NJSBC-së.

Në përfundim, edhe pse komenti i institucionit vlerësohet, qëndrimi i GVJ-së mbetet i pandryshuar: **standardi vlerësohet si i përmbushur kryesisht**, pasi duhet evidentohet nevoja për dokumentim më të plotë dhe analitik të evidencave që tregojnë ndikimin real të proceseve të vlerësimit në përmirësimin e rezultateve të programit. Argumentimi i UT-së mbështetet kryesisht te masat e departamentit, ndërsa kërkesa e kriterit ka të bëjë me funksionimin dhe ndërhyrjet e NJSBC-së si strukturë përgjegjëse institucionale për sigurimin e cilësisë.

Standardi VI.3 - Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ka marrë në konsideratë përgjigjen e institucionit, ku Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit ka realizuar një analizë të detajuar për zhvillimin e programit Master Profesional në Gazetari Investigative. Analiza identifikon faktorët që kanë ndikuar në rezultatet e paplota të diplomimeve, përfshirë natyrën profesionale të studentëve, mungesën e mundësive të praktikës institucionale dhe stimulimeve të jashtme për përfundimin e studimeve. GVJ vlerëson pozitivisht këtë qasje, duke evidentuar që mekanizmat e dokumentuar për shqyrtimin dhe mbikëqyrjen e programit janë funksionale dhe orientuar drejt përmirësimit të vazhdueshëm.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson angazhimin e Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit në zhvillimin e analizave dhe masave për përmirësimin e programit. Megjithatë, theksohet se kontributi i NJSBC-së, veçanërisht në nivel fakulteti, duhet të jetë më i qartë, konkret dhe i matshëm për përmirësimin e programit të studimit dhe për garantimin e mbarëvajtjes akademike.

Për këtë arsye, edhe pse komenti i institucionit merret parasysh dhe vlerësohet si sqarim i dobishëm, ai nuk pranohet plotësisht. Qëndrimi i GVJ-së mbetet i pandryshuar: **standardi vlerësohet si i përmbushur kryesisht**, duke nënvizuar nevojën për dokumentim më të qartë, të matshëm dhe të dallueshëm të rolit dhe ndikimit të NJSBC-së në nivel programi. Mbetet e nevojshme që raportet/analizat e NJSBC-së të jenë të individualizuara veçanërisht për programet strategjike dhe me ndikim të madh social, si Gazetaria Investigative. Në thelb të këtij programi qëndron përkushtimi ndaj vlerave të gazetarisë etike, së vërtetës dhe shërbimit publik, të cilat janë themelore për funksionimin e një demokracie të shëndetshme dhe për mbrojtjen e interesit publik. Aktualisht, ky program studimi nuk duket se tërheq studentët në numër të mjaftueshëm, gjë që nënvizon nevojën për një qasje më të targetuar dhe përmirësuese të adresimit të mangësive dhe planin e masave konkrete nga NJSBC-ja në nivel fakulteti së pari, por edhe në nivel universiteti.

Standardi VI.5 - Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.

Përgjigja e institucionit merret parasysh dhe kriteri vlerësohet si i përmbushur plotësisht. Analiza e detajuar e Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit dhe plani i masave për përmirësim tregojnë qartë angazhimin institucional për të adresuar dobësitë dhe për të rritur cilësinë e programit.

Bazuar në sa më sipër:

Më poshtë paraqiten përfundimet e vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Gazetari Investigative” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universitetit i Tiranës”.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Gazetari Investigative”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit Master Profesional në “Gazetari Investigative”, i ofruar nga Departamenti i Komunikimit dhe Gazetarisë në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës, është konceptuar dhe zhvilluar në përputhje të plotë me interesat kombëtare dhe me misionin e arsimit të lartë për të ruajtur dhe konsoliduar vlerat akademike dhe kulturore të shoqërisë shqiptare. Ky program synon të përgatisë profesionistë të fushës së medias që ushtrojnë rolin e tyre si faktorë thelbësorë në garantimin e transparencës, llogaridhënies publike dhe ndërtimit të një diskursi kritik e të informuar në shoqëri. Në thelb të këtij programi qëndron përkushtimi ndaj vlerave të gazetarisë etike, së vërtetës dhe shërbimit publik, parime që janë thelbësore për funksionimin e një demokracie të shëndetshme dhe për mbrojtjen e interesit publik. Programi i Masterit Profesional në Gazetari Investigative është në përputhje me standardet akademike dhe ligjore të arsimit të lartë shqiptar, si dhe ofron një kontribut konkret dhe të matshëm në jetën publike, duke nxitur një gazetari përgjegjëse, të angazhuar dhe në shërbim të qytetarëve dhe demokracisë. <i>E.1.1. Statuti i UT-së</i> <i>E.1.2. Strategjia e zhvillimit të UT-së (2023-2028)</i> <i>E.1.3. Rregullore e UT-së</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Master Profesional në “Gazetari Investigative” është hartuar dhe zbatuar në përputhje të plotë me misionin institucional dhe objektivat strategjike të universitetit si qendër e arsimit të lartë, kërkimit shkencor dhe formimit profesional cilësor. Misioni i Universitetit të Tiranës përfshin promovimin e dijeve, zhvillimin e mendimit kritik, përgatitjen e kuadrove të kualifikuar në funksion të nevojave të shoqërisë dhe forcimin e kapaciteteve demokratike në vend. Në këtë kuadër, programi në “Gazetari Investigative” përfaqëson një zhvillim të rëndësishëm brenda fushës së komunikimit dhe gazetarisë, duke synuar formimin e specialistëve të aftë për të kryer investigim mediatik me standarde profesionale dhe etike të larta. Struktura, përmbajtja dhe rezultatet e të nxënit të këtij programi janë tërësisht të harmonizuara me profilin akademik të institucionit,

	duke reflektuar fushat prioritare të kërkimit dhe formimit profesional që Universiteti i Tiranës mbështet dhe zhvillon. Gjithashtu, programi përputhet me objektivin e institucionit për të kontribuar në zhvillimin e një media të lirë, të përgjegjshme dhe në funksion të interesit publik, si pjesë e angazhimit të tij për shoqërinë demokratike dhe informimin e bazuar në fakte. Përmes këtij programi, Universiteti i Tiranës demonstroi aftësinë për të ofruar formim të specializuar në një fushë me rëndësi të veçantë shoqërore, duke ndërlidhur qëllimet e tij akademike dhe kërkimore me nevojat aktuale të tregut të punës dhe zhvillimet bashkëkohore të sistemit mediatik. <i>E.1.1. Statuti i UT-së</i> <i>E.1.2. Strategjia e zhvillimit të UT-së (2023-2028)</i> <i>E.1.2.1. Plani i Kërkimit Shkencor të UT-së (2018-2022)</i> <i>E.1.3. Rregullore e UT-së</i> <i>E.1.4. Plani i Zhvillimit të Departamentit të Gazetarisë 2024-2029</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimeve akademike të Institucionit.	Programi i studimit Master Profesional në “Gazetari Investigative” është hartuar në përputhje të plotë me dokumentet themelore që rregullojnë veprimtarinë e institucionit, përkatësisht me Strategjinë e Zhvillimit, Statutin dhe Rregulloren e Universitetit. Në përmbajtjen dhe drejtimin e tij, ky program reflekton qartë prioritetet strategjike të Universitetit të Tiranës për të nxitur cilësinë akademike, inovacionin në mësimdhënie, integritimin e kërkimit shkencor në procesin arsimor dhe forcimin e lidhjeve me tregun e punës dhe shoqërinë. Programi përmbush objektivin institucional për të ofruar studime të avancuara në fushat me impakt të drejtpërdrejtë në zhvillimin demokratik dhe konsolidimin e institucioneve të një shteti ligjor, në përputhje me misionin e universitetit si institucion publik arsimor dhe kërkimor. Përmes këtij programi, Universiteti i Tiranës forcon kapacitetet e veta akademike në fushën e shkencave sociale dhe humane, në përputhje me profilin e tij akademik dhe drejtimet ekzistuese të studimit. Hartimi i programit është bërë në zbatim të rregullave institucionale, përmes proceseve të miratimit akademik që përfshijnë departamentin, fakultetin dhe senatin akademik, duke garantuar standarde të larta cilësie dhe përputhshmëri me kuadrin ligjor dhe institucional. Programi, si pjesë e strukturës së ofrimit të ciklit të dytë të studimeve, kontribuon në realizimin e vizionit të universitetit për të formuar profesionistë të aftë, të angazhuar dhe etikë, në një fushë me rëndësi të veçantë publike siç është gazetaria investigative. <i>E.1.1. Statuti i UT-së</i> <i>E.1.2. Strategjia e zhvillimit të UT-së (2023-2028)</i> <i>E.1.3. Rregullore e UT-së</i>

	E.1.4. Plani i Zhvillimit të Departamentit të Gazetarisë 2024-2029			
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prioritetet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	Programi i studimit është hartuar dhe zhvillohet në përputhje me objektivat kombëtare për përmirësimin e cilësisë në arsimin e lartë, si dhe në përputhje me dokumentet orientuese strategjike në nivel institucional dhe kombëtar. Në veçanti, ai reflekton objektivat e përcaktuara në Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit të Tiranës 2023-2028, që thekson nevojën për përshtatjen e programeve të studimit me kërkesat e tregut të punës, ndërkombëtarizimin e kurrikulave, nxitjen e mendimit kritik dhe zhvillimin e kompetencave profesionale. Hartimi dhe përmirësimi i programit është mbështetur gjithashtu në zhvillimet aktuale në fushën e arsimit dhe në dokumentacionin përkatës vendas dhe ndërkombëtar, duke siguruar një qasje të balancuar mes kërkesave lokale dhe trendeve globale në arsimin e lartë.			
Konkluzione	1.3. Strategjia e Zhvillimit të UT (2018-2023, 2023-2028) <i>Institucioni i arsimit të lartë ofron këtë program studimi në përputhje me misionin, qëllimet strategjike dhe vlerat kombëtare që ai promovon. Përputhshmëria e programeve me strategjinë e zhvillimit institucional, statutin dhe aktet normative garanton koherencë institucionale dhe sigurimin e një kornize të qëndrueshme për zhvillimin akademik dhe profesional të studentëve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson se standardi është realizuar plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2 Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, ka kapacitetet akademike, përvojën dhe burimet e nevojshme për ofrimin cilësor të programit të studimit Master Profesional në “Gazetari Investigative”. Stafi akademik i angazhuar në këtë program përbëhet nga 14 staf akademik efektiv (PAE) dhe 3 staf akademik m kontratë (PAK), të cilët janë ekspertë të mirënjohur në fushën e gazetarisë, komunikimit dhe medias. Shumë prej tyre janë profesionistë aktivë në media kombëtare dhe ndërkombëtare, me përvojë të drejtpërdrejtë në gazetarinë investigative dhe çështjet e interesit publik, i cili garanton një ndërthurje të dobishme midis përvojës praktike dhe qasjes akademike.

	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit disponon një staf efektiv prej 17 anëtarësh me përgatitje të lartë shkencore dhe akademike: 2 prej tyre mbajnë titullin “Profesor”, 7 kanë titullin “Profesor i Asociuar”, 6 zotërojnë gradën “Doktor i Shkencave” dhe 2 janë asistentë lektorë me nivel “Master i Shkencave”. Kjo përbërje reflekton një bazë solide pedagogjike dhe shkencore që mbështet zhvillimin e një programi të avancuar dhe të specializuar siç është gazetaria investigative. Për më tepër, programi mbështetet nga një infrastrukturë didaktike dhe teknologjike bashkëkohore, e cila përfshin mjete audiovizive, laboratorë media, qasje në burime elektronike dhe ambiente studimi që favorizojnë përvetësimin e njohurive teorike dhe zhvillimin e aftësive praktike. <i>E.1.4. Plani i Zhvillimit të Departamentit të Gazetarisë 2024-2029</i> <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit “MP ne Gazetari Investigative”</i> <i>E.2.2. CV e stafit akademik me kohë të plotë të angazhuar në programin e studimit</i> <i>E.2.2.a. Lista e PAE dhe personeli i angazhuar ne program</i> <i>E.2.2.b. Lista dhe CV e stafit akademik me kohë të pjeshme të angazhuar në MPGI</i> <i>E.4.5. Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fusha e përgjithshme dhe ajo specifike e programit të studimit Master Profesional në “Gazetari Investigative” është plotësisht në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore përgjegjëse për këtë program, që është Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë pranë Universitetit të Tiranës. Ky fakultet mbulon në mënyrë të plotë fushat e shkencave humane, përfshirë gazetarinë dhe komunikimin, në përputhje me klasifikimin/kodifikimin e programeve të studimit sipas Rregullores së Klasifikimit të Programeve të Studimit dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane (siç përcaktohen në vendimet e Këshillit të Ministrave dhe udhëzimet e MASR). Për më tepër, programi mbështetet në ekspertizën akademike dhe kërkimore të Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit, si një njësi themelore brenda Fakultetit, e cila ka një traditë të konsoliduar në fushën e gazetarisë, si dhe në zhvillimin e studimeve teorike dhe praktike në këtë fushë. <i>E.5.2. Udhërrëfyesi i programeve të studimit FHF</i> <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit “MP ne Gazetari Investigative”</i>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga	Programi i studimit Master Profesional në “Gazetari Investigative” është konceptuar dhe ofrohet në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë përgjegjëse, që është Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës. Ky departament ka

njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	një profil të konsoliduar akademik dhe kërkimor në fushën e shkencave të komunikimit dhe medias, të cilat janë në përputhje të drejtpërdrejtë me fushën specifike të programit të ofruar. Fusha tematike e programit, gazetaria investigative, është një degë e avancuar dhe e specializuar brenda disiplinës së gazetarisë dhe komunikimit masiv dhe përputhet me klasifikimin zyrtar të programeve të studimit sipas direktivave kombëtare dhe atyre evropiane të arsimit të lartë. Në aspektin institucional, programi mbështetet në traditën akademike dhe kapacitetet kërkimore të Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit, i cili prej dekadash është njësi kryesore që ofron formim universitar dhe pasuniversitar në këtë fushë. Në këtë mënyrë, programi jo vetëm që është në përputhje me profilin akademik të njësisë bazë, por përforcon edhe më tej identitetin kërkimor dhe zhvillimin profesional të saj, duke reflektuar koherencë ndërmjet objektivave të programit, ekspertizës së disponueshme dhe standardeve akademike kombëtare e ndërkombëtare. <i>E.1.1. Statuti i UT-së</i> <i>E.1.2. Strategjia e zhvillimit të UT-së (2023-2028)</i> <i>E.1.2.1. Plani i Kërkimit Shkencor të UT-së (2018-2022)</i> <i>E.1.3. Rregullore e UT-së</i> <i>E.1.4. Plani i Zhvillimit të Departamentit të Gazetarisë 2024-2029</i> <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP ne Gazetari Investigative"</i>
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program "Master profesional" në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Programi Master Profesional në "Gazetari Investigative" zhvillohet brenda profilit akademik të Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit, i cili zotëron kapacitetet e nevojshme njerëzore dhe akademike për mbulimin e plotë të këtij drejtimi të specializuar. Bashkëpunimet me institucione partnere kombëtare dhe ndërkombëtare shërbejnë si vlerë e shtuar, por cilësia dhe realizimi bazë i programit garantohet nga vetë departamenti. <i>E.2.6. Propozim për hapjen e programit të studimit MPGI</i>
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, si njësi bazë përgjegjëse për ofrimin e programit Master Profesional në "Gazetari Investigative" ka krijuar një rrjet të gjerë bashkëpunimesh me institucione mediatike, organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe projekte që mbështesin zhvillimin profesional të diplomuarve. Përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe projekteve të përbashkëta me institucione si BIRN, si dhe aktorë ndërkombëtarë si USAID, Ambasada Britanike dhe rrjete akademike partnere si De Montfort University në Mbretërinë e Bashkuar. Departamenti ofron trajnime, seminare dhe aktivitete praktike pas diplomimit, të cilat synojnë fuqizimin e kompetencave profesionale dhe rritjen e mundësive për punësim. Këto iniciativa janë të mirëstrukturuar

	dhe të lidhura ngushtë me nevojat aktuale të tregut të punës në fushën e gazetarisë dhe komunikimit.			
	<i>E.1.9. Marrëveshjet e bashkëpunimit</i> <i>E.2.6. Propozim për hapjen e programit të studimit MPGI</i> <i>E.3.6. Projektet shkencore të departamentit</i>			
Konkluzione	Programi i studimit është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë kryesore përgjegjëse, duke respektuar klasifikimin dhe kodifikimin sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare dhe evropiane. Kjo garanton integritetin akademik dhe përshtatshmërinë e programit me kërkesat e fushës përkatëse, duke lehtësuar kështu zhvillimin e mëtijshëm profesional dhe hulumtues.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Institucioni ka krijuar një sistem efektiv bashkëpunimi ndërmjet njësive akademike dhe personelit për realizimin, mbikëqyrjen dhe funksionimin e programit. Ndarja e qartë e detyrave dhe përgjegjësisë siguron koordinim të mirëorganizuar dhe një proces të vazhdueshëm monitorimi dhe përmirësimi të cilësisë së mësimdhënies dhe përmbajtjes së programit. Një faktor kyç në realizimin e këtij kriteri është përbërja e stafit akademik, i cili përbëhet nga pedagogë me kualifikime të larta akademike dhe përvojë të konsiderueshme praktike në fushën e gazetarisë, medias dhe komunikimit. Stafi i kualifikuar siguron jo vetëm nivelin e lartë akademik të programit, por edhe përshtatjen e tij me kërkesat reale të tregut të punës, e cila konfirmohet edhe nga studimi i tregut të punës (E 1.12), ku rezulton se 75% e të diplomuarve janë të punësuar dhe aktivë në media, duke luajtur role të rëndësishme në media dhe opinionin publik. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP në Gazetari Investigative"</i> <i>E.2.2. CV e stafit akademik me kohë të plotë të angazhuar në programin e studimit</i> <i>E.2.2.a. Lista e P.1E dhe personeli i angazhuar në program</i> <i>E.2.2.b. Lista dhe CV e stafit akademik me kohë të pjeshme të angazhuar në MPGI</i> <i>E.1.12. Studimi i tregut - Media in fokus</i>

Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Institucioni ka krijuar dhe zhvilluar marrëdhënie të qëndrueshme dhe strategjike bashkëpunimi me një gamë të gjerë partnerësh homologë, aktorë të biznesit, dhe organizata ndërkombëtare, të cilat përkrahin realizimin e objektivave mësimore dhe formuese të studentëve. Për periudhën 2015-2023 janë nënshkruar 15 marrëveshje bashkëpunimi që përfshijnë partnerë të rëndësishëm si Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), me të cilin ekziston një marrëdhënie e konsoliduar dhe funksionale. Në nivel ndërkombëtar, bashkëpunimet me institucione si Universiteti i Bolonjës, konkretisht për projektin "Fake Spotting" i financuar nga Bashkimi Evropian, kontribuojnë në avancimin e njohurive dhe praktikave të studentëve në fushën e gazetarisë investigative. Për më tepër, partneritetet me organizata si USAID dhe Bashkimi Evropian, në kuadër të projekteve "Media in Focus: Gazetari në Shqipëri" i vitit 2020, theksojnë angazhimin e institucionit për të ofruar mundësi praktike dhe trajnime të specializuara që pasqyrojnë nevojat reale të tregut dhe sfidat aktuale të medias. Këto marrëdhënie bashkëpunimi jo vetëm që zgjerojnë horizontet akademike dhe praktike të studentëve, por edhe forcojnë lidhjen midis arsimit të lartë dhe sektorit profesional, duke garantuar një përgatitje të qëndrueshme dhe cilësore për profesionistët e ardhshëm të gazetarisë investigative. Duke marrë në konsideratë dinamikën e shpejtë të zhvillimeve në fushën e gazetarisë investigative dhe rëndësinë e patjetërsueshme demokratike dhe shoqërore të këtij programi studimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm sugjeron rritjen e mëtejshme të partneriteteve ndërkombëtare në vitet në vijim, me qëllim thellimin e dimensionit global të programit dhe fuqizimin e kompetencave ndërkulturore e profesionale të studentëve. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP në Gazetari Investigative"</i> <i>E.1.9. Marrëveshjet e bashkëpunimit</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Për zbatimin cilësor të programit të studimit Master Profesional në "Gazetari Investigative", institucioni ka parashikuar dhe strukturuar zhvillimin e praktikave profesionale në përputhje me kërkesat akademike dhe objektivat formues të programit. Sipas rregullores së studimeve, komponenti praktik është pjesë integrale e formimit profesional të studentëve dhe realizohet në mënyrë të planifikuar dhe të monitoruar. Në Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit, studentët zhvillojnë gjatë javës 8 lëndë teorike nga e hëna në të enjte, ndërsa dita e premte i është dedikuar plotësisht praktikës profesionale në laboratorët modernë të gazetarisë brenda departamentit. Këto laboratorë janë të pajisur me teknologji bashkëkohore që

	mbështesin procesin e prodhimit mediatik në format audio, video dhe digjital. Produksionet e realizuara gjatë kësaj praktike vlerësohen nga stafi akademik dhe më pas publikohen në platformën zyrtare www.reportiinvestigativ.al, duke i dhënë studentëve mundësinë të kenë një portofol profesional të dokumentuar publikisht. Kjo formë e integruar e praktikës jo vetëm që nxit angazhimin aktiv të studentëve në procesin e të mësuarit përmes veprimit, por gjithashtu shërben si urë lidhëse me tregun real të punës. Në këtë kontekst, institucioni ka nënshkruar gjithashtu marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe organizata të fushës së medias, të cilat mbështesin zhvillimin e mëtejshëm të praktikës profesionale dhe lehtësojnë integrimin e studentëve në mjedise pune reale. Për mobilitetin akademik, stafi përfiton nga programet Erasmus+ dhe marrëveshje të tjera, ndërsa për shkak të natyrës njëvjecare dhe zhvillimit në gjuhën shqipe të programit, mobiliteti i studentëve nuk është i mundur në kuptimin klasik, por ata përfshihen aktivisht në projekte bashkëpunimi që zhvillon njësia bazë. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP ne Gazetari Investigative"</i> <i>E.1.9. Marrëveshjet e bashkëpunimit</i> <i>E.3.7. Pedagogë pjesëmarrës në Erasmus</i>
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Njësia përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në "Gazetari Investigative", në përputhje me standardet institucionale dhe kërkesat për sigurimin e cilësisë, harton në mënyrë periodike raporte analitike mbi përfitimet konkrete që rrjedhin nga marrëveshjet e bashkëpunimit. Këto raporte synojnë të evidentojnë ndikimin e drejtpërdrejtë të bashkëpunimeve në funksion të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, rritjes së mundësive për praktika profesionale, dhe përfshirjes së studentëve në projekte aplikative dhe kërkimore. Përmes analizës së të dhënave dhe feedback-ut të marrë nga partnerët institucionalë dhe studentët, Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit identifikon fushat e përmirësimit dhe përcakton mënyrat më efektive për të shfrytëzuar këto marrëveshje në funksion të objektivave të programit. Këto raporte përbëjnë një instrument të rëndësishëm për reflektim dhe planifikim strategjik, duke kontribuar në forcimin e lidhjes ndërmjet formimit akademik dhe praktikës profesionale në fushën e gazetarisë investigative. Hartimi i këtyre raporteve pasqyrohet edhe në dokumentacionin institucional dhe shërben si bazë për përditësimin e bashkëpunimeve ekzistuese apo për iniciativën për krijimin e partneriteteve të reja që i përgjigjen dinamikës së tregut të medias dhe sfidave të gazetarisë bashkëkohore. <i>E.1.7. Raport i analizës vjetore të Departamentit</i>

	E.1.10. Vlerësimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit nga departamenti E.6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT			
Konkluzione	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson se institucioni i arsimit të lartë ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në ndërtimin dhe konsolidimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit me institucione publike dhe private, organizata ndërkombëtare, si dhe aktorë të rëndësishëm të fushës së medias dhe komunikimit. Këto bashkëpunime janë reflektuar në funksion të realizimit efektiv të programit të studimit Master Profesional në "Gazetari Investigative", duke ndikuar pozitivisht në aftësimin profesional të studentëve, përfshirjen në projekte kërkimore me karakter aplikativ dhe në nxitjen e përparimit akademik.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Master Profesional në "Gazetari Investigative", i ofruar nga Universiteti i Tiranës, është i strukturuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit shqiptar për arsimin e lartë dhe në harmoni me parimet e Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program është i organizuar për një vit akademik me ngarkesë totale 60 ECTS, ku 1 ECTS përfaqëson 25 orë pune të studentit (në auditor dhe jashtë tij). Struktura modulare përfshin 9 lëndë të shpërndara në katër module, duke përfshirë edhe projektin përfundimtar (tezën). Planet mësimore janë të ndara në pesë kategori veprimtarish formuese: - Lëndë bazë (6 ECTS), - Lëndë karakterizuese (24 ECTS), - Lëndë ndërdisiplinore/zgjedhje (12 ECTS), - Lëndë plotësuese (6 ECTS), - Detyrime përmbyllëse – tezë diplome (12 ECTS), në përputhje me VKM nr. 879, datë 18.12.2019.

	Format e mësimdhënies përfshijnë leksione të integruara me seminare, ushtrime praktike, punë laboratorike, projekte dhe detyra kursi. Ngarkesa javore e studentëve është e balancuar në mënyrë që të mos kalojë 25 orë në javë, ndërsa ngarkesa totale për një vit akademik ndahet në 585 orë në auditor dhe 915 orë jashtë auditorit. Gjithashtu, çdo lëndë është e shoqëruar me syllabus të detajuar, ku përcaktohen objektivat, ngarkesa, orare mësimore, format e vlerësimit, përmbajtja tematike dhe rezultatet e të nxënësve që synohen. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP në Gazetari Investigative"</i> <i>E.1.8. Plan i mësimor i Programit të Studimit MPGI</i> <i>E.2.6. Propozim për hapjen e programit të studimit MPGI</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Masteri Profesional në "Gazetari Investigative" paraqet një strukturë të plotë dhe të mirëkonsoliduar në përmbajtjen e lëndëve, metodologjisë së mësimdhënies dhe objektivave që synon të arrijë. Ky program është ndërtuar duke pasur në qendër nevojën për thellimin e njohurive teorike dhe aftësive praktike në një fushë të rëndësishme të gazetarisë, e cila deri më sot është trajtuar vetëm në nivelin e parë të studimeve dhe vetëm përmes një lënde të vetme. Në përputhje me këtë qasje, programi është i strukturuar në katër module të mëdha, të cilat përfshijnë komponentë të ndryshëm nga gazetaria e të dhënave, etika profesionale, investigimi ekonomik dhe online, gazetaria financiare dhe mbrojtja e burimeve. Mësimdhënia realizohet nëpërmjet metodave bashkëkohore si workshop-e, klinika investigimi, punë në grup, projekte individuale, produksione në TV dhe radio, si dhe vizita në redaksi dhe institucione mediatike, duke iu dhënë studentëve mundësinë të përfshihen aktivisht në procesin mësimor. Kjo strukturë përmban një ndërthurje të kujdesshme të anës teorike me praktikën, duke i dhënë rëndësi përvojës reale të studentëve në mjedisin profesional të gazetarisë. Qëllimi i programit, siç është formuluar nga vetë njësia, është "të rrisë perspektivën individuale të avancimit të karrierës përmes njohurive se si të zbatohen të mësuarit akademik në praktikën më të mirë të investigimit në gazetari", duke krijuar kështu një urë të drejtpërdrejtë mes arsimit të lartë dhe kërkesave të tregut të punës në fushën e medias. Në këtë kontekst, studentët jo vetëm që përvetësojnë aftësi për të realizuar investigime të thelluara në përputhje me parimet etike, por gjithashtu mësojnë të menaxhojnë të mësuarit e tyre në mënyrë të pavarur, të identifikojnë nevojat personale për zhvillim profesional dhe të ndërveprojnë ngushtë me ekspertë të fushës. <i>E.2.6. Propozim për hapjen e programit të studimit MPGI</i> <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP në Gazetari Investigative"</i>

Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit përcakton qartë ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe për detyrimet përmbyllëse, duke përfshirë edhe tezën e diplomës me një vlerë prej 12 ECTS. Në Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit, studentët ndjekin gjatë javës tetë lëndë teorike nga e hëna në të enjte, ndërsa dita e premte i dedikohet plotësisht praktikës profesionale në laboratorë modernë të pajisur me teknologji bashkëkohore për prodhimin mediatik audio, video dhe digjital. Kjo praktikë përbën një lëndë mësimore integrale që siguron zhvillimin e aftësive teknike dhe profesionale të studentëve. Struktura e ngarkesës kreditive për praktikën dhe tezën e diplomës është në përputhje me standardet e arsimit të lartë dhe VKM nr. 879, datë 18.12.2019, duke siguruar një balancë të mirë mes përgatitjes teorike dhe asaj praktike. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP ne Gazetari Investigative"</i> <i>E.1.8. Plani mësimor i Programit të Studimit MPGI</i>
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë "Master" në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve "Master", sipas fushave përkatëse të formimit.	Nuk aplikohet
Kriteri 5. Programet "Master" në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet "Master", që formojnë mësues të shtë njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	Nuk aplikohet
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Programi i studimit është organizuar dhe zbatuar në përputhje të plotë me ligjin e arsimit të lartë dhe udhëzimet specifike të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, duke respektuar të gjitha kërkesat që lidhen me organizimin e studimeve, pranimin e studentëve dhe financimin e tyre në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë. Procesi i pranimi të studentëve është rregulluar në mënyrë të qartë duke u bazuar në kriteret dhe procedurat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi, si dhe në rregulloren e brendshme të programit.

	Përveç kësaj, sikurse evidentohet në evidencën 2.6 në propozimin për hapjen e programit MPGI, janë trajtuar të gjitha aspektet ligjore dhe administrative që garantojnë një organizim të qëndrueshëm dhe të drejtë për studentët. Kjo qasje siguron që programi të funksionojë në një kuadër ligjor të qartë, duke i ofruar studentëve mundësi të barabarta për akses dhe përfitim nga arsimimi dhe duke krijuar bazën për zhvillim profesional dhe akademik në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP në Gazetari Investigative"</i> <i>E.2.6. Propozim për hapjen e programit të studimit MPGI</i>
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit Master, edhe pse i pari i këtij lloji në Shqipëri, është hartuar në mënyrë që kurrikula mësimore të ketë ngjashmëri me programe të tjera të gazetarisë në nivel kombëtar, duke siguruar kështu përputhshmërinë me standardet akademike dhe kërkesat e fushës. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP në Gazetari Investigative"</i> <i>E.1.8. Plani mësimor i Programit të Studimit MPGI</i>
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit Master Profesional në "Gazetari Investigative" është shoqëruar me kodin përkatës 71MP0321S, i cili është caktuar në përputhje me klasifikimet zyrtare të publikuara. Ky kodifikim siguron një identifikim të qartë dhe të standardizuar të programit brenda sistemit arsimor, duke lehtësuar administrimin, raportimin dhe njohjen institucionale dhe kombëtare. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP në Gazetari Investigative"</i>
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Programi i studimit Master në "Gazetari Investigative" zhvillohet nga Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, duke qenë i pari i këtij lloji në Shqipëri dhe duke adresuar një boshllëk të rëndësishëm në fushën e gazetarisë dhe komunikimit. Edhe pse nuk është një program i përbashkët formal midis institucioneve të arsimit të lartë vendas dhe të huaj, përmbajtja e tij është zhvilluar dhe përmirësuar duke u mbështetur në standardet dhe përvojën e Departamentit të Gazetarisë të De Montfort University në Mbretërinë e Bashkuar. Ky bashkëpunim është realizuar përmes asistencës së ekspertëve britanikë, Dr. Richard Dunbery dhe Dr. Perves Khan, me mbështetjen e projektit "Drejtësi për të gjithë" nga USAID dhe Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar, dhe ka qenë thelbësor në hartimin dhe avancimin e kurrikulës. Në të ardhmen, është planifikuar nënshkrimi i një memorandum bashkëpunimi midis universiteteve dhe departamenteve për të krijuar mundësi bashkëpunimi të vazhdueshëm në zhvillimin dhe realizimin e programit. Kjo qasje garanton zhvillimin e vazhdueshëm dhe

	përmirësimin e cilësisë së programit në përputhje me standardet ndërkombëtare.			
	<i>E.2.6. Propozim për hapjen e programit të studimit MPGI</i>			
Konkluzione	Grupi i vlerësimit të jashtëm vlerëson se programi i studimit është organizuar në përputhje të plotë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Struktura, përmbajtja dhe procedurat e programit respektojnë kërkesat ligjore të arsimit të lartë në Shqipëri, duke siguruar një kornizë të qartë dhe të qëndrueshme për zhvillimin akademik dhe profesional të studentëve. Kjo përputhshmëri garanton ligjshmërinë e ofrimit të programit dhe krijon bazën për një proces arsimor cilësor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në “Gazetari Investigative”, përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi lidhur me organizimin dhe strukturën akademike, përbërjen e stafit akademik, si dhe proceset e vlerësimit dhe akreditimit. Departamenti funksionon sipas rregulloreve të miratuara në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe aktet nënligjore përkatëse, duke garantuar mbështetjen institucionale, burimet njerëzore dhe kapacitetet e nevojshme për ofrimin dhe zhvillimin cilësor të programit të studimit. Gjithashtu, janë respektuar kërkesat për kualifikimin dhe angazhimin e stafit akademik në përputhje me standardet ligjore, si dhe përfshirja në procese të vazhdueshme të vetëvlerësimit dhe vlerësimit të jashtëm në funksion të përmirësimit të cilësisë. <i>E.2.2. CV e stafit akademik me kohë të plotë të angazhuar në programin e studimit</i> <i>E.2.2.b. Lista dhe CV e stafit akademik me kohë të pjeshme të angazhuar në MPGI</i> <i>1.5. Rregullore për funksionimin e NjSBC</i> <i>1.2. Rregullore e Universitetit të Tiranës 2022</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, si njësi bazë përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në “Gazetari Investigative”, përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi edhe në aspektin e angazhimit të personelit

akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	ndihmës akademik dhe administrativ. Një personel ndihmës akademik me karakter mësimor, laboranti i departamentit, mbështet studentët dhe stafin pedagogjik për proceet të ndryshme mësimore. Detyrat dhe përgjegjësitë e stafit ndihmës akademik janë të parashikuara në nenin 5 të rregullores së programit të studimit. Gjithashtu, në mbështetje të realizimit të praktikave mësimore dhe aktiviteteve laboratorike është i angazhuar stafi efektiv akademik dhe administrativ, përfshirë koordinorët përkatës të programit, të cilët garantojnë zhvillimin cilësor të komponentit praktik. Ky organizim siguron funksionimin efikas të proceseve mësimore dhe mbështet formimin profesional të studentëve në përputhje me objektivat e programit dhe kërkesat ligjore në fuqi. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP ne Gazetari Investigative"</i>			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, ka përmbushur detyrimin ligjor për caktimin e koordinorit të programit të studimit Master Profesional në "Gazetari Investigative". Ky përcaktim është i parashikuar në nenin 9 të Rregullores së programit të studimit MPGI, ku specifikohet roli dhe përgjegjësitë e koordinorit në drejtim të mbikëqyrjes së ecurisë dhe zhvillimit të programit në përputhje me objektivat akademike dhe profesionale të tij. Në zbatim të kësaj dispozite, me vendimin nr. 3, datë 18.09.2024, të Departamentit, është emëruar koordinor i programit të studimit, i cili mban përgjegjësinë kryesore për ndjekjen e zbatimit të planit mësimor, bashkërendimin e praktikave profesionale dhe sigurimin e cilësisë së procesit mësimor. Ky mekanizëm siguron një menaxhim efektiv dhe të strukturuar të programit. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP ne Gazetari Investigative"</i> <i>E.2.3. Urdhër për emërimin e koordinorit të programit të studimit</i>			
Konkluzione	Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe vlerësimin e kryer, grupi i vlerësimit të jashtëm konkludon se njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në "Gazetari Investigative" përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të parashikuara për këto njësi. Struktura organizative është funksionale, me përgjegjësi të qarta institucionale dhe akademike, stafi efektiv është i angazhuar në përmbushjen e objektivave të programit, ndërsa roli i koordinorit të programit është i institucionalizuar përmes rregullores së programit të studimit dhe vendimeve të departamentit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	NDR përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X



Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Njësia bazë përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, konkretisht Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, disponon të gjitha informacionet e nevojshme lidhur me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit Master Profesional në “Gazetari Investigative”. Këto informacione janë të dokumentuara dhe të aksesueshme përmes rregullores së programit, strukturës së kurrikulës, sillabuseve të miratuara për çdo lëndë dhe materialeve informuese të cilat vihen në dispozicion të studentëve. Për më tepër, plani mësimor i programit të studimit, sikurse paraqitet në evidencën 1.8, përfshin të gjithë përbërësit bazë të programit dhe është hartuar në përputhje të plotë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit “MP ne Gazetari Investigative”</i> <i>E.1.8. Plan i mësimor i Programit të Studimit MPGI</i> <i>E.2.1. Syllabuset e lëndëve</i>
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Programi i studimit Master Profesional në “Gazetari Investigative” përmban një plan mësimor të strukturuar dhe të detajuar, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Bazuar në evidencën 1.8, është e qartë ndarja e lëndëve në module dhe semestra, duke garantuar një organizim të mirëpedagogjizuar të ngarkesës akademike. Plani mësimor specifikon për çdo lëndë: emrin e lëndës, emrin e pedagogut përgjegjës, kodin përkatës të lëndës, llojin e saj (bazë, karakterizuese, zgjedhje, etj.), gjuhën në të cilën lektrohet, grupin e lëndës sipas klasifikimit, si dhe ndarjen ndërmjet leksioneve dhe seminareve. Po ashtu, janë të përcaktuara edhe ngarkesat përkatëse në ECTS, si dhe ndarja e orëve në auditor dhe jashtë tij. <i>E.1.8. Plan i mësimor i Programit të Studimit MPGI</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit Master Profesional në “Gazetari Investigative” përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, në përputhje me legjislacionin për arsimin e lartë dhe aktet nënligjore në fuqi. Nenet 39 dhe 40 të Rregullores së Programit të Studimit parashikojnë qartë kriteret për pranimin e studentëve. Në këto nene përcaktohet se kriteri bazë për pranimin është përfundimi me sukses i ciklit të parë të studimeve (Bachelor), si dhe nota mesatare, e vendosur nga Departamenti përgjegjës sipas

	standardeve akademike dhe kuotave të pranimit. Gjithashtu, neni 40 specifikon dokumentacionin e nevojshëm për aplikim, duke garantuar transparencë dhe barazi në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve. Për më tepër, mbështetur në Rregulloren e Universitetit të Tiranës, zbatohen procedurat për transferimin dhe ekuivalentimin e studimeve për studentët që kanë ndjekur më parë programe të ngjashme, duke siguruar përputhshmëri me standardet kombëtare të arsimit të lartë. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP në Gazetari Investigative"</i> <i>1.2. Rregullore e Universitetit të Tiranës 2022</i> <i>E.5.4. Kriteret dhe kuotat e pranimit</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit Master Profesional në "Gazetari Investigative" përmban të gjithë informacionin e nevojshëm për çdo lëndë përmes programit lëndor (syllabusit). Çdo syllabus përfshin objektivat e lëndës, përmbajtjen tematike, rezultatet e të nxënës, metodologjinë e mësimdhënies, si dhe modalitetet e vlerësimit të studentëve. Gjithashtu, për secilën lëndë janë të përcaktuara praktikën, seminarin, orët e laboratorit dhe komponentët e tjerë formues, që kontribuojnë në përgatitjen akademike dhe praktike të studentëve në përputhje me kërkesat e një programi profesional. Evidenca e syllabuseve është e dokumentuar në dosjen e programit dhe u mundëson studentëve orientim të qartë për çdo komponent të përfshirë në procesin mësimor. <i>E.2.1. Syllabuset e lëndëve</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohen dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Përmbajtja e programit të studimit Master Profesional në "Gazetari Investigative" është objekt i një procesi të vazhdueshëm vlerësimi dhe përmirësimi, në përputhje me standardet akademike dhe kërkesat e tregut të punës. Në fillim të çdo viti akademik, Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit rishikon dhe miraton çdo ndryshim eventuale në strukturën apo përmbajtjen e programit, duke reflektuar nevojat e identifikuara gjatë implementimit të mëparshëm. Të gjitha ndryshimet dokumentohen dhe arkivohen në dosjen përkatëse të programit, duke garantuar gjurmueshmëri dhe transparencë institucionale. Gjatë vizitës në terren të grupit të vlerësimit të jashtëm, u konfirmua se procesi i vlerësimit periodik është një praktikë e konsoliduar, veçanërisht në prag të fillimit të vitit akademik. Ky angazhim për përmirësim të vazhdueshëm kontribuon në rritjen e cilësisë së programit dhe përputhshmërinë e tij me zhvillimet bashkëkohore në fushën e gazetarisë.

	Duhet theksuar se institucioni duhet të dokumentojë arkivimin e dosjes së plotë në gjuhën angleze.			
	<i>E.2.7. Procesverbale të mbledhjeve të departamentit</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit Master Profesional në "Gazetari Investigative" është i strukturuar dhe organizuar në përputhje me kërkesat ligjore dhe objektivat formues të ciklit të dytë. Ai ofron informacion të plotë mbi përmbajtjen, planin mësimor, programet lëndore dhe procedurat akademike. Grupi i vlerësimit të jashtëm konkludon se standardi është i realizuar plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4	
Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi i studimit Master Profesional në "Gazetari Investigative" përmbush kërkesat e këtij kriteri, pasi emërtimi është në përputhje me objektivat e tij formues, duke reflektuar qartë fushën e specializimit. Përmbajtja e veprimtarive mësimore dhe organizimi i lëndëve teorike e praktike janë të orientuara drejt zhvillimit të aftësive profesionale, analitike dhe kërkimore, që mundësojnë si vazhdimin e studimeve në nivel më të lartë, ashtu edhe integrimin e drejtpërdrejtë në tregun e punës. Struktura e programit, me theks në praktikën profesionale dhe aftësitë investigative në fushën e gazetarisë, mbështet një formim të avancuar në përputhje me nevojat aktuale të tregut mediatik dhe në të njëjtën kohë plotëson një boshllëk në tregun e punës. <i>E.1.8. Plan i mësimor i Programit të Studimit MPG</i> <i>E.2.1. Syllabuset e lëndëve</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arrijen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Programi i studimit Master Profesional në "Gazetari Investigative" organizohet për një vit akademik me ngarkesë totale prej 60 ECTS, të shpërndara në dy semestra. Ai përfshin mësimin e teknikave kryesore të gazetarisë investigative, duke i kushtuar vëmendje të veçantë parimeve të gazetarisë investigative, etikës, sigurisë së gazetareve, gazetarisë së të dhënave, investigimit online, mbrojtjes së burimeve, si dhe fushave specifike si investigimi ekonomik, gazetaria financiare dhe raportimi mbi pushtetin gjyqësor dhe krimin. Struktura dhe ndarja në module sigurojnë arrijen e objektivave formues dhe zhvillimin e kompetencave të nevojshme, ndërsa programi promovon autonominë e studentëve në

	menaxhimin e procesit të të mësuarit, duke iu mundësuar atyre të identifikojnë vetë nevojat e tyre dhe të bashkëpunojnë ngushtë me stafin akademik për zhvillim më të mirë. <i>E.1.8. Plan i mësimor i Programit të Studimit MPGI</i> <i>E.2.1. Syllabuset e lëndëve</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Programi Master Profesional në "Gazetari Investigative" ka një strukturë të balancuar dhe të integruar mes teorisë dhe praktikës, në përputhje me profilin e programit dhe kërkesat e fushës së studimit. Ndarja e lëndëve dhe raporti teori-praktik janë të projektuara për të siguruar zhvillimin e aftësive të thelluara profesionale dhe kompetencave të nevojshme për gazetarët investigativë. Ky program është hartuar me mbështetjen dhe asistencën e Departamentit të Gazetarisë në De Montford University, Mbretëria e Bashkuar, përmes një bashkëpunimi të ngushtë me ekspertët Dr. Richard Dunbery dhe Dr. Pervces Khan. Ky bashkëpunim, i realizuar me mbështetjen e projektit "Drejtësi për të gjithë" të USAID dhe Ambasadës së Mbretërisë së Bashkuar, ka siguruar përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare dhe ka ndihmuar në zhvillimin e një kurrikule moderne dhe konkurruese. Programi siguron aftësi profesionale në gazetari investigativ, me fokus në etikën, sigurinë e gazetarëve, gazetarinë e të dhënave, investigimin online dhe financiar, duke i përgatitur studentët për sfidat reale të profesionit dhe për punësim në media me standarde të larta profesionale. Kjo qasje e kombinuar mes përvojës ndërkombëtare dhe praktikës lokale garanton një formim cilësor dhe të thelluar profesional. <i>E.1.8. Plan i mësimor i Programit të Studimit MPGI</i> <i>E.2.6. Propozim për hapjen e programit të studimit MPGI</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Programi i studimit karakterizohet nga një ndarje e qartë dhe e balancuar midis veprimtarive formuese teorike dhe praktike, duke siguruar arritjen e objektivave të formimit profesional. Me një strukturë modulare që përfshin 4 module dhe 9 lëndë, programi ofron një raport të drejtë midis orëve në auditor (585 orë) dhe punës jashtë auditorit (915 orë), si dhe shpërndarjen e kredive ECTS (60 total, 30 për semestër) në përputhje me ngarkesën mësimore. Përveç leksioneve dhe seminareve, përfshihen edhe laboratorë, projekte dhe detyra kursi që promovojnë praktikën profesionale dhe zhvillimin e aftësive të studentëve. Ky dizajn i programit, i mbështetur edhe nga bashkëpunimi me De Montford University në Mbretërinë e Bashkuar, garanton përputhshmeri me standardet ndërkombëtare dhe i përgatit studentët për mobilitet akademik dhe punësim në tregun e punës.

	<i>E.1.8. Plani mësimor i Programit të Studimit MPGI</i> <i>E.2.6. Propozim për hapjen e programit të studimit MPGI</i> <i>E.2.1. Syllabuset e lëndëve</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Programet e lëndëve (syllabuset) përditësohen në mënyrë të rregullt në fillim të çdo viti akademik, nëpërmjet një procesi të hapur konsultimi ndërmjet anëtarëve të departamentit dhe me marrjen parasysh të sugjerimeve të studentëve, për të reflektuar zhvillimet akademike dhe nevojat e tregut të punës. Megjithatë, gjatë vlerësimit u evidentua se sa i përket literaturës së detyrueshme dhe asaj të rekomanduar nuk përfshiheshin botime të viteve të fundit. Pas kërkesës së Grupit të Vlerësimit të Jashtëm që departamenti të ndërmarrë një proces të rishikimit të literaturës në të gjitha lëndët, duke siguruar përfshirjen e teksteve dhe burimeve shkencore të përditësuara, si në pjesën e literaturës bazë ashtu edhe në atë ndihmëse, u përcollën evidenca shtesë nga DGK në sistemin AMS, ku evidentohet se ky kriter konsiderohet i realizuar. <i>E.2.1. Syllabuset e lëndëve</i> <i>E.2.7. Procesverbale të mbledhjeve të departamentit</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programit të studimit është konceptuar dhe ndërtuar në funksion të përfundimit të plotë të njohurive, aftësive praktike dhe kompetencave profesionale që i përgjigjen objektivave formues të ciklit të dytë të studimeve dhe kërkesave të tregut të punës. Lëndët janë të organizuara në mënyrë të tillë që të mbulojnë aspektet teorike dhe praktike të fushës së gazetarisë investigative, duke i pajisur studentët me kompetenca në analiza të thelluara, hulumtim investigativ, etikë profesionale, përdorim të burimeve të hapura, si dhe aftësi për komunikim efektiv dhe të përgjegjshëm në mjedisin mediatik. Struktura e programit garanton ndërlidhjen mes teorisë dhe praktikës përmes integritit të trajnimeve, seminareve, punës në terren dhe përgatitjes së projektit përfundimtar. Ky kombinim siguron zhvillimin e kompetencave të avancuara që synohen në përfundim të programit, në përputhje me kornizën kombëtare dhe europiane të kualifikimeve për arsimin e lartë. <i>E.1.8. Plani mësimor i Programit të Studimit MPGI</i>
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimitin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit të studimit Master Profesional në “Gazetari Investigative” është ndërtuar në mënyrë të tillë që u ofron studentëve një formim të thelluar profesional, i cili jo vetëm përmbush objektivat formuese të ciklit të dytë, por gjithashtu i përgatit ata për të vijuar studime më të thelluara ose për t’u integruar menjëherë në tregun e punës. Modulët e përfshira në program janë hartuar në përputhje me kërkesat aktuale të industrisë së medias dhe sfidat që lidhen me gazetarinë investigative, duke synuar zhvillimin e kompetencave

	që kërkohen nga punëdhënësit në sektorë të ndryshëm: media tradicionale dhe online, organizata joqeveritare, institucione publike dhe agjenci ndërkombëtare. Përmbajtja e kurrikulës përfshin trajnim në etikë profesionale, teknika hulumtimi dhe analiza të avancuara, duke mundësuar që studentët të përfitojnë një profil konkurrues dhe të aplikueshëm në praktikat profesionale, por njëkohësisht edhe të përgatisin baza të qëndrueshme për vazhdimin e mëtejshëm të karrierës akademike. <i>E.1.8. Plan i mësimor i Programit të Studimit MPGI</i>			
Konkluzione	<i>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit janë në përputhje me objektivat formuese të parashikuara për ciklin e dytë të studimeve, si dhe me nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve. Programi siguron zhvillimin e kompetencave akademike dhe profesionale të studentëve, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve apo integrimin në tregun e punës. Gjithashtu, në përmbajtje reflektohet përpjekja për përgatitjen e studentëve në funksion të kërkesave aktuale të tregut dhe zhvillimeve të fushës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Përmirësimi i përmbajtjes së programit të studimit realizohet nëpërmjet një procesi të vazhdueshëm konsultimi dhe bashkëpunimi me aktorë të jashtëm, përfshirë institucionet partnere, të diplomuarit dhe përfaqësues të tregut të punës. Gjatë hartimit dhe ecurisë së programit “Master Profesional në Gazetari Investigative”, departamenti ka marrë parasysh sugjerimet e ardhura nga ekspertë të fushës, organizata mediatike dhe projekte bashkëpunimi me institucione ndërkombëtare. Ky bashkëpunim ka ndikuar drejtpërdrejt në përmbajtjen dhe profilin profesional të programit, duke e bërë atë më të përshtatshëm me kërkesat e tregut aktual të punës në fushën e gazetarisë. <i>E.2.6. Propozim për hapjen e programit të studimit MPGI</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe	Nga evidencat e dorëzuara në dosjen e aplikimit, si dhe vizita në institucion, takimi me studentë dhe aktorë të tjerë evidentohet se

konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	institucioni inkurajon dhe përfshin studentët në procesin e përmirësimit të programit të studimit përmes diskutimeve të drejtpërdrejta në kuadër të mbledhjeve të departamentit, forumeve studentore dhe analizave vjetore të zhvillimit të programit. Struktura përfaqësuese e studentëve është e përfshirë në organet vendimmarrëse dhe kontribuon me sugjerime për rritjen e cilësisë akademike dhe përmbajtjes së programeve. Po ashtu, departamenti ruan kontakte të vazhdueshme me të diplomuarit, duke i angazhuar ata në forma të ndryshme konsultimi dhe vlerësimi të ecurisë së programit. Mendimet dhe përvojat e tyre në tregun e punës shërbejnë si indikatorë të vlefshëm për të reflektuar dhe përshtatur më tej përmbajtjen e programit me nevojat e aktualizuara profesionale. <i>E.2.7. Procesverbale të mbledhjeve të departamentit</i> <i>E.6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i>			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Ky kriter konsiderohet një nga pikat më të forta të programit të studimit. Siç dëshmohet në dokumentin E.2.6 "Propozim për hapjen e programit të studimit MPGI", gjatë konceptimit dhe miratimit të tij është ndjekur një proces gjithëpërfshirës, me konsultime të gjera me rrjete profesionistësh, organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe aktorë nga tregu i punës. Ky bashkëpunim nuk është i njëhershëm, por vijon edhe gjatë zbatimit të programit, ku njësia përgjegjëse angazhohet në përmirësimin dhe përditësimin e tij, në përputhje me zhvillimet e fundit në fushën e gazetarisë investigative. Në mënyrë të vazhdueshme, merren parasysh propozimet që vijnë nga partnerët institucionalë, rrjetet e studentëve të diplomuar dhe profesionistët e fushës, duke garantuar që përmbajtja e programit të mbetet relevante, dinamike dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe të zhvillimeve akademike bashkëkohore. <i>E.2.6. Propozim për hapjen e programit të studimit MPGI</i> <i>E.3.6. Projektet shkencore të departamentit</i>			
Konkluzione	<i>Grupi i vlerësimit të jashtëm vlerëson se institucioni ka ndërmarrë masa të strukturuar për të nxitur dhe siguruar përfshirjen aktive të studentëve, të diplomuarve, partnerëve institucionalë, rrjeteve profesionale dhe organizatave vendore e ndërkombëtare në procesin e hartimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të programit të studimit. Kjo përfshirje ka kontribuar ndjeshëm në përcaktimin me sukses të objektivave formuese të programit dhe në përafrimin e tij me kërkesat aktuale të tregut të punës, duke rritur cilësinë dhe relevancën e tij akademike e profesionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi i studimit Master Profesional në “Gazetari Investigative”, i ofruar nga Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, përcakton në mënyrë të qartë prioritetet dhe objektivat themelore të studimit dhe kërkimit shkencor, në përputhje të plotë me objektivat strategjikë të Universitetit të Tiranës dhe misionin e tij akademik. Programi synon të ndërtojë një profil të specializuar të gazetarit investigativ, duke nxitur zhvillimin e mendimit kritik, aftësive kërkimore dhe etikës profesionale, përmes një strukture të integruar teorike dhe praktike. Objektivat janë të orientuara drejt përgatitjes së studentëve për të analizuar dhe trajtuar në mënyrë të pavarur dhe të argumentuar çështje komplekse me rëndësi publike, në përputhje me standardet bashkëkohore të gazetarisë dhe me prioritetet kërkimore të institucionit, që përfshijnë ndershmërinë akademike, inovacionin dhe angazhimin qytetar. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit “MP në Gazetari Investigative”</i> <i>E.2.6. Propozim për hapjen e programit të studimit MPGI</i> <i>E.1.2. Strategjia e zhvillimit të UT-së (2023-2028)</i>
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	Gjatë vizitës të GVJ në institucion me stafin akademik efektiv dhe me kontratë u vu theksi te roli aktiv i Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit, si njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në “Gazetari Investigative”, në nxitjen, bashkërendimin dhe administrimin e veprimtarive të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në përputhje me misionin akademik të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë dhe të Universitetit të Tiranës. Departamenti garanton respektimin e plotë të lirisë akademike të stafit pedagogjik, duke i krijuar hapësira për zhvillimin e përmbytjes mësimore dhe iniciativave kërkimore në përputhje me fushën e tyre të ekspertizës. Procesi i mësimdhënies zhvillohet në mënyrë të organizuar dhe në përputhje me parimet e cilësisë akademike, ndërsa kërkimi shkencor mbështetet si në nivel individual, ashtu edhe përmes pjesëmarrjes në projekte dhe bashkëpunime ndërinstitucionale kombëtare e ndërkombëtare <i>E.6.8. Publikime të stafit akademik (2022-2023)</i> <i>E.1.7. Raport i analizës vjetore të Departamentit</i> <i>E.3.6. Projektet shkencore të departamentit</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjimnazit “Qemal Stafa”, Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

	<i>E.3.7. Pedagogë pjesëmarrës në Erasmus+</i>
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Kriteri 3 konsiderohet i realizuar plotësisht, pasi programi i studimit Master Profesional në “Gazetari Investigative”, i ofruar nga Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, ofron një strukturë të qartë dhe mbështetëse që nxit përfshirjen aktive të studentëve në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore. Nëpërmjet komponentëve të praktikës profesionale dhe lëndëve të fokusuara në metodologjinë e hulumtimit dhe analizës mediatike, studentët inkurajohen të aplikojnë njohuritë e fituara në projekte konkrete investiguese. Këto projekte, të realizuara nën mbikëqyrjen e stafit akademik, publikohen në platformën zyrtare të programit, duke u dhënë studentëve mundësinë për të zhvilluar një portofol profesional dhe për të kontribuar në debatet publike me produkte mediatike me vlerë kërkimore. Gjithashtu, pjesëmarrja në veprimtari brenda dhe jashtë institucionit, si trajnime, konferenca dhe konkurse mediatike, përbën një tjetër formë nxitjeje për zhvillimin akademik dhe profesional të studentëve, në përputhje me objektivat formues të programit. Kjo u konfirmua edhe gjatë vizitës në institucion nga vetë studentët, të cilët në takimin me grupin e vlerësimit shprehën angazhimin dhe përfshirjen e tyre aktive në këto veprimtari kërkimore dhe profesionale. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit “MP ne Gazetari Investigative”</i> <i>E.1.8. Plan i mësimor i Programit të Studimit MPGI</i>
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore dhe shkencore, Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit si njësi bazë, mbështetet financiarisht nga burimet institucionale të Universitetit të Tiranës, një institucion publik. Zërat buxhetorë për këto aktivitete përcaktohen dhe miratohen në bashkërendim me njësinë kryesore, Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, në përputhje me planifikimin vjetor dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit. Përveç mbështetjes nga fondet publike, Departamenti ka siguruar fonde shtesë përmes pjesëmarrjes dhe fitimit të projekteve kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat administrohen në përputhje me rregulloret përkatëse. Këto projekte mbështesin drejtpërdrejt aktivitetin kërkimor, përfshirjen e stafit dhe studentëve në veprimtari akademike dhe mundësojnë zgjerimin e bashkëpunimeve me aktorë të tjerë institucionale. <i>E.3.6. Projektet shkencore të departamentit</i>
Konkluzione	<i>Grupi i vlerësimit të jashtëm vlerëson se programi i studimit garanton orientim të qartë në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor, përmes përmbajtjes së lëndëve, projekteve praktike,</i>

	përfshirjes në prodhime kërkimore dhe bashkëpunimeve me aktorë të fushës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	Për realizimin e këtij kriteri, Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit ka treguar angazhim në mbështetjen e projekteve kërkimore dhe bashkëpunimeve me struktura të tjera kërkimore brenda dhe jashtë institucionit, në funksion të përmbushjes së objektivave të programit të studimit në fushën e kërkimit shkencor. Megjithatë, gjatë vlerësimit u konstatua se mungon dokumentacion i qartë dhe i formalizuar që dëshmon ndarjen dhe funksionimin e grupeve lëndore, të cilat janë element kyç për strukturimin e veprimtarisë akademike dhe kërkimore. Njësia bazë duhet të dokumentojë ndarjen e grupeve lëndore në përputhje me kërkesat ligjore dhe praktikrat e mira akademike, si dhe të forcojë rolin e tyre në zhvillimin e projekteve të lidhura me fushën e programit. <i>E.3.6. Projektet shkencore të departamentit</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	Për realizimin e këtij kriteri, Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, si njësi përgjegjëse për programin e studimit, angazhohet aktivisht në projekte dhe nisma kërkimore që lidhen me fushën e medias, komunikimit dhe zhvillimeve sociale. Në përputhje me misionin e tij akademik, departamenti kontribuon në hartimin dhe realizimin e analizave dhe studimeve me karakter kërkimor, në bashkëpunim me institucione publike, organizata mediatike, si dhe partnerë kombëtarë e ndërkombëtarë. Gjithashtu, përmes përfshirjes së personelit akademik dhe të studentëve në këto procese, nxisin përvojën kërkimore dhe zhvillimin e kompetencave analitike dhe shkencore. Praktikrat kërkimore shpesh lidhen edhe me projektet në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit, duke mundësuar një ndërthurje të qëllimeve akademike me nevojat reale të shoqërisë dhe tregut të punës. <i>E.3.6. Projektet shkencore të departamentit</i> <i>E.1.9. Marrëveshjet e bashkëpunimit</i>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, si njësi përgjegjëse për programin e studimit, angazhohet rregullisht në organizimin e konferencave, tryezave të rrumbullakëta, seminareve dhe aktiviteteve akademike me fokus në zhvillimet bashkëkohore të

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit «Qemal Stafa», Tiranë
Tel: +355 (0) 222-13423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	gazetarisë dhe komunikimit. Këto aktivitete shërbejnë si hapësira të rëndësishme për diskutim shkencor dhe shkëmbim përvojash ndërmjet stafit akademik, studentëve dhe profesionistëve të fushës. Përveç zhvillimit profesional të personelit, këto evente përfshijnë në mënyrë aktive studentët, duke nxitur pjesëmarrjen e tyre me prezantime studimore dhe projekte praktike, si dhe duke forcuar aftësitë e tyre analitike dhe kërkimore. Organizimi i këtyre aktiviteteve kontribuon në realizimin e objektivave të programit të studimit, veçanërisht në drejtim të formimit të një komuniteti akademik të angazhuar dhe të orientuar drejt ekselencës në kërkimin shkencor dhe zhvillimin profesional. <i>E.3.6. Projektet shkencore të departamentit</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi i studimit Master Profesional në “Gazetari Investigative”, i ofruar nga Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, synon formimin e profesionistëve konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës, nëpërmjet një plani mësimor bashkëkohor, të strukturuar sipas standardeve akademike europiane dhe të përshtatur me kërkesat dinamike të industrisë mediatike. Struktura e programit ofron një kombinim të balancuar ndërmjet formimit teorik dhe aftësive praktike, çka përbën një avantazh të qartë për studentët në përgatitjen e tyre profesionale. Megjithatë, të dhënat statistikore tregojnë se pavarësisht cilësisë dhe ambicies së planit mësimor, numri i studentëve të diplomuar mbetet i ulët. Në vitin akademik 2021–2022, nga 14 studentë të regjistruar, nuk ka pasur asnjë të diplomuar; ndërsa në vitet 2022–2023 dhe 2023–2024, janë diplomuar përkatësisht 3 studentë në secilin vit. GVJ tërheq vëmendjen për stimulimin dhe motivimin e studentëve për përfundimin e studimeve, duke pasur parasysh edhe domosdoshmërinë që ka në jetën publike përgatitja e profesionistëve në fushën e gazetarisë investigative. <i>E.1.8. Plan i mësimor i Programit të Studimit MPGI</i> <i>E.4.8. Aneks RVB-tabelat përmbledhëse</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Programi i studimit është i strukturuar për të siguruar zhvillimin e kompetencave profesionale, etike dhe teknike të nevojshme për gazetarinë investigative. Ky program synon përgatitjen e studentëve në përputhje me standardet dhe kërkesat aktuale të tregut të punës, duke u mundësuar atyre të ushtrojnë profesionin në mënyrë profesionale në fushën investigative. <i>E.1.8. Plan i mësimor i Programit të Studimit MPGI</i> <i>E.2.6. Propozim për hapjen e programit të studimit MPGI</i>
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet	Programi i studimit është zhvilluar bazuar në bashkëpunim ndërkombëtar, duke synuar përputhshmërinë me standardet

me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	evropiane për kualifikimet profesionale. Megjithatë, duke qenë se gazetaria nuk është një profesion i rregulluar ligjërisht në vend, programi fokusohet në përgatitjen e studentëve me kompetenca të njohura dhe të pranura në nivel ndërkombëtar, për të siguruar aftësi konkurruese në tregun e punës. <i>E.1.8. Plani mësimor i Programit të Studimit MPGI</i> <i>E.2.6. Propozim për hapjen e programit të studimit MPGI</i>			
Konkluzione	Grupi i vlerësimit të jashtëm vlerëson se programi i studimit siguron njohuri të thelluara, promovon dhe mbështet aktivitetet kërkimore, duke përmbyllur kërkesat e standardit.			
Shkalla e përmbylljes së standardit	Nuk përmbyllet	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht
				X

Shkalla e përmbylljes së standardeve të fushës II	Nuk përmbyllet	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Programi i studimit demonstroi një larmi të pasur formatesh të mësimdhënies dhe të mësimnxënies, të strukturuar në përputhje me objektivat formues dhe natyrën profesionale të programit. Në kurrikulën mësimore përfshihen leksione, seminare, projekte individuale, punë laboratorike dhe praktika profesionale të integruara, të cilat mundësojnë zhvillimin e kompetencave akademike, analitike dhe praktike të studentëve. Kjo shumëllojshmëri formash jo vetëm që pasuron përvojën mësimore, por përbën një ndër pikat më të forta të programit, duke kontribuar drejtpërdrejt në përgatitjen e studentëve për sfidat reale të tregut të punës. <i>E.1.8. Plani mësimor i Programit të Studimit MPGI</i> <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP në Gazetari Investigative"</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Personeli akademik i përfshirë në programin e studimit demonstroi angazhim në përshtatjen e metodave të mësimdhënies me nevojat e ndryshme të studentëve, duke respektuar parimin e diversitetit dhe përfshirjes në procesin mësimor. Kjo reflektohet edhe në ndërtimin e syllabuseve të lëndëve, ku përcaktohen qartë objektivat e të nxënës, format alternative të vlerësimit, burimet

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit "Qemal Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

	ndihmëse dhe metodologjitë e ndryshme të të mësuarit, si leksione interaktive, punë në grup, punë individuale, analiza rasti, përdorimi i platformave digjitale dhe atelietë e mediave. Kjo qasje gjithëpërfshirëse kontribuon në përmirësimin e përvojës akademike dhe përgatitjen e plotë të studentëve në përputhje me profilin e programit. Mundësitë alternative të mësimdhënies dhe mësimnxënies u konfirmuan gjithashtu nga vetë studentët gjatë intervistave të zhvilluara në kuadër të vizitës në institucion, e cila dëshmon për përfshirjen aktive të tyre dhe fleksibilitetin e stafit akademik në procesin mësimor. <i>E.2.1. Syllabuset e lëndëve</i> <i>E.1.8. Plan i mësimor i Programit të Studimit MPGJ</i> <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP në Gazetari Investigative"</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënës.	Institucioni ofron mbështetje për zhvillimin profesional të personelit akademik, kryesisht nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte akademike e kërkimore. Përafrimi i metodave të mësimdhënies me rezultatet e pritshme të të nxënës reflektohet në strukturimin e programeve mësimore dhe në rritjen e kapaciteteve pedagogjike të stafit. Megjithatë, edhe pse personeli akademik përfshihet në projekte kërkimore që mund të kontribuojnë në zhvillimin e kompetencave didaktike, mungon një dokumentim dhe vlerësim i strukturuar i ndikimit të këtyre angazhimeve në përmirësimin konkret të praktikës mësimore. <i>E.3.6. Projektet shkencore të departamentit</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Master Profesional në "Gazetari Investigative" zotëron kompetencat e nevojshme pedagogjike dhe profesionale për të transmetuar njohuri të avancuara në përputhje me objektivat e kurrikulës. Metodatat e mësimdhënies të përdorura janë të ndryshme dhe përfshijnë forma interaktive, me në qendër studentin, si diskutimet analitike, projektet në grup, analizat e rasteve dhe praktikatat laboratorike. Përmes këtyre qasjeve, nxënësin mendojnë kritik, krijues dhe zhvillimin e autonomisë së studentëve. Deklaratat e studentëve gjatë vizitës konfirmojnë një marrëdhënie respekti, bashkëpunimi dhe mbështetjeje reciproke mes stafit akademik dhe studentëve, duke ndihmuar në krijimin e një klime të shëndetshme akademike dhe formuese. Ky kriter përfaqëson një tjetër pikë të fortë të programit të studimit. <i>E.2.2. CV e stafit akademik me kohë të plotë të angazhuar në programin e studimit MPGJ</i>

Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e progamit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Procesi i vlerësimit dhe përmirësimit periodik të metodave dhe formave të mësimdhënies nga njësia përgjegjëse është i integruar në praktikat e programit të studimit, e cila dokumentohet nga disa evidenca. Përfshirja aktive e studentëve në këtë proces realizohet jo vetëm përmes mekanizmave të grumbullimit të feedback-ut dhe reflektimit mbi sugjerimet e tyre, por edhe përmes pjesëmarrjes së një përfaqësuesi studentor në mbledhjet e departamentit. Ky angazhim kontribuon në një dialog të hapur dhe bashkëpunues mes stafit akademik dhe studentëve, duke mundësuar një përmirësim të vazhdueshëm dhe adaptim të metodave didaktike në përputhje me nevojat dhe pritshmëritë e komunitetit studentor. <i>E.5.1. Analiza e departamentit për objektivat formues të programit të studimit</i> <i>E.6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i> <i>E.6.9. Raporti i vlerësimit të lëndëve nga pyetësi i studentëve</i> <i>E.2.7. Procesverbale të mbledhjeve të departamentit</i>			
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Me urdhër të Dekanit të Fakultetit është ngritur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila ka përgjegjësi kryesore për monitorimin, vlerësimin dhe përmirësimin sistematik të proceseve akademike dhe mësimdhënies në nivel fakulteti. Instrumentet e aplikuara nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) vlejnë në mënyrë të njëjtë për të gjitha programet e studimit. Megjithatë, GVJ sugjeron që NJSBC-ja duhet të shtrihet përtej funksionit raportues, duke u angazhuar në mënyrë më aktive në monitorimin e zbatimit të rekomandimeve, si dhe nxitjen dhe koordinimin e aktiviteteve për zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies. Një angazhim i tillë do të siguronte që roli i NJSBC-së të jetë më i dukshëm, efektiv dhe i matshëm në përmirësimin e proceseve akademike dhe të cilësisë së përgjithshme institucionale. <i>E.6.4. Urdhër i Dekanit për krijimin e NJSBC-së në PHF</i> <i>E.6.6. NJSBC dhe Karriera – Raporti vjetor 2023-2024</i>			
Konkluzione	<i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson se institucioni garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional me metoda dhe praktika bashkëkohore, të fokusuara te studenti, duke synuar arritjen e rezultateve të planifikuara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi
----------	-----------

Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Kriteret dhe mënyrat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, aftësive profesionale dhe shkencore në programin e studimit janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e Programit të Studimit. Këto kritere janë të integruara edhe në syllabuset e çdo lënde dhe bëhen publike për studentët përmes platformave institucionale dhe shpërndarjes në fillim të çdo semestri. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP ne Gazetari Investigative"</i> <i>E.2.1. Syllabuset e lëndëve</i>			
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në përputhje me standardet akademike dhe rregulloret institucionale, studentët informohen që në fillim të çdo lënde/moduli për metodologjinë e testimit dhe vlerësimit, e cila është e detajuar në syllabusin përkatës. Titullari i lëndës prezanton qartë mënyrat e vlerësimit, peshën e komponentëve të vlerësimit dhe kriteret e performancës, duke siguruar transparencë në procesin mësimor. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP ne Gazetari Investigative"</i> <i>E.2.1. Syllabuset e lëndëve</i>			
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në formë dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Procesi i testimit dhe vlerësimit është i shumëllojshëm dhe përfshin formë të ndryshme si: provime të ndërmjetme e përfundimtare, prezantime, punë individuale dhe në grup, produkte mediatike, si dhe vlerësim të praktikave profesionale. Kjo qasje e kombinuar mundëson që studentët të demonstrojnë në mënyrë të plotë dhe të drejtë njohuritë, kompetencat dhe aftësitë profesionale të fituara gjatë ciklit të studimeve. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP ne Gazetari Investigative"</i> <i>E.2.1. Syllabuset e lëndëve</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni ka përcaktuar dhe zbatuar qartë kriteret dhe format e vlerësimit, të reflektuara në rregullore dhe syllabuse, duke siguruar transparencë dhe informim të studentëve. Zbatohen metoda të ndryshme vlerësimi që nxisin kompetenca të larmishme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në	Kriteri konsiderohet i realizuar, pasi procesi i testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit akademik. Syllabuset e lëndëve përmbajnë qartësisht komponentët e vlerësimit, si dhe

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjimnazit "Qemal Stafa", Tiranë
 Tel: +355 (0) 222-13423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	peshën e secilës pjesë për vlerësimin përfundimtar. Kjo qasje siguron një monitorim të vazhduar të përparimit të studentëve dhe krijon një lidhje funksionale midis mësimdhënies dhe rezultateve të të nxënit. <i>E.2.1. Syllabuset e lëndëve</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Në raportin e vlerësimit të brendshëm të institucionit thuhet se “sistemet elektronike të testimit dhe vlerësimit janë të aplikueshme shumë rrallë për shkak të profilit të studimit”. Për vet specifikën e këtij program studimi kjo praktikë konsiderohet e pranueshme. <i>Raporti i vlerësimit të brendshëm – MP, Standardi III.3, Kriteri 2, f. 32</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Kriteri konsiderohet i realizuar, pasi vlerësimi përfundimtar i lëndëve realizohet në përputhje me përcaktimet e bëra në syllabus përkatës dhe në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Titullarët e lëndëve respektojnë komponentët e vlerësimit të përcaktuar në syllabus, duke siguruar transparencë, objektivitet dhe trajtim të barabartë të studentëve në procesin e vlerësimit. Kjo u konfirmua edhe nga takimi me studentët gjatë vizitës në institucion. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit “MP ne Gazetari Investigative”</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Kriteri konsiderohet i realizuar, pasi në procesin e vlerësimit parashikohet dhënia e komenteve dhe feedback-ut individual nga titullarët e lëndëve, veçanërisht në rastet e detyrave me karakter analitik apo praktik. Ky feedback ndihmon studentët të kuptojnë pikat e tyre të forta dhe ato që kërkojnë përmirësim, duke e orientuar procesin e tyre të të nxënit drejt arritjes së rezultateve më të mira në të ardhmen. Kjo u konfirmua edhe nga takimi me studentët gjatë vizitës në institucion. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit “MP ne Gazetari Investigative”</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Kriteri konsiderohet i realizuar, duke qenë se njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik zbatojnë masat për parandalimin e plagjiaturës dhe kopjimit, në përputhje me Rregulloren e Programit të Studimit (neni 46) dhe Kodin e Etikës të Universitetit të Tiranës (neni 5). Studentët njoftohen për rëndësinë e integritetit akademik dhe pasojat e shkeljeve, ndërsa përdorimi i mjeteve teknologjike për zbulimin e plagjiaturës mbetet një fushë për përmirësim. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit “MP ne Gazetari Investigative”</i> <i>E.6.10. Kodi i etikës së UT-së.</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale	Ky kriter është i realizuar duke pasur parasysh që procesi i vlerësimit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohet në parimin

bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	e meritës dhe rezultatet komunikohen brenda afateve të përcaktuara nga rregulloret përkatëse të institucionit. Përgjegjësit e njësive akademike garantojnë respektimin e procedurave dhe afateve ligjore.			
	<i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP ne Gazetari Investigative"</i>			
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Institucioni respekton dhe garanton të drejtat e studentëve për të njohur rezultatet e vlerësimit dhe për të kërkuar rishikim në përputhje me dispozitat e statutëve, rregulloreve dhe procedurave përkatëse, duke siguruar kështu një proces të drejtë dhe të hapur për studentët. Gjatë vizitës në institucion studentët konfirmuan se ata njohin të drejtat e tyre për t'u informuar mbi vlerësimet dhe për të kërkuar rivlerësim sipas rregullave institucionale, ndërsa mungesa e ankesave tregon efikasitetin dhe besueshmërinë e këtij procesi.			
	<i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP ne Gazetari Investigative"</i>			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Çdo ankim apo kërkesë për rishikim të vlerësimit trajtohet nga komisionet e parashikuara në rregullore, me një proces të dokumentuar, transparent dhe të arkivuar, që garanton përgjegjshmërinë në trajtimin e shqetësimeve të studentëve. Gjatë vizitës në institucion u evidentua se gjatë viteve të fundit nuk ishte regjistruar asnjë kërkesë apo ankesë.			
	<i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP ne Gazetari Investigative"</i>			
Konkluzione	Programi i studimit përmbush plotësisht standardet e përcaktuara, duke garantuar një proces të organizuar dhe transparent të mësimdhënies, vlerësimit dhe mbështetjes së studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit siguron thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale e shkencore të studentëve përmes një kurrikule bashkëkohore dhe ambicioze. Megjithatë, numri relativisht i ulët i të diplomuarve sugjeron nevojën për intensifikim të strategjive që nxisin përfundimin me sukses të studimeve.
	<i>E.1.8. Plan i mësimor i Programit të Studimit MPG1</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së	Programi garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fusha të ndryshme, përfshirë teknologjinë e informacionit, komunikimin dhe gjuhët e huaja, duke u mbështetur në metodat dhe format e

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit «Qemal Stafa», Tiranë
Tel:+355 (0) 222-13 123

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	ndryshme të mësimdhënies, si seminare, punë laboratorike dhe orë të hapura. <i>E.1.8. Plani mësimor i Programit të Studimit MPGI</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Ky kriter konsiderohet i realizuar. Kompetencat dhe aftësitë që studentët fitojnë gjatë zhvillimit të çdo lënde analizohen dhe vlerësohen në përfundim të saj, nëpërmjet disa instrumenteve. Personeli akademik informon dhe udhëzon studentët lidhur me rëndësinë praktike të këtyre njohurive dhe kërkesat që duhet të plotësojnë për t'u certifikuar me sukses në lëndë. Kjo siguron një lidhje të qartë mes përbajtjes mësimore dhe pritshmërive profesionale. <i>E.6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i> <i>E.6.9. Raporti i vlerësimit të lëndëve nga pyetësi i studentëve</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Mësimdhënia realizohet mbi bazën e zhvillimit të kompetencave praktike dhe teorike, duke përfshirë praktikat profesionale dhe aktivitetet laboratorike që i ofrojnë studentëve mundësi të aplikojnë njohuritë në situata reale. Personeli akademik ka një rol aktiv në udhëheqjen e diskutimeve, nxitjen e punës në grupe dhe stimulimin e mendimit kritik dhe kreativ, duke siguruar një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e aftësive profesionale dhe shkencore. Për më tepër, programi inkurajon bashkëpunimin me institucione partnere dhe organizata jashtë institucionit, duke ofruar mundësi për mobilitet dhe përvojë praktike të zgjeruar. Një infrastrukturë logjistike bashkëkohore, e pajisur me teknologji të avancuar, mbështet në mënyrë efektive procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke krijuar kushte optimale për zhvillimin e kompetencave të studentëve dhe adaptimin ndaj kërkesave të tregut të punës dhe zhvillimeve shkencore bashkëkohore. <i>E.1.8. Plani mësimor i Programit të Studimit MPGI</i> <i>E.3.6. Projektet shkencore të departamentit</i> <i>E.1.9. Marrëveshjet e bashkëpunimit</i>
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, si dhe të ftuar nga departamenti zhvillojnë orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të fundit shkencore dhe teknologjike që lidhen direkt ose indirekt me fushën e studimit, duke kontribuar në azhurnimin e njohurive dhe aftësive të studentëve jashtë programit bazë mësimor. <i>E.1.7. Raport i analizës vjetore të Departamentit</i>
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Institucioni inkurajon dhe mbështet zhvillimin e ideve inovative dhe projekteve kërkimore të avancuara nga studentët, përmes angazhimit në projekte kërkimore shkencore. <i>E.3.6. Projektet shkencore të departamentit</i>

	E.1.9. Marrëveshjet e bashkëpunimit			
Konkluzione	Programi i studimit përmbush standardet duke garantuar zhvillimin e njohurive të thelluara, aftësive profesionale dhe shkencore. Ky program mbështetet në mësimdhënie të bazuar në kompetenca, praktika profesionale, infrastrukturë bashkëkohore dhe përfshirjen aktive të personelit akademik në zhvillimin e studentëve. Promovohen ide inovative dhe angazhim në kërkimin shkencor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe e bën atë publike.	Në përputhje me Nenin 14 të Rregullores së Programit të Studimit, institucioni i arsimit të lartë ka hartuar dhe zbatuar një procedurë të posaçme për realizimin e detyrimeve përmbyllëse, tezën e diplomës (12 ECTS). Këto procedura bëhen të njohura për studentët në mënyrë të qartë dhe transparente, si përmes rregulloreve zyrtare, ashtu edhe në platformën elektronike të institucionit, duke garantuar informim të plotë dhe të barabartë për të gjithë. Një rol të rëndësishëm në këtë proces luan edhe udhëheqësi i diplomës, të cilët mbështesin studentët në përzgjedhjen dhe formulimin e temës, orientimin metodologjik, strukturimin e punimit, analizën e të dhënave dhe përgatitjen për mbrojtje. Në përfundim, ai vlerëson cilësinë e punimit dhe jep miratimin ose jo për paraqitjen e tij para komisionit. Megjithatë, rregullorja e studimit parashikon të drejtën e studentit për të mbrojtur temën edhe në rast se udhëheqësi nuk e miraton versionin përfundimtar. Në këtë rast, është komisioni i diplomës ai që vlerëson përmbajtjen dhe vendos për pranueshmërinë e punimit për mbrojtje, duke respektuar të drejtën e studentit për t'u diplomuar dhe për të përmbyllur ciklin e studimeve. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP ne Gazetari Investigative"</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Strukturat përgjegjëse, në bashkëpunim me personelin akademik, ofrojnë asistencë të vazhdueshme ndaj studentëve në fazën e përgatitjes së detyrimeve përmbyllëse. Udhëzuesit për hartimin e diplomës, dokumentet mbështetëse dhe modelet e vlerësimit janë të aksesueshme dhe shoqërohen me mbështetje individuale nga pedagogët udhëheqës.

	E.3.3. Material udhëzues për punimin e tezës
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Në programin e studimit Master Profesional në Gazetari Investigative, nuk parashikohet provimi përfundimtar, por detyrimi përmbyllës realizohet përmes mbrojtjes së tezës së diplomës, e cila përfaqëson një punim profesional dhe kërkimor të studentit në përputhje me profilin praktik të këtij cikli studimi. Administrimi i procesit të mbrojtjes realizohet nga një komision i posaçëm i ngritur sipas rregullores së studimeve, i cili vlerëson njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e fituara nga studenti gjatë gjithë ciklit të studimeve, bazuar në përmbajtjen e temës, cilësinë e analizës, zbatimin e njohurive profesionale dhe nivelin e përgatitjes për tregun e punës. Ky proces respekton standardet akademike dhe rregulloret institucionale, duke siguruar një vlerësim objektiv dhe gjithëpërfshirës të performancës përfundimtare të studentit.
	E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP ne Gazetari Investigative"
Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Udhëheqësi i punimit të diplomës orienton studentët në përzgjedhjen e temës, strukturimin e përmbajtjes, kërkimin dhe përpunimin e të dhënave. Gjithashtu, ndihmon studentët në zhvillimin e aftësive analitike dhe kritike, duke i inkurajuar ata të përdorin metoda kërkimore të përshtatshme dhe burime të besueshme. Udhëheqësi garanton cilësinë akademike të punimit përmes konsultimeve të rregullta dhe vetëm pas vlerësimit të përmbajtjes dhe rezultateve lejon ose jo kalimin për mbrojtje.
	E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP ne Gazetari Investigative"
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Në përputhje me natyrën dhe kërkesat e temave të diplomës, institucioni i arsimit të lartë ofron mbështetje të vazhdueshme logjistike dhe teknike për studentët në fazën e realizimit të kërkimeve, analizave, matjeve dhe testeve të nevojshme. Kjo mbështetje sigurohet si brenda ambienteve të institucionit, të pajisura me infrastrukturë bashkëkohore, laboratorë funksionalë dhe mjete teknologjike moderne, ashtu edhe në bashkëpunim me institucione të tjera publike ose private, në varësi të profilit të kërkimit. Përmes kësaj strukture të zhvilluar mbështetëse, krijohen kushte optimale për zhvillimin e kërkimit aplikativ, si dhe për realizimin cilësor të detyrimeve përmbyllëse, në përputhje me objektivat akademike të programit të studimit.
	E.4.5. Infrastruktura në funksion të programit të studimit
	E.1.9. Marrëveshjet e bashkëpunimit
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të	Në përfundim të mbrojtjes së punimit të diplomës studenti vlerësohet me notë sipas kriterëve të përcaktuara në rregullore.

mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Procesi i vlerësimit është i dokumentuar dhe i bazuar në performancën akademike dhe përmbajtjen e paraqitur.			
	<i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP në Gazetari Investigative"</i>			
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Pas përfundimit me sukses të programit të studimit, institucioni pajis studentin me diplomën përkatëse dhe suplementin e diplomës në përputhje me formatet zyrtare të miratuara nga Ministria e Arsimit. Studentit i vihet gjithashtu në dispozicion një kopje zyrtare e listës së notave.			
	<i>E.3.5. Formati i diplomës MP në "Gazetari Investigative" dhe suplementi i saj</i>			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Institucioni respekton legjislacionin në fuqi për arkivimin dhe ruajtjen e dokumentacionit të studentëve. Të dhënat e detyrimeve përmbyllëse, si dhe vlerësimet, ruhen në formë fizike dhe paraqiten në rastet kur kërkohen nga studentët ose autoritetet përkatëse.			
	<i>E.1.3. Rregullore e UT-së</i> <i>E.4.3. Rregulla të sekretarisë mësimore</i>			
Konkluzione	<i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson se institucioni garanton mbështetje akademike, teknike dhe procedurale për realizimin e detyrimeve përmbyllëse, duke siguruar cilësi dhe infrastrukturë të përshtatshme për studentët.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit është Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, i cili garanton realizimin e praktikave laboratorike dhe profesionale në ambiente bashkëkohore brenda institucionit, si laboratorët e specializuar dhe studiot e medias, por edhe jashtë tij, nëpërmjet marrëveshjeve bashkëpunimi me institucione partnere. DGK disponon një infrastrukturë logjistike bashkëkohore, përfshirë 5 atelie fizike me kushte moderne, që sigurojnë zhvillimin optimal të praktikave profesionale dhe laboratorike për studentët.
	<i>E.4.5. Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i> <i>E.1.9. Marrëveshjet e bashkëpunimit</i>
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet,	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit ka krijuar partneritete të qëndrueshme me institucione publike dhe private,

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit "Qemal Stafa", Tiranë
Tel: +355 (0) 222-13-123

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	duke mundësuar zhvillimin e praktikave profesionale me teknologji bashkëkohore dhe standarde të larta profesionale. Praktikant synojnë përfitimin sa më të mirë të njohurive, zhvillimin e kompetencave dhe përgatitjen për tregun e punës.			
Kriteri 3. Praktikant profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	<i>E.1.9. Marrëveshjet e bashkëpunimit</i>			
	Në programin e masterit profesional në gazetari investigative, praktikant profesionale dhe stazhet integrohen si pjesë thelbësore e moduleve dhe lëndëve përkatëse, pa konvertim në kredi ECTS. Kjo praktikë është e rëndësishme sepse ofron përvojë direkte në terren, duke i mundësuar studentit të zhvillojë aftësi praktike dhe etike në investigimin dhe raportimin e ngjarjeve. Gjithashtu, ndihmon në ndërtimin e rrjetit profesional dhe përgatit studentët për sfidat reale të medias dhe gazetarisë investigative.			
Konkluzione	<i>E.1.8. Plan i mësimor i Programit të Studimit MPG</i>			
	Programi i studimit në Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit përmbush me sukses standardet e kërkuara për realizimin e praktikave laboratorike dhe profesionale. Njësia bazë siguron ambiente të përshtatshme dhe infrastrukturë bashkëkohore, duke ofruar mundësi të shumta për zhvillimin e kompetencave praktike të studentëve. Bashkëpunimi me institucione partnere përforcon më tej cilësinë dhe relevancën profesionale të praktikave, duke garantuar përgatitje të mirëfilltë për tregun e punës dhe zhvillimin profesional të studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se stafi akademik dhe ndihmës akademik i përfshirë në

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit "Qemal Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	programin e studimit Master Profesional në “Gazetari Investigative” plotëson standardet ligjore në fuqi përsa i përket nivelit të kualifikimit dhe përputhjes së tij me fushën e ekspertizës, natyrën dhe specifikat e moduleve të programit. Në zbatimin e këtij programi janë të përfshirë 17 pedagogë (efektivë dhe me kontratë) dhe 1 ndihmës akademik. Departamenti, si njësi bazë, dokumenton dhe menaxhon informacionin mbi kualifikimet, fushat e specializimit, titujt akademikë, gradat shkencore dhe përvojën profesionale apo kërkimore të stafit, duke garantuar shpërndarjen e përshtatshme të moduleve në përputhje me profilin e çdo pedagogu. Gjithashtu, ai koordinon dhe dokumenton ndarjen e ngarkesës mësimore dhe pjesëmarrjen e stafit në veprimtari të tjera akademike gjatë vitit, duke e përcjellë këtë informacion në mënyrë të rregullt pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore, apo organeve të tjera kur kërkohet. Zyra e Burimeve Njerëzore merret me administrimin e procedurave të rekrutimit, përgatitjes së kontratave dhe verifikimit të përmbushjes së kriterëve ligjore për përfshirjen e stafit akademik dhe ndihmës akademik, në përputhje me kuadrin ligjor të arsimit të lartë dhe standardet përkatëse të cilësisë. <i>E.2.2.a. Lista e PAE dhe personeli i angazhuar ne program</i> <i>E.2.2. CV e stafit akademik me kohë të plotë të angazhuar në programin e studimit MPGI</i> <i>E.2.2.b. Lista dhe CV e stafit akademik me kohë të pjeshme të angazhuar në MPGI</i> <i>E.4.1. Rregulla të Zyrës së Burimeve Njerëzore, FHF</i> <i>E.4.2. Format i Dosjes personale të stafit akademik</i> <i>E.4.6. Manuali për punësimin e stafit të UT-së</i>
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Bazuar në evidencën E.1.8. Plani mësimor i Programit të Studimit MPGI miratuar nga Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit dhe i dorëzuar në instancat përkatëse për miratim, rezulton se programi është hartuar dhe strukturuar në përputhje me standardet akademike dhe kornizën ligjore në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë. Plani mësimor parashikon shpërndarjen e ngarkesës prej 60 kreditesh ECTS të ndara në mënyrë të balancuar përgjatë 1 viti akademik dhe është hartuar nga një grup pune i specializuar, i përbërë nga staf akademik me kompetenca profesionale në fushën e gazetarisë dhe komunikimit. Mbulimi i ngarkesës mësimore realizohet në përputhje me kornizën ligjore dhe kërkesat institucionale për përbërjen e stafit. Nga 17 pedagogët e angazhuar në programin e studimit, 14 janë staf efektiv dhe 3 staf me kontratë. Pra, rreth 82% e lëndëve të programit mbulohen nga stafi i brendshëm efektiv, e cila garanton qëndrueshmërinë e programit të studimit.



	Stafi me kontratë përfshin gazetarë dhe ekspertë të njohur të medias, me përvojë të thelluar dhe profesionale në fushën e gazetarisë investigative, si Anila Hoxha, Aleksandara Bogdani, Vladimir Karaj të cilët sjellin ekspertizë praktike dhe njohuri të avancuara në program. <i>E.1.8. Plan i mësimor i Programit të Studimit MPGI</i> <i>E.2.2.a. Lista e PAE dhe personeli i angazhuar në program</i> <i>E.2.2.b. Lista dhe CV e stafit akademik me kohë të pjeshme të angazhuar në MPGI</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Institucioni siguron qëndrueshmëri të stafit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit. Sipas të dhënave zyrtare të administruara nga Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit dhe Zyra e Burimeve Njerëzore në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë, rezultojnë se pjesa më e madhe e personelit që realizon këtë program përbëhet nga staf efektiv (82%), me marrëdhënie të rregullta pune, në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe me aktet normative të brendshme të UT-së. Kontratat e punës janë të rregullta, të dokumentuara dhe garantojnë të gjitha të drejtat ligjore të stafit, kontributojnë në sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Menaxhimi i marrëdhënieve të punës kryhet nga Zyra e Burimeve Njerëzore, e cila përditëson të dhënat për çdo anëtar të stafit akademik dhe ndihmës akademik. <i>E.4.1. Rregulla të Zyrës së Burimeve Njerëzore, FHF</i> <i>E.4.2. Format i Dosjes personale të stafit akademik</i> <i>E.4.6. Manuali për punësimin e stafit të UT-së</i> <i>E.2.2.a. Lista e PAE dhe personeli i angazhuar në program</i> <i>E. 2.4. Model kontrate PAE, kategoria 'Profesor'</i> <i>E.2.5 Model kontrate PAK</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedurë rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Institucioni zbaton procedurë të qarta dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e stafit akademik, të cilat bazohen në kritere të përgjithshme dhe të veçanta, të publikuara dhe të përshtatura me karakteristikat dhe përmbajtjen e programit të studimit MPGI. Procesi i punësimit dhe përzgjedhjes së stafit akademik zhvillohet në përputhje me Manualin për punësimin e stafit akademik të Universitetit të Tiranës, si dhe me Rregulloren e Zyrës së Burimeve Njerëzore në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë. Këto dokumente përcaktojnë në mënyrë të qartë procedurat për hapjen e vendeve të punës, kriteret e përzgjedhjes, përbërjen e komisioneve vlerësuese dhe dokumentacionin e nevojshëm në çdo fazë të procesit të rekrutimit. Gjithashtu, neni 13 i Rregullores së Programit Master Profesional në "Gazetari Investigative" përcakton kriteret e përgjithshme dhe

	specifike për staf akademik, duke përfshirë kërkesat për nivelin e kualifikimit dhe përvojën si specialist në fushën përkatëse, si dhe përputhshmërinë me natyrën akademike dhe praktike të gazetarisë investigative dhe me strukturën dhe përmbajtjen e moduleve të programit. Rregullorja siguron kushtet e duhura për punësimin e çdo anëtari të stafit në këtë program. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP në Gazetari Investigative"</i> <i>E.4.1. Rregulla të Zyrës së Burimeve Njerëzore, FHH</i> <i>E.4.6. Manuali për punësimin e stafit të UT-së</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Institucioni garanton angazhimin e ndihmës akademike në mënyrë të përshtatshme për realizimin e komponentëve praktikë të programit, duke respektuar natyrën aplikative të tij dhe kërkesat që rrjedhin nga lëndët me përmbajtje laboratorike dhe praktika profesionale. Neni 15 i Rregullores përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e personelit ndihmës akademik (laboranti i departamentit). Sipas nenit 9 të Rregullores së programit, për çdo laborator mediatik (atelie) emërohet një pedagog përgjegjës, i cili ndjek dhe mbikëqyr nga afër zhvillimin e veprimtarive mësimore dhe praktikave në mjedise të specializuara. Në funksion të mirëorganizimit të programit të studimit personeli ndihmës akademik me karakter mësimor asiston stafin akademik në përmbushje të detyrave funksionale. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP në Gazetari Investigative"</i> <i>E.2.2.a. Lista e PAE dhe personeli i angazhuar në program</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Institucioni garanton mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e rregullt të të dhënave të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ të angazhuar në programin e studimit MPGI, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe me standardet e menaxhimit administrativ në arsimin e lartë. Zyra e Burimeve Njerëzore në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë mban dhe administron dosje individuale për çdo anëtar të stafit të angazhuar në program, pavarësisht nëse janë me kohë të plotë apo të pjesshme. Këto dosje përmbajnë informacion të plotë mbi nivelin e arsimimit, kualifikimet akademike dhe shkencore, publikimet, informacionin shëndetësor të nevojshëm, vlerësimet nga studentët, kontratat e punës në vite dhe të dhëna të tjera që lidhen me statusin profesional dhe institucional të stafit. Fillimisht, të dhënat për personelin mbledhen dhe përpunohen në nivel departamenti nga Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit (njësia bazë) dhe më pas përcillen në Zyrën e Burimeve Njerëzore të fakultetit për administrim të centralizuar dhe të dokumentuar.

	Gjatë vizitës në institucion dhe takimeve me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi se dokumentacioni për personelin është i plotë dhe i mirëstrukturuar. Nga përzgjedhja rastësore e disa dosjeve të stafit akademik (PAE dhe PAK), u verifikua se ato përmbajnë të gjithë elementët e nevojshëm dhe përmbushin standardet ligjore e institucionale. Për më tepër, në Rregulloren e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë janë përcaktuar qartë kriteret e nivelit të kualifikimit që duhet të plotësojë stafi akademik për t'u angazhuar në këtë program, duke ndihmuar kështu në sigurimin e cilësisë dhe përputhshmërisë me natyrën e lëndëve dhe objektivat mësimorë. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP në Gazetari Investigative"</i> <i>E.4.1. Rregulla të Zyrës së Burimeve Njerëzore, FHF</i> <i>E.4.2. Format i Dosjes personale të stafit akademik</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e injaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit garanton angazhimin e personelit të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikat profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera të lidhura ngushtë me natyrën specifike të programit. Institucioni ka një rrjet të gjerë bashkëpunimi të formalizuar përmes 15 marrëveshjeve me institucione mediatike, autoritete rregullatore dhe aktorë të sektorit të komunikimit dhe medias, të cilat mundësojnë integrimin praktik të studentëve në ambiente profesionale. Ndër këto bashkëpunime spikat marrëdhënia e konsoliduar shumëvjeçare me Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA), e cila është materializuar në një sërë projektesh kërkimore, monitoruese dhe zhvillimore në fushën e politikave mediatike, dixhitalizimit, cilësisë së transmetimeve, audiencave dhe sfidave të epokës post-digjitale. Këto projekte janë realizuar në mënyrë të vazhdueshme nga DGK me mbështetje financiare dhe teknike nga AMA, OSBE, Bashkimi Evropian, UNDP dhe partnerë të tjerë institucionalë. Në kuadër të këtyre bashkëpunimeve, studentët përfshihen në mënyrë aktive në projekte kërkimore dhe praktika profesionale të udhëhequra nga staf i specializuar i departamentit dhe nga profesionistë të jashtëm të fushës. Gjithashtu, marrëveshjet përfshijnë angazhimin e institucioneve pritëse në mbikëqyrjen dhe mentorimin e studentëve gjatë praktikës, në përputhje me objektivat e modulit përkatës. Ky rrjet bashkëpunimi kombëtar dhe ndërkombëtar, i shoqëruar me një strukturë të mirëpërcaktuar të përfshirjes së personelit të kualifikuar, garanton një mbështetje të plotë dhe efektive për zhvillimin profesional të studentëve dhe për përmbushjen e

	objektivave të programit të studimit, në përputhje me standardet akademike dhe nevojat e tregut të punës. Duhet nënvizuar se edhe pse institucioni gëzon një marrëdhënie të konsoliduar bashkëpunimi me Autoritetin e Mediave Audiovizive (AMA), mund të rishikohet dhe të zgjerohet gama e bashkëpunimeve me aktorë të tjerë institucionalë, përfshirë agjencitë e pavarura të komunikimit, organizatat jofitimprurëse dhe partnerë ndërkombëtarë në fushën e gazetarisë dhe komunikimit.			
	<i>E.1.9. Marrëveshjet e bashkëpunimit</i>			
Kriteri 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Për realizimin e këtij kriteri, Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit ka raportuar se të gjitha lëndët e përfshira në programin e studimit ofrojnë mundësi praktike për studentët. Për më tepër, marrëveshjet e lidhura nga departamenti me institucione të ndryshme publike dhe private sigurojnë mundësinë e zhvillimit të praktikave profesionale në këto ambiente. Megjithatë, pavarësisht vlerësimit pozitiv të këtyre aspekteve shihet e nevojshme që DGK të përforcojë dokumentimin me evidenca konkrete mbi rolin dhe angazhimin e personelit mbikëqyrës në ambientet pritëse, veçanërisht në ndihmën që ofrohet për studentët gjatë përmbushjes së detyrimeve.			
	<i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP në Gazetari Investigative"</i> <i>E.1.9. Marrëveshjet e bashkëpunimit</i>			
Konkluzione	<i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, mbi bazën e dokumentacionit, intervistave dhe verifikimeve në terren, konstaton se programi i studimit Master Profesional në Gazetari Investigative përmbush në mënyrë të plotë Standardin IV.1. Personeli akademik është i mjaftueshëm në numër, me kualifikime të përshtatshme akademike dhe profesionale, duke garantuar zhvillimin cilësor dhe të qëndrueshëm të procesit mësimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Asnjë përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën	Mjediset fizike dhe laboratorike përbëjnë një nga pikat më të forta të programit të studimit Master Profesional në "Gazetari Investigative". Institucioni ofron ambiente të dedikuara dhe funksionale, të përshtatura për natyrën teorike dhe praktike të moduleve të programit. Hapësirat përfshijnë auditorë, laboratorë

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit "Qemal Stafa", Tiranë
Tel: +355 (0) 222-13423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	multimedialë dhe të radios, si dhe një “open media lab” modern, të pajisur me teknologji bashkëkohore për zhvillimin e praktikave profesionale dhe trajnimeve të avancuara në fushën e gazetarisë investigative. Këto kapacitete infrastrukturore jo vetëm që mbështesin në mënyrë të qëndrueshme procesin mësimor, por kontribuojnë ndjeshëm edhe në përgatitjen praktike dhe profesionale të studentëve, duke përmbushur në mënyrë të plotë standardin përkatës. <i>E.4.5. Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i>
Kriteri 2. Mjediset mesimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit zotëron një infrastrukturë laboratorike të specializuar dhe të mirëpajisur, që përfaqëson një nga pikat kyçe të forta të programit të studimit “Master Profesional në Gazetari Investigative”. Labororët e dedikuar për gazetari dhe media janë të pajisur me kompjuterë modernë, softuerë profesionalë për redaktim dhe prodhim audio-viziv, kamera dhe mikrofona të nivelit profesional, pajisje regjistrimi si dhe serverë të dedikuar për ruajtjen dhe menaxhimin e materialeve mediatike. Veçanërisht, Laboratori Media Lab ofron kabina izolimi akustik dhe stacione pune të konceptuara për të simuluar mjedisin real të një redaksie, duke mundësuar një proces mësimor praktik, të orientuar drejt prodhimit të përmbajtjes cilësore. Këto ambiente mbështesin lëndë me përmbajtje të theksuar praktike. Auditorët dhe klasat janë të pajisura me mjete digjitale interaktive dhe teknologji për leksione të asistuar, duke mundësuar zhvillimin e mësimdhënies moderne dhe ndërvepruese. Gjithashtu, përdorimi i platformave online, si Microsoft Teams, mbështet mësimin në distancë dhe komunikimin në kohë reale, duke lehtësuar ndarjen e materialeve, sidomos në lëndët me komponentë kërkimorë dhe bashkëpunues. Kjo infrastrukturë teknologjike e avancuar krijon një përvojë të plotë mesimore për studentët dhe garanton zhvillimin e kompetencave të domosdoshme për sfidat e gazetarisë investigative në një mjedis mediatik gjithnjë e më të digjitalizuar. <i>E.4.5. Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i> <i>E.2.9. Manual përdorimi i sistemit Teams – Clean Score</i> <i>E.2.10. Manual përdorimi i sistemit e-Student</i>
Kriteri 3. Labororët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm ka evidentuar se Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit (DGK) disponon laboratorë të specializuar dhe të teknologjizuar, të konceptuar për të mbuluar një gamë të gjerë aftësish profesionale në fushën e gazetarisë dhe medias, në përputhje me natyrën praktike dhe kërkesat bashkëkohore të programit të studimit. Këto përfshijnë:

objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	→ Laboratorin e Radios, të pajisur me mikrofona profesionale, miksera zëri, pajisje regjistrimi dhe transmetimi, që i shërbejnë zhvillimit të moduleve të gazetarisë radiofonike, teknikave të komunikimit vokal dhe edukimit të zërit. → Media Lab-in multimedial, një hapësirë dinamike e pajisur me kompjuterë të fuqishëm dhe softuer profesional si Adobe Premiere, Audacity, Photoshop, që mbështesin prodhimin audio-viziv, montazhin dhe dizajnin grafik. Ky laborator përfshin gjithashtu kamera profesionale, pajisje ndriçimi dhe mjete për prodhim përmbajtjeje vizuale, të përshtatura për realizimin e projekteve praktike në fushën e gazetarisë vizuale dhe rrjeteve sociale. → Laboratorët e përgjithshëm të gazetarisë dhe komunikimit, të pajisur me stacione pune kompjuterike me akses të plotë në internet, të cilët shërbejnë për zhvillimin e moduleve që përfshijnë gazetarinë e shkruar, gazetarinë digjitale, teknikat e avancuara të shkrimit dhe raportimit për media të ndryshme. Të gjitha këto mjedise janë të strukturuar në mënyrë funksionale dhe favorizojnë punën individuale dhe në grup, duke imituar realitetin profesional të redaksive mediatike. Pajisjet dhe teknologjitë e përfshira janë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe kërkesat e tregut të medias, duke siguruar zhvillimin e kompetencave praktike dhe përmbushjen e objektivave formues të programit në mënyrë efektive dhe bashkëkohore. <i>E.4.5. Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Institucioni i arsimit të lartë garanton infrastrukturën e nevojshme për mbështetjen teknologjike të procesit mësimor dhe praktik. Në funksion të natyrës së programit të studimit “Master Profesional në Gazetari Investigative”, DGK ka në përdorim laboratorë të teknologjisë së informacionit të pajisur me kompjuterë bashkëkohorë dhe programe profesionale, si dhe mjete të tjera që përputhen me kërkesat e moduleve për redaktim audio-viziv, dizajn grafik dhe gazetari digjitale. Kjo infrastrukturë lejon realizimin e moduleve praktike dhe nxit përvetësimin e aftësive teknologjike të domosdoshme në profesionin e gazetarit. <i>E.4.5. Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të	institucioni garanton zhvillimin e praktikave profesionale, brenda dhe jashtë institucionit, në përputhje me natyrën aplikative të programit të studimit. DGK ka ndërtuar dhe ka marrëdhënie të konsoliduara bashkëpunimi me një sërë institucionesh dhe

bashkëpunimit), që mjediset janë të njafueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.	mediash publike e private të formalizuara përmes marrëveshjeve të posaçme. Këto bashkëpunime mundësojnë kryerjen e praktikave profesionale në ambiente të përshtatura dhe nën mbikëqyrjen e gazetarëve profesionistë. Kjo formë e integruar e praktikës forcon lidhjen midis formimit akademik dhe kërkesave të tregut të punës, duke ndikuar drejtpërdrejt në zhvillimin e kompetencave profesionale të studentëve. <i>E.4.5. Infrastruktura në funksion të programit të studimit</i> <i>E.1.9. Marrëveshjet e bashkëpunimit</i>			
Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë garanton mjedise funksionale dhe infrastrukturë të përshtatshme në përputhje me natyrën profesionale dhe praktike të programit të studimit Master Profesional në Gazetari Investigative. Ambientet përfshijnë laboratorë të specializuar, studio mediatike dhe hapësira interaktive të pajisura me teknologji bashkëkohore, të cilat mbështesin në mënyrë të plotë zhvillimin e procesit mësimor dhe formimin praktik të studentëve, duke përmbushur standardin përkatës plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Institucioni i arsimit të lartë garanton aksesin e studentëve të programit Master Profesional në Gazetari Investigative në literaturën bazë dhe ndihmëse, si në formë fizike ashtu edhe digjitale, në gjuhën shqipe dhe të huaj, në përputhje me objektivat akademike të programit dhe me natyrën kërkimore e praktike të lëndëve. Biblioteka e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, si një nga bibliotekat universitare më të pasura në vend, ofron një koleksion të gjerë prej mbi 51.000 tituj librash dhe 400 tituj periodikësh, duke mbuluar fusha kyçe si gazetaria, komunikimi, etika mediatike, e drejta e informimit, marrëdhëniet me publikun, sociologjia, dhe shkencat politike. Literatura e përzgjedhur për programin e masterit përfshin botime të autorëve vendas dhe të huaj, manuale profesionale dhe përmbledhje akademike që ndihmojnë studentët në ndjekjen e moduleve praktike dhe teorike, si dhe në përgatitjen e punimit përmbyllës të diplomës. Biblioteka është pjesë e rrjetit COBISS.Net, duke u ofruar studentëve akses online në katalogun elektronik dhe mundësi të avancuara për kërkimin bibliografik.

	Për më tepër, mjediset e bibliotekës përfshijnë një sallë leximi me mbi 70 vende, fonde të hapura dhe staf të specializuar që asistojnë studentët dhe pedagogët në orientimin akademik. <i>E.3.1. Fondi i bibliotekës FHF</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, si njësi përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional në Gazetari Investigative, zotëron akses në një infrastrukturë të pasur bibliografike dhe digjitale që mbështet procesin e formimit akademik dhe profesional të studentëve. Përmes bashkëpunimit me Bibliotekën e Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, si dhe sistemeve të integruara si COBISS.Net dhe katalogut elektronik, studentëve dhe stafit u mundësohet konsultimi me një gamë të gjerë literaturash në fushën e gazetarisë dhe komunikimit, si në gjuhën shqipe ashtu edhe të huaj. Gjithashtu, studentët kanë në dispozicion biblioteka digjitale dhe motorë kërkimi akademik si Albanian Academic Research Engine, JSTOR, Rosetta Stone dhe Biblioteka Virtuale e Shqipërisë, të cilat përbëjnë një aset të rëndësishëm për përvetësimin e njohurive bashkëkohore dhe zhvillimin e punës kërkimore. Megjithatë, pavarësisht këtij potenciali, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se njësia përgjegjëse nuk ka dokumentuar evidenca konkrete mbi përditësimin sistematik të literaturës së përdorur në këtë program, veçanërisht në lidhje me përfshirjen e botimeve të viteve të fundit. Kjo mungesë evidencash reflektohet edhe në syllabuset e moduleve, ku literatura e rekomanduar nuk është e azhurnuar sipas zhvillimeve më të fundit në fushën e gazetarisë investigative. Për të garantuar një përpunje të vazhdueshme me standardet akademike dhe nevojat e tregut të punës, pas kërkesës së Grupit të Vlerësimit të Jashtëm, Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit përcolli evidenca shtesë në sistemin AMS ku evidentohet përditësimi i literaturës bashkëkohore me botime të reja shkencore të viteve të fundit. <i>E.3.1. Fondi i bibliotekës FHF</i> <i>E.2.1. Syllabuset e lëndëve</i> <i>Evidencë shtesë – Syllabuset e lëndëve të programit "MP në Gazetari Investigative"</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Institucioni i arsimit të lartë garanton aksesin e plotë dhe të barabartë për të gjithë studentët e programit të studimit Master Profesional në Gazetari Investigative në bibliotekën mësimore, e cila përbën një burim të rëndësishëm për mbështetjen e procesit akademik dhe të kërkimit shkencor. Biblioteka e Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, si një nga bibliotekat më të mëdha universitare në vend, është e hapur për të

	gjithë studentët e programit, pavarësisht formës së ndjekjes së studimeve. Aksesueshmëria dhe funksionaliteti i saj i përgjigjen nevojave të studentëve të nivelit master, duke ofruar mjedis të përshtatshëm për punë individuale dhe kërkim të avancuar. <i>E.3.1. Fondi i bibliotekës FHF</i> <i>E.3.2. Rregullore e Bibliotekës</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e njaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të njaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Institucioni i arsimit të lartë, përmes Bibliotekës së Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, garanton një fond fizik të pasur dhe të përshtatur me nevojat akademike të programit të studimit Master Profesional në Gazetari Investigative. Ky fond përfshin tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, botime shkencore dhe revista profesionale në gjuhën shqipe dhe të huaj, të përzgjedhura për të mbuluar veprimtaritë mësimore dhe kërkimore të lidhura me natyrën e specializuar të programit. Fondi i bibliotekës përfshin mbi 51,000 tituj librash dhe rreth 400 tituj periodikësh që trajtojnë fusha të rëndësishme për gazetarinë investigative si: media dhe komunikimi, gazetaria hulumtuese, e drejta e informimit, etika e medias, sociologjia, politika, historia bashkëkohore, teknologjia e informacionit dhe kultura bashkëkohore. Studentët dhe pedagogët kanë akses në këto materiale përmes sallës së leximit me fonde të hapura, si dhe përmes mundësisë së huazimit për përdorim studimor. Në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm, GVJ sugjeron forcimin e mekanizmave të bashkëpunimit ndërmjet departamentit dhe bibliotekës, me qëllim që procesi i përzgjedhjes së literaturës të bëhet më efektiv dhe në përputhje me nevojat akademike. <i>E.3.1. Fondi i bibliotekës FHF</i> <i>E.3.2. Rregullore e Bibliotekës</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Institucioni i arsimit të lartë, në funksion të mbështetjes së programit Master Profesional në Gazetari Investigative, garanton akses të barabartë dhe pa pagesë për të gjithë studentët në bibliotekat online dhe burimet digjitale, të cilat mbulojnë në mënyrë të plotë fushat përkatëse të gazetarisë investigative, etikës së medias, komunikimit publik, të drejtës së informimit dhe shkencave sociale. Studentët kanë në dispozicion Bibliotekën Digjitale të Universitetit të Tiranës, e cila ofron materiale akademike dhe kërkimore të përditësuar, në gjuhën shqipe dhe të huaj, të aksesueshme në çdo kohë përmes lidhjes institucionale. Po ashtu, ata përfitojnë pa pagesë akses në një sërë platformash të mirënjohura dhe katalogësh elektronikë si: JSTOR, Albanian Academic Research Engine, Biblioteka Virtuale e Shqipërisë, dhe sistemi COBISS.Net, të cilat ofrojnë literaturë të specializuar në fushat që lidhen drejtpërdrejt me programin.

	Përdorimi i këtyre burimeve nuk ka kosto për studentët dhe përbën një komponent thelbësor të procesit të mësimnxënies dhe përgatitjes akademike në këtë program. Informacioni mbi platformat digjitale dhe mënyrën e përdorimit të tyre u komunikohet studentëve në fillim të vitit akademik, gjatë javës së orientimit dhe përforcohet në mënyrë të vazhdueshme nga stafi pedagogjik dhe biblioteka, përmes seminareve praktike dhe udhëzimeve teknike. <i>E.3.1. Fondi i bibliotekës FHH</i> <i>E.3.2. Rregullore e Bibliotekës</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka e Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, në funksion të mbështetjes së programit Master Profesional në Gazetari Investigative, është e pajisur me infrastrukturën teknike dhe teknologjike të nevojshme, duke garantuar akses të lirë, të barabartë dhe pa kufizim për të gjithë studentët e këtij programi. Biblioteka disponon pajisje kompjuterike funksionale të dedikuara për kërkime bibliografike, konsultimin e katalogut elektronik dhe përdorimin e burimeve digjitale të njohura, të cilat përfshijnë literaturë shkencore dhe profesionale në gjuhën shqipe dhe të huaj. Pajisjet janë të vendosura në ambientet e bibliotekës dhe janë të aksesueshme gjatë gjithë orarit zyrtar të saj, për të gjithë përdoruesit, pa dallim. Gjithashtu, infrastruktura mbështetëse përfshin rrjetin Wi-Fi, sistemin e ndriçimit, ajrosjes dhe ngrohjes, të përmirësuar pas rikonstruksionit të vitit 2014, duke krijuar një mjedis të përshtatshëm për punë akademike individuale apo në grup. <i>E.3.1. Fondi i bibliotekës FHH</i> <i>E.3.2. Rregullore e Bibliotekës</i>
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Orari i funksionimit të bibliotekës është i përcaktuar qartë, i përditësuar rregullisht dhe i afishuar në mënyrë të dukshme për studentët, duke siguruar informim të vazhdueshëm. Hapësirat dhe shërbimet që ofron biblioteka janë të organizuara në mënyrë të tillë që garantojnë mundësi të barabarta për të gjithë studentët për të përfituar nga fondi bibliotekar. <i>E.3.1. Fondi i bibliotekës FHH</i> <i>E.3.2. Rregullore e Bibliotekës</i>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe	Në përputhje me Nenin 17 të Rregullores së Bibliotekës, stafi bibliotekar është përgjegjës për hartimin dhe përditësimin e listës së literaturës për pasurimin e fondit, duke u mbështetur në kërkesat dhe nevojat e përdoruesve, përfshirë studentët dhe pedagogët e programit të studimit Master Profesional në Gazetari Investigative. Biblioteka monitoron dhe raporton rregullisht mbi cilësinë, përditësimin dhe shkallën e shfrytëzimit të fondit ekzistues, si fizik

studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	ashtu edhe digjital, duke përfshirë aksesin në salla studimi dhe përdorimin e platformave akademike. Pasurimi i fondeve realizohet nëpërmjet blerjeve të planifikuara, donacioneve dhe bashkëpunimit të drejtpërdrejtë me stafin akademik për përzgjedhjen e titujve të rinj, në përputhje me zhvillimet bashkëkohore në fushën e gazetarisë hulumtuese. Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit të vijojë dokumentimin e bashkëpunimit të tij me bibliotekën, me synim forcimin e mëtejshëm të mbështetjes bibliografike për programin. Një rishikim i rregullt i literaturës bazë dhe ndihmëse në përputhje me përmbajtjen e moduleve do të ndihmonte në identifikimin e fushave që mund të pasurohen më tej, duke siguruar akses të plotë në burimet akademike, si në formën fizike, ashtu edhe në atë digjitale, që u përgjigjen kërkesave specifike të këtij cikli studimesh. <i>E.3.2. Rregullore e Bibliotekës</i>			
Konkluzione	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se programi i studimit Master Profesional në Gazetari Investigative është mbështetur me një infrastrukturë të përshtatshme për mësimdhënie dhe mësimnxënie, përfshirë mjedise funksionale të posaçme dhe bibliotekën e institucionit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Programi i studimit Master Profesional në Gazetari Investigative funksionon në kuadër të sistemit të menaxhimit institucional të Universitetit të Tiranës, i cili garanton një administrim të integruar dhe të strukturuar të informacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre akademik, nga regjistrimi deri në diplomim. Universiteti i Tiranës përdor platformën Microsoft Office 365 Education, veçanërisht aplikacionin Microsoft Teams, si mjet digjital mbështetës në procesin mësimor. Pedagogët krijojnë grupe specifike për çdo modul të programit, duke u ofruar studentëve mundësinë për të komunikuar drejtpërdrejt me mësimdhënësit dhe kolegët, për të ndarë materiale mësimore, për të marrë detyra dhe për të ndjekur leksione dhe diskutime online përmes funksioneve interaktive si chat, video-call dhe ndarja e dokumenteve. Ndërkohë, sistemi elektronik "e-Student" mundëson administrimin e të dhënave akademike dhe financiare të studentëve. Ky sistem, i

	aksesueshëm përmes kredencialeve të platformës e-Albania, u lejon studentëve të programit të regjistrohen në provime, të ndjekin notat dhe historikun akademik, të dorëzojnë kërkesa administrative dhe të verifikojnë të dhënat për pagesat dhe tarifat e studimit. <i>E.2.9. Manual përdorimi i sistemit Teams – Clean Score</i> <i>E.2.10. Manual përdorimi i sistemit e-Student</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Administrimi i informacionit, dokumentacionit dhe aktivitetit të personelit akademik, ndihmësakademik dhe administrativ që kontribuon në realizimin e programit Master Profesional në Gazetari Investigative realizohet nëpërmjet sistemit të brendshëm të menaxhimit të Universitetit të Tiranës. Në nivel institucional, Universiteti përdor sisteme të integruara të dokumentimit dhe arkivimit, të cilat sigurojnë menaxhimin e të dhënave për stafin akademik dhe administrativ, duke përfshirë ngarkesën mësimore, oraret, dokumentacionin mbi kualifikimet, raportet vjetore, vlerësimet e performancës dhe aktivitetet kërkimore-shkencore. Përditësimi dhe përpunimi i këtyre të dhënave realizohet nga sekretaria mësimore në bashkëpunim të ngushtë me strukturat drejtuese të fakultetit dhe njësinë përgjegjëse për programin. Për të lehtësuar bashkëpunimin dhe komunikimin e brendshëm midis stafit akademik dhe administrativ, si dhe për koordinimin e veprimtarive mësimore dhe mbështetëse, përdoren platformat digjitale Microsoft Teams dhe Office 365. Angazhimi i ekspertëve të jashtëm dhe profesionistëve të medias në kuadër të programit dokumentohet dhe menaxhohet nëpërmjet marrëveshjeve kontraktuale, të cilat pasqyrohen në planet mësimore dhe raportet vjetore të aktiviteteve akademike. Regjistrat fizikë të lëndëve dhe procesverbalet e provimeve administrohen në mënyrë të rregullt dhe të saktë nga Sekretaria Mësimore e njësisë bazë, duke garantuar dokumentacion të plotë dhe të organizuar për aktivitetet akademike të programit. <i>E.2.9. Manual përdorimi i sistemit Teams – Clean Score</i> <i>E.2.10. Manual përdorimi i sistemit e-Student</i> <i>E.1.3. Rregullore e UT-së</i> <i>E.4.3. Rregulla të sekretarisë mësimore</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vëren se përmes përdorimit të platformës e-Student për studentët dhe sistemeve të brendshme administrative për personelin akademik dhe administrativ, sigurohet akses në dokumentacionin dhe informacionet akademike të programit Master Profesional në Gazetari Investigative. Studentët kanë mundësi të konsultojnë të dhënat personale, regjistrimet në module dhe provime, rezultatet akademike si dhe statusin e pagesave. Ndërkohë, personeli akademik dhe administrativ ka qasje të plotë në dokumentacionin lidhur me

	ngarkesën mësimore, planet mësimore të programit dhe njoftimet institucionale, duke garantuar një menaxhim efektiv dhe transparent të procesit akademik. <i>E.2.9. Manual përdorimi i sistemit Teams – Clean Score</i> <i>E.2.10. Manual përdorimi i sistemit e-Student</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Platforma Microsoft Teams, pjesë e paketës Microsoft 365 Education të Universitetit të Tiranës, ofron një mjet efikas për komunikim interaktiv dhe shkëmbim informacioni mes studentëve dhe pedagogëve të programit Master Profesional në Gazetari Investigative. Funkcionalitetet e bëjnë Microsoft Teams një mjet të përshtatshëm për përmbushjen e nevojave specifike të këtij programi studimi. <i>E.2.9. Manual përdorimi i sistemit Teams – Clean Score</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi i menaxhimit siguron një monitorim të vazhdueshëm dhe në kohë reale të veprimtarive kryesore akademike dhe administrative. <i>E.2.9. Manual përdorimi i sistemit Teams – Clean Score</i>
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit siguron informacion të plotë dhe të përditësuar për programet akademike, stafin dhe aktivitetet në faqen zyrtare online të fakultetit në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Për shembull, seksioni “Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit” në faqen zyrtare të Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë ofron të dhëna mbi programin Bachelor dhe programet Master në shqip e anglisht, duke përfshirë listën e stafit akademik me profile specifike (<u>Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë</u>). Në faqen online të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë publikohen planet mësimore të semestrave të programit të studimit (p.sh., lëndët për secilin vit studimi), si dhe njoftime për aktivitete të studentëve dhe projekte ndërkombëtare (p.sh., Erasmus+). Duke ofruar informacion paralel në anglisht, institucioni lehtëson aksesin për: - Studentë dhe stafe nga jashtë vendit (Erasmus+); - Partnerë akademikë ndërkombëtarë dhe pjesëmarrës në projekte të financuara nga BE ose institucione të tjera. <i>Evidenca faqja online e Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë</i> https://fhf.edu.al/
Konkluzione	<i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se institucioni i arsimit të lartë ka implementuar dhe përdor në mënyrë efektive një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional, i cili siguron administrimin, informimin dhe monitorimin e gjithë aktivitetit akademik, financiar dhe administrativ lidhur me programin e studimit.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni dhe informacionin e mbledhur gjatë vizitës në Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit (DGK), Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson se planifikimi buxhetor për programin “Master Profesional në Gazetari Investigative” është i qëndrueshëm dhe i strukturuar, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, Statutin dhe rregulloret e brendshme të institucionit. Edhe pse buxhetimi nuk realizohet në nivel të veçantë për secilin program studimi, për shkak të angazhimit të pedagogëve në disa programe dhe menaxhimit të përbashkët të shpenzimeve materiale dhe logjistike në nivel departamenti ose fakulteti, procesi i konsoliduar i buxhetimit siguron mbështetje financiare të qëndrueshme edhe për këtë program studimi. Plani financiar përfshin pagesat e personelit akademik dhe ndihmës, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e infrastrukturës, pasurimin e literaturës dhe burimeve mësimore, si dhe shpenzimet për laboratorët, teknologjinë dhe aktivitetet praktike, duke garantuar zbatimin e programit në përputhje me standardet akademike gjatë gjithë periudhës së studimeve. Procesi i hartimit dhe miratimit të planeve financiare zbatohet në përputhje të plotë me dispozitat ligjore, rregulloret e brendshme të Universitetit dhe praktikën e administrimit tatimor. <i>E.1.1. Statuti i UT-së</i> <i>E.4.4. Raporti financiar dhe kostoja e programit</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të	Plani i financimit për programin “Master Profesional në Gazetari Investigative” hartohet në nivel institucional dhe përfshin të gjitha zërat e nevojshëm për funksionimin e qëndrueshëm të Universitetit të Tiranës dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit në njësitë përbërëse të tij. Struktura financiare përfshin: - Të ardhurat, të cilat burojnë nga tarifat studentore, fondet e projekteve, si dhe burime të tjera të ligjshme; - Shpenzimet, që mbulojnë mësimdhënien dhe administrimin akademik, aktivitetet kërkimore-shkencore, projektet e kërkimit, shpenzimet administrative të përgjithshme, si dhe investimet në infrastrukturë dhe teknologji në shërbim të të gjitha programeve të studimit.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjimnazit “Qemal Stafa”, Tiranë
 Tel: +355 (0) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Bordi i Administrimit, si organi më i lartë administrativ i Universitetit, miraton dhe monitoron zbatimin e buxhetit institucional, duke siguruar menaxhimin efektiv financiar dhe realizimin e objektivave strategjike të institucionit. Zyra e Financës kryen analizat financiare dhe përgatit raportet periodike për Bordin, të cilat përdoren për vendimmarrje të bazuar dhe përparësi investimesh në nivel fakulteti dhe departamenti. Megjithatë buxhetimi nuk bëhet në nivel të veçantë për programin e masterit, Master Profesional në "Gazetari Investigative" përfiton nga buxhetimi i njësisë bazë, i cili mbulon: - Financimin e burimeve njerëzore, përfshirë personelin akademik dhe ndihmës-akademik të angazhuar në program; - Shpenzimet operative për funksionimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të mësimdhënies, laboratorëve të gazetarisë dhe pajisjeve teknologjike mbështetëse; - Pasurimin e bibliotekës, duke siguruar blerjen e literaturës dhe aksesin në burime digjitale të specializuara; - Detyrimet administrative dhe financiare lidhur me menaxhimin dhe zhvillimin e programit; - Grantet dhe financimet nga projekte bashkëfinancuese me partnerë vendorë dhe ndërkombëtarë, që kontribuojnë në zhvillimin e kërkimit shkencor dhe formimit praktik të studentëve; - Marrëveshjet dhe bashkëpunimet me institucione mediatike për zhvillimin e praktikave profesionale, projekteve studimore dhe mbështetjes logjistike të procesit akademik. <i>E.1.1. Statuti i UT-së</i> <i>E.4.4. Raporti financiar dhe kostoja e programit</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Universiteti i Tiranës, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregulloret për administrimin financiar publik, zbaton mekanizma të rregullt për auditim të brendshëm dhe të jashtëm financiar, me qëllim monitorimin dhe garantimin e efektivitetit të përdorimit të burimeve ekonomike. Auditimet realizohen në mënyrë periodike nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, e ngritur në nivel institucional, e cila kontrollon dokumentacionin financiar, vlerëson përputhshmërinë me procedurat ligjore dhe monitoron përdorimin racional të fondeve. Gjithashtu, Zyra e Financës harton dhe ruan dokumentacionin e nevojshëm për të gjitha operacionet financiare, duke përfshirë përlogaritjet e të ardhurave dhe

	shpenzimeve, analizën e treguesve financiarë, raportet vjetore dhe informacionin mbi zbatimin e buxhetit sipas njësive bazë. Këto auditime dhe vlerësime sigurojnë transparencën dhe llogaridhënien, përmirësojnë planifikimin financiar në nivel njësish akademike dhe administrative, dhe mbështesin vendimmarrjen e bazuar në evidencë për priorizimin e investimeve dhe burimeve, duke përfshirë edhe programin profesional Master në “Gazetari Investigative”. <i>E.1.1. Statuti i UT-së</i> <i>E.4.4. Raporti financiar dhe kostoja e programit</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësive bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Në përputhje me rregullat financiare dhe statutin e Universitetit të Tiranës, kryhen raportime të rregullta dhe të strukturuar mbi realizimin e buxhetit të miratuar për vitin financiar të kaluar, duke përfshirë informacion të detajuar deri në nivelin e njësive bazë përgjegjëse për programin profesional Master në “Gazetari Investigative”. Pas mbylljes së vitit financiar, Zyra e Financës, në bashkëpunim me njësitë bazë, përgatit raporte analitike mbi të ardhurat dhe shpenzimet, të cilat pasqyrojnë ecurinë e përdorimit të fondeve përkatëse. Këto raporte i dërgohen strukturave drejtuese të fakultetit dhe departamentit, për të siguruar transparencë, përgjegjshmëri dhe një planifikim të mirëinformuar financiar për vitin vijues. <i>E.1.1. Statuti i UT-së</i> <i>E.4.4. Raporti financiar dhe kostoja e programit</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësive bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Universiteti i Tiranës siguron qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e të gjitha programeve të studimit në njësitë bazë, duke përfshirë programin profesional “Master në Gazetari Investigative”, përmes një strukture të konsoliduar planifikimi dhe menaxhimi financiar, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe aktet nënligjore përkatëse. Buxheti i institucional garanton mbulim të vazhdueshëm të nevojave për: → Financimin e burimeve njerëzore akademike dhe ndihmës-akademike; → Shpenzimet infrastrukturore dhe operative për funksionimin normal të departamentit dhe fakultetit; → Mbështetjen e aktiviteteve mësimore, kërkimore dhe praktike, përfshirë investimet në laboratorë, pajisje teknologjike dhe pasurimin e literaturës. → Universiteti ndjek një politikë të diversifikimit të burimeve financiare përmes: → Projekteve kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare; → Granteve nga partnerë institucionalë dhe organizata ndërkombëtare;

	→ Marrëveshjeve të bashkëpunimit me aktorë të sektorit mediatik dhe organizata civile, që përfshijnë mbështetje për praktikat profesionale, projekte studimore dhe trajnime të studentëve. Kjo qasje e kombinuar i mundëson institucionit të ruajë stabilitetin financiar, të sigurojë cilësinë dhe vazhdimësinë e programit të masterit profesional në Gazetari Investigative dhe të përgjigjet në mënyrë efektive ndaj sfidave që mund të shfaqen në burimet ekonomike të njësive bazë.			
Konkluzione	<i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson se institucioni i arsimit të lartë siguron mbështetje financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor dhe kërkimor, si dhe për funksionimin e përgjithshëm të programit të studimit. Financimi i garantuar mbulon nevojat për zhvillimin e aktiviteteve akademike, pajisjet dhe infrastrukturën e nevojshme, si dhe përkrahjen e studentëve gjatë gjithë ciklit studimor. Kjo qasje kontribuon në mbarëvajtjen e programit dhe siguron kushte të favorshme për arritjen e objektivave mësimore dhe kërkimore, duke përmbyllur në mënyrë të plotë kërkesat e standardit.</i>			
Shkalla e përmbylljes së standardit	Nuk përmbyllet	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht
				X

Shkalla e përmbylljes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbyllet	Përmbyllet pjesërisht	Përmbyllet kryesisht	Përmbyllet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Në programin e studimit Master Profesional në “Gazetari Investigative”, zbatohen politika dhe procedura të qarta dhe të dokumentuara që mbulojnë gjithë ciklin akademik të studentëve, nga momenti i pranimi deri në diplomim. Këto politika dhe procedura janë në përputhje të plotë me legjislacionin kombëtar në fuqi dhe me aktet rregullatore të Universitetit të Tiranës. Elementet kryesore të realizimit të këtij kriteri përfshijnë: - Procesi i pranimi dhe regjistrimit: Institucioni ka përcaktuar kriteret dhe procedurat specifike për pranimin e studentëve në programin master profesional në gazetari investigative, duke respektuar kuotat dhe rregullat ligjore,

	si dhe duke siguruar transparencë dhe barazi në procesin e përzgjedhjes. - Menaxhimi i procesit mësimor: Politikat dhe procedurat mbulojnë zhvillimin e planprogramit të specializuar në gazetari investigative, organizimin e orarit të mësimit, metodat e vlerësimit dhe monitorimit të studentëve gjatë gjithë ciklit akademik, duke garantuar standarde të njëjta dhe të larta për të gjithë studentët. - Regjistrimi dhe administrimi i provimeve: Ekzistojnë rregulla të përcaktuara për regjistrimin në provime, mënyrën e organizimit të tyre, si dhe procedurat për ankesa dhe përmirësim të notave, të përshtatura për nevojat e programit profesional. - Mbështetja dhe këshillimi akademik: Institucioni ka vendosur mekanizma për ndjekjen dhe mbështetjen e studentëve gjatë studimeve, duke përfshirë këshillimin akademik të specializuar dhe orientimin profesional në fushën e gazetarisë investigative. - Diplomimi dhe certifikimi: Procedurat për përfundimin e studimeve, vlerësimin përfundimtar dhe dhënien e diplomës janë të rregulluara dhe të harmonizuara me legjislacionin dhe rregulloret për arsimin e lartë, duke reflektuar natyrën profesionale dhe kërkesat specifike të programit. <i>E.1.3. Rregullore e UT-së</i> <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP në Gazetari Investigative"</i> <i>E.4.3. Rregulla të Sekretarisë Mësimore</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Institucioni ka hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura të qarta që garantojnë barazi dhe trajtim të drejtë për të gjithë kandidatët dhe studentët e programit Master Profesional në "Gazetari Investigative", gjatë të gjithë ciklit akademik, nga pranimi deri në diplomim. Këto politika janë në përputhje me legjislacionin kombëtar për arsimin e lartë dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e studentëve, duke përfshirë parimin e mosdiskriminimit në bazë të gjinisë, etnisë, besimit, statusit social apo aftësive të ndryshme. Elementet kryesore të zbatimit përfshijnë procedura të hapura dhe transparente për pranimin në program, të bazuara në kriteret objektive dhe të njëjta për të gjithë kandidatët, pa favorizime apo diskriminim. Gjithashtu, sigurohet trajtim i barabartë gjatë gjithë studimeve, duke garantuar qasje të drejtë në burimet akademike, mbështetje për studentët me nevoja të veçanta, si dhe të drejtën për ankesa dhe shqyrtim të vendimeve në mënyrë të drejtë dhe transparente.



	Politikat për trajtimin e ankesave dhe zgjidhjen e konflikteve janë të qarta dhe sigurojnë mbrojtje të të drejtave të studentëve, duke lehtësuar zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mënyrë objektive dhe paanshme. <i>E.1.1. Statuti i UT-së</i> <i>E.1.3. Rregullore e UT-së</i> <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP në Gazetari Investigative"</i> <i>E.5.4. Kriteret dhe kuotat e pranimit</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Kriteri 3 është përmbushur në mënyrë të plotë nga institucioni. Para çdo viti akademik, Universiteti i Tiranës harton dhe publikon kriteret të qarta dhe specifike për përzgjedhjen e kandidatëve që do të pranohen në programet e studimit, përfshirë programin "Master Profesional në Gazetari Investigative". Këto kriteret janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe respektojnë udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Institucioni zbaton me përpikëri ligjet dhe udhëzimet përkatëse, duke bashkëpunuar ngushtë me strukturat e ngritura për zbatimin e provimit të maturës shtetërore. Ky bashkëpunim u konfirmua edhe gjatë vizitës në institucion. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP në Gazetari Investigative"</i> <i>E.5.4. Kriteret dhe kuotat e pranimit</i> <i>Evidenca faqja online e Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë</i> https://unitir.edu.al/arkiva-2024-2025-kriteret-e-pranimit-ne-ciklin-e-pare-dhe-te-dyte-te-studimeve-ne-universitetin-e-tiranes/ https://shf.edu.al/kriteret-e-pranimit-ne-ciklin-e-pare-dhe-te-dyte-te-studimeve-ne-universitetin-e-tiranes-per-vitin-akademik-2023-2024/
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Kriteret, rregullat dhe procedurat që lidhen me pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, transferimin dhe diplomimin e studentëve në programin Master Profesional në "Gazetari Investigative" janë të qarta, transparente dhe lehtësisht të aksesueshme për publikun. Këto procedura janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar në Statutin dhe Rregulloret e Universitetit të Tiranës, si dhe në dokumentacionin shoqërues të programit, i cili i vihet në dispozicion studentëve gjatë aplikimit dhe regjistrimit. Informacioni është gjithashtu i publikuar në faqet zyrtare të Universitetit dhe njësive përkatëse akademike. Të gjitha materialet janë të paraqitura në një gjuhë të kuptueshme për studentët dhe publikun e gjerë dhe janë të disponueshme në formate fizike në ambientet e fakultetit dhe departamentit, si dhe në formate digjitale në portalet zyrtare të Universitetit dhe fakultetit. Për më tepër, në fillim të çdo viti akademik organizohen sesione orientuese për studentët e rinj, ku ata informohen mbi të drejtat dhe detyrimet, strukturën e programit dhe procedurat administrative, duke siguruar kështu një integrim të suksesshëm

	në procesin akademik dhe administrativ të programit të studimit në Gazetari Investigative. <i>E.1.1. Statuti i UT-së</i> <i>E.1.3. Rregullore e UT-së</i> <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP në Gazetari Investigative"</i> <i>E.5.4. Kriteret dhe kuotat e pranimit</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit siguron informim të qartë dhe të përditësuar për publikun dhe kandidatët lidhur me kriteret dhe procedurat e pranimit në programin "Master Profesional në Gazetari Investigative". Ky informacion publikohet në faqet zyrtare të Universitetit, fakultetit dhe departamentit, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit. Për të rritur dukshmërinë dhe për të ofruar orientim të mirëfilltë për kandidatët, zbatohet një plan marketingu që përfshin komunikim digjital dhe tradicional, organizim sesionesh informuese dhe ditësh të hapura, si dhe promovim të mundësive për praktikë profesionale dhe histori suksesi të alumnive. Të gjitha informacionet mbi strukturën e programit, profilin profesional, kriteret e pranimit dhe procedurat e regjistrimit janë të aksesueshme dhe përditësohen çdo vit para fillimit të afateve zyrtare të aplikimit dhe regjistrimit. <i>E.5.5. Politika e marketingut për programin e studimit</i> <i>E.5.2. Udhërrëfyti i programeve të studimit</i> <i>E.5.3.b. Udhërrëfyti i programeve të studimit FHF</i> <i>E. 5.3 A Udhëzuesi i programeve të studimit në DGK</i>
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	Në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar për arsimin e lartë dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, programi "Master Profesional në Gazetari Investigative" zbaton kriteret për pranimin e kandidatëve nga kategori të veçanta, duke përfshirë personat me aftësi të kufizuara, përfaqësues të pakicave dhe shtresa të marginalizuara. Këto kriteret janë në përputhje me ligjin Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë, i cili parashikon mundësinë e kuotave të veçanta për këto grupe. Rregulloret dhe praktikat institucionale garantojnë respektimin e parimeve të barazisë, përfshirjes së plotë dhe mosdiskriminimit gjatë procesit të pranimit dhe gjatë gjithë zhvillimit të programit. <i>E.1.1. Statuti i UT-së</i> <i>E.1.3. Rregullore e UT-së</i> <i>E.5.8. Bursa dhe politika mbështetëse për studentët</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	Kriteret e pranimit dhe përzgjedhjes për kandidatët nga shtete të tjera janë të përcaktuara në përputhje me rregulloret e Universitetit të Tiranës dhe aktet përkatëse të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Këto kriteret bëhen publike përpara çdo viti akademik përmes

	kanaleve zyrtare të institucionit, duke siguruar transparencë dhe akses të barabartë për të gjithë aplikantët.			
	<i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP në Gazetari Investigative"</i> <i>E.5.4. Kriteret dhe kuotat e pranimit</i>			
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimi në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Çdo fillim viti akademik, në faqen zyrtare të njësisë kryesore publikohen politikat e ndihmës ekonomike që vlejné edhe për studentët e programit Master Profesional në "Gazetari Investigative", duke përfshirë bursa dhe lehtësira tarifore për kategori të caktuara sociale dhe ekonomike. Aplikimi për përfitime ekonomike realizohet nëpërmjet platformës Microsoft Teams dhe më pas plotësohet me dorëzimin fizik të dokumentacionit në fakultet, brenda afateve të përcaktuara.			
	<i>Evidenca faqja online e Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë</i> https://fhf.edu.al/njoftim-aplikimi-per-bursa-dhe-reduktim-tarife-viti-2024-2025/			
Konkluzione	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se institucioni i arsimit të lartë i përmbush plotësisht kërkesat e këtij standardi. Politikat dhe procedurat që lidhen me pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, transferimin, njohjen dhe vlerësimin e dijeve, si dhe diplomimin e studentëve në programin e studimit, janë të dokumentuara, të qarta dhe të zbatueshme. Ato respektojnë kuadrin ligjor kombëtar dhe janë të aksesueshme për studentët dhe publikun përmes platformave zyrtare dhe dokumentacionit përkatës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit siguron informacion të plotë, të strukturuar dhe të aksesueshëm për studentët e programit "Master Profesional" në lidhje me përparimin akademik. Ky informacion publikohet përmes udhërrëfyesit të programit, i cili përfshin të dhëna të detajuara mbi strukturën e programit, kreditet, ngarkesën mësimore dhe kriteret e vlerësimit. Gjithashtu, në fillim të vitit akademik organizohen sesione orientuese që sqarojnë procesin e ndjekjes së studimeve, mënyrën e vlerësimit dhe kërkesat për përfundimin e suksesshëm të ciklit. Këto forma informimi garantojnë transparencë të plotë dhe

	ndihmojnë studentët të orientohen qartë në çdo hap të rrugëtimit të tyre akademik. <i>E.1.3. Rregullore e UT-së</i> <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP në Gazetari Investigative"</i> <i>E.5.2. Udhërrëfyesi i programeve të studimit</i> <i>E. 5.3 A Udhëzuesi i programeve të studimit në DGK</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Kriteri 2 është përmbushur nga institucioni. Studentët informohen rregullisht për këto procedura përmes platformave zyrtare të universitetit dhe të njësive përbërëse, si dhe gjatë sesioneve orientuese në fillim të vitit akademik. Procedurat përfshijnë dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm, vlerësimin nga njësia bazë dhe vendimmarrjen institucionale në përputhje me kriteret e transparencës dhe barazisë. <i>E.1.3. Rregullore e UT-së</i> <i>E.5.2. Udhërrëfyesi i programeve të studimit</i> <i>E. 5.3 A Udhëzuesi i programeve të studimit në DGK</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Në programin e studimit "Master Profesional në Gazetari Investigative", syllabuset e lëndëve përcaktojnë në mënyrë të detajuar metodat, kriteret dhe procedurat e vlerësimit për secilën lëndë, në përputhje me rregulloret institucionale dhe kërkesat e programit. Këto kriteret janë të përfshira gjithashtu në rregulloren mësimore të programit dhe prezantohen nga pedagogët në fillim të çdo semestri, për të garantuar informimin e plotë dhe transparent të studentëve mbi mënyrën e vlerësimit. Përveç komunikimit në auditor, informacioni i vlerësimit shpërndahet edhe përmes platformës Microsoft Teams, duke siguruar akses të lehtë dhe të vazhdueshëm për studentët gjatë gjithë ciklit të studimeve. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP në Gazetari Investigative"</i> <i>E.2.1. Syllabuset e lëndëve</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Në programin Master Profesional në "Gazetari Investigative", informacioni mbi kriteret dhe procedurat e punimit të diplomës u ofrohet studentëve përmes materialeve udhëzuese specifike, të hartuara në përputhje me kërkesat akademike të ciklit të dytë. Këto materiale përmbajnë udhëzime të qarta mbi përzgjedhjen e temës, strukturën dhe formatin e punimit, metodat e kërkimit, si dhe kriteret e vlerësimit. Gjithashtu, gjatë periudhës së përgatitjes së temës dhe punimit të diplomës, organizohen takime informuese me studentët, me qëllim sqarimin e afateve, dokumentacionit të nevojshëm, procedurave të dorëzimit dhe mbrojtjes. Studentët mbështeten nga pedagogë udhëheqës, të cilët i orientojnë në çdo hap të punës kërkimore dhe hartimit të diplomës, duke garantuar

	përmbyshjen e standardeve akademike dhe cilësinë e produktit final. <i>E.3.3. Material udhëzues për punimin e tezës</i> <i>E.3.4. Skedë vlerësimi për temën e diplomës në MP</i> <i>E.3.5. Format i diplomës MP në "Gazetari Investigative" dhe suplementi i saj</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Institucioni i arsimit të lartë përmbysh kriterin. Përpara fillimit të çdo viti akademik publikon një udhëzues të detajuar të programit, i cili është i disponueshëm në faqet zyrtare të universitetit për akses të lehtë nga studentët dhe të interesuarit. Gjithashtu, organizohet një javë orientuese dhe takime informuese specifike për studentët e ciklit të dytë, ku prezantohet struktura e programit, mënyra e organizimit të mësimdhënies, kërkesat akademike, procedurat e vlerësimit dhe praktikat profesionale. <i>E.5.2. Udhërrëfytes i programeve të studimit</i> <i>E. 5.3 A Udhëzuesi i programeve të studimit në DGK</i>			
Konkluzione	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson se ky standard realizohet plotësisht duke siguruar informacion të plotë dhe të detajuar për studentët në lidhje me përparimin akademik, njohjen dhe vlerësimin e dijeve gjatë gjithë ciklit të studimeve dhe deri në diplomim. Procedurat e ndjekura janë të dokumentuara dhe lehtësisht të aksesueshme.			
Shkalla e përmbyshjes së standardit	Nuk përmbyshet	Përmbyshet pjesërisht	Përmbyshet kryesisht	Përmbyshet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbyajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Institucioni i arsimit të lartë siguron informim të hollësishëm dhe të qartë për studentët e programit "Master Profesional në Gazetari Investigative" lidhur me strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e studimeve, përmes dokumenteve dhe materialeve zyrtare të përgatitura posaçërisht për këtë cikël. Rregullorja e programit përmbysh dispozitat ligjore dhe rregullat që sqarojnë të gjitha aspektet akademike dhe administrative të masterit, ndërsa udhëzuesi i programit ofron informacion të detajuar mbi përmbyajtjen e lëndëve, kurrikulën, organizimin e procesit mësimor dhe kërkesat për përfundimin e studimeve. Planet mësimore semestrale dhe kreditet ECTS janë publikuar dhe të aksesueshme për studentët, duke mundësuar ndjekjen e qartë të rrjedhës së studimeve dhe planifikimin efektiv të përparimit akademik. Ky informacion përditësohet dhe shpërndahet vazhdimisht gjatë gjithë

	periudhës së studimeve, duke qenë i disponueshëm në platformën elektronike e-student dhe faqet zyrtare të institucionit. Për më tepër, koordinatori i programit mbështet studentët në çdo kërkesë për sqarime apo informacione shtesë gjatë zhvillimit të studimeve. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP në Gazetari Investigative"</i> <i>E. 5.3 A Udhëzuesi i programeve të studimit në DGK</i> <i>E.2.3. Urdhër për emërimin e koordinorit të programit të studimit</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Institucioni i arsimit të lartë siguron informacion të detajuar për çdo lëndë/modul të programit Master Profesional në "Gazetari Investigative", duke përfshirë përmbajtjen akademike dhe aktivitetet formuese. Syllabuset e çdo lënde përmbajnë objektivat mësimore, temat kryesore, metodologjinë e mësimdhënies, kriteret e vlerësimit, si dhe aktivitetet praktike, projektet dhe punën individuale të studentit. Ky material është i aksesueshëm për studentët përmes platformës e-student dhe është i disponueshëm që në fillim të vitit akademik, duke mundësuar planifikim të mirë dhe ndjekje të strukturuar të mësimit. Staf i akademik ofron mbështetje dhe orientim të vazhdueshëm për realizimin e veprimtarive formuese, duke siguruar një proces mësimor të organizuar dhe bashkëpunues. Ky element u konfirmua edhe nga vet studentë gjatë vizitës në institucion. <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP në Gazetari Investigative"</i> <i>E.2.1. Syllabuset e lëndëve</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Kriteri 3 është një nga pikat më të forta të Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit. Institucioni siguron informacion të vazhdueshëm dhe të detajuar për studentët mbi mundësitë reale të punësimit pas përfundimit të studimeve, si dhe ofron mbështetje institucionale aktive për orientimin profesional dhe integrimin në tregun e punës. Bashkëpunimet e shumta të departamentit me aktorë të industrisë mediatike dhe organizata të ndryshme profesionale krijojnë mundësi të mirëfillta praktike dhe punësimi për studentët. Gjatë takimit zyrtar në institucion, vetë studentët konfirmuan këtë aspekt, të cilin e atribuojnë jo vetëm përgatitjes cilësore gjatë studimeve, por edhe mbështetjes së vazhdueshme që marrin nga departamenti dhe universiteti për t'u orientuar dhe për t'u integruar në tregun e punës. <i>E.1.4. Plani i Zhvillimit të Departamentit të Gazetarisë 2024-2029</i> <i>E.3.9. Listë trajnimesh prej Zyrës së Këshillimit të Karrierës</i> <i>E.6.7. NJSBC dhe Karriera – Raporti vjetor 2023-2024</i> <i>E.1.9. Marrëveshjet e bashkëpunimit</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor,	Institucioni siguron akses të vazhdueshëm për studentët në të gjitha aspektet e organizimit të procesit mësimor dhe funksionimit administrativ përmes një sistemi të integruar komunikimi dhe

logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	informacioni, di dhe duke i vënë në dispozicion udhëzuesin e studimeve. Mbështetja administrative ofrohet përmes zyrave përkatëse, duke përfshirë sekretarinë mësimore dhe zyrën e karrierës. Komunikimi i drejtpërdrejtë me stafin akademik dhe administrativ sigurohet përmes takimeve dhe platformave digjitale, duke garantuar një mbështetje të plotë gjatë gjithë ciklit të studimeve në programin Master Profesional në “Gazetari Investigative”. Gjithashtu, koordinatori i studimit asiston studentët për çdo informacion. <i>E. 5.3 A Udhëzuesi i programeve të studimit në DGK</i> <i>E.2.3. Urdhër për emërimin e koordinatorit të programit të studimit</i>			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Përmes platformës e-student dhe Microsoft Teams, studentët marrin informacion të përditësuar mbi oraret, kalendarin akademik, syllabuset, si dhe aspekte të tjera me programin e studimit duke qenë lehtësisht i arritshëm edhe në distancë. <i>E.2.9. Manual përdorimi i sistemit Teams – Clean Score</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se institucioni ka krijuar një sistem të strukturuar dhe efektiv për informimin e studentëve të programit “Master Profesional në Gazetari Investigative”. Informacioni i ofruar përfshin objektivat, strukturën dhe përmbajtjen e programit, rezultatet e pritshme të të nxënësve, si dhe mundësitë e punësimit dhe zhvillimit profesional, duke qenë i aksesueshëm në kohë reale përmes platformave digjitale akademike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.					
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve				
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve të diplomuarve, në programin e studimit.	Sekretaria mësimore është përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e informacionit mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe të diplomuar në secilin program studimi. Këto statistika azhurnohen çdo vit akademik dhe përfshijnë të dhëna lidhur me numrin e studentëve të regjistruar për herë të parë dhe totalin e studentëve aktivë, numrin e studentëve të diplomuar sipas viteve akademike, tregues të ecurisë së regjistrimeve dhe diplomimeve. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen të dhënat për programin e studimit.				
	Viti akademik	Studentë të regjistruar	Studentë të diplomuar	Nota mesatare hyrëse	Nota mesatare dalëse

	<table><tr><td>2021-2022</td><td>14</td><td>0</td><td>7</td><td></td></tr><tr><td>2022-2023</td><td>6</td><td>3</td><td>7.3</td><td>8</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>3</td><td>3</td><td>6.9</td><td>7</td></tr><tr><td>2024-2025</td><td>1</td><td></td><td>7.8</td><td></td></tr></table>	2021-2022	14	0	7		2022-2023	6	3	7.3	8	2023-2024	3	3	6.9	7	2024-2025	1		7.8	
2021-2022	14	0	7																		
2022-2023	6	3	7.3	8																	
2023-2024	3	3	6.9	7																	
2024-2025	1		7.8																		
	E.4.3. Rregulla të sekretarisë mësimore E.4.8. RVB tabelat përmbledhëse																				
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Sekretaria Mësimore në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë mbledh dhe përditëson rregullisht statistikat vjetore për çdo program studimi. Këto të dhëna përfshijnë numrin e studentëve që regjistrohen në fillim të vitit akademik, studentët që përfundojnë me sukses studimet brenda afateve të parashikuara, ata që largohen nga programi me kërkesë personale ose për arsye të tjera të dokumentuara, studentët që përjashtohen para përfundimit të programit për shkak të mosplotësimit të kërkesave akademike ose disiplinore, si dhe ata që nuk arrijnë të kalojnë vitin akademik përkatës. E.4.3. Rregulla të sekretarisë mësimore E.4.8. RVB tabelat përmbledhëse																				
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat statistikore të studentëve ruhen dhe menaxhohen në regjistra elektronikë bazë, të cilët përmbajnë informacion të detajuar dhe të përditësuar në kohë reale. Këto regjistra përfshijnë: regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e rezultateve akademike dhe regjistrin e diplomave. Të gjitha këto të dhëna ruhen në një bazë të dhënash që administrohet nga Sekretaria Mësimore. Kjo njësi është përgjegjëse për mbikëqyrjen e aksesit dhe sigurinë e të dhënave, duke garantuar që vetëm personat e autorizuar mund të hyjnë, modifikojnë dhe kontrollojnë informacionin. E.4.3. Rregulla të sekretarisë mësimore																				
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretariatë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Institucioni mbështet dhe garanton kontrollin periodik të përvitshëm të njësive përgjegjëse për menaxhimin e të dhënave të studentëve nëpërmjet një kuadri të miratuar rregullator dhe procedural. Ky kontroll zbatohet ndaj sekretarive mësimore në të gjitha njësitë kryesore dhe bazë. Procesi i kontrollit kryhet nga struktura të caktuara të institucionit dhe është i dokumentuar përmes raporteve vjetore. E.1.3. Rregullore e UT-së E.1.2. Strategjia e zhvillimit të UT-së (2023-2028) E.4.7. Rregullore e brendshme e punës për organizimin dhe funksionimin e administratës së rektoratit të UT-së																				
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e	Njësia bazë ka vendosur një sistem të organizuar për vlerësimin e profilit të studentëve në hyrje dhe dalje, si dhe për ndjekjen e punësimit të tyre pas përfundimit të studimeve. Bazuar në analiza periodike dhe studime të tregut të punës, përfshirë edhe studimin “Media in Fokus”, janë identifikuar tendencat dhe nevojat e sektorit mediatik. Këto të																				

duhura në drejtim të përmirësimit të ketyre treguesve.	dhëna shërbejnë si bazë për përmirësimin e programit të Masterit Profesional në Gazetari Investigative, duke përfshirë rishikimin e moduleve, forcimin e praktikave profesionale dhe zgjerimin e bashkëpunimeve me median dhe institucionet përkatëse. Ky proces i vazhdueshëm synon të rrisë cilësinë e programit dhe të përgatisë profesionistë të aftë dhe të punësueshëm në tregun e medias dhe komunikimit. <i>E.1.4. Plani i Zhvillimit të Departamentit të Gazetarisë 2024-2029</i> <i>E.1.11. Analizë e tregut të punës</i> <i>E.1.12. Studimi i tregut - Media in fokus</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se institucioni i arsimit të lartë ka ngritur mekanizma efikas për mbledhjen, administrimin, përditësimin dhe ruajtjen e të dhënave të studentëve të programit të Masterit Profesional në Gazetari Investigative, nga momenti i pranimit deri në diplomim. Këto të dhëna menaxhohen përmes regjistrave zyrtarë të sekretarisë mësimore dhe ruhen në baza të dhënash institucionale. Për më tepër, institucioni ka ndërmarrë iniciativë për ndjekjen e të dhënave pas diplomimit, duke përfshirë analiza të tregut të punës dhe studime specifike për këtë program.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Institucioni i arsimit të lartë siguron përfshirjen aktive të studentëve të programit "Master Profesional në Gazetari Investigative" dhe përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Kjo e drejtë është garantuar në Statutin e Universitetit të Tiranës dhe detajuar në Rregulloren e UT-së, ku përcaktohen mënyrat e zgjedhjes dhe roli i përfaqësuesve studentorë në strukturat kolegjiale, si Senati Akademik, Këshilli i Fakultetit dhe Këshilli i Departamentit. Në nivel të programit të studimit, parashikohen mekanizma për përfshirjen e përfaqësuesve të studentëve në këshillat dhe komisionet që trajtojnë çështje akademike, organizative dhe të cilësisë së programit. Në praktikë, përfaqësuesit e studentëve marrin pjesë aktive në mbledhjet përkatëse, me të drejtë diskutimi dhe votimi, duke siguruar kështu një rol të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së arsimit në masterin profesional.

	<i>E.1.1. Statuti i UT-së</i> <i>E.1.3. Rregullore e UT-së</i> <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP në Gazetari Investigative"</i> <i>E.2.11. Procesverbale të mbledhjeve të departamentit (Shembull)</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen aktive dhe me ndikim të studentëve të programit "Master Profesional në Gazetari Investigative" dhe përfaqësuesve të tyre në proceset e vendimmarrjes, këshillimit dhe vlerësimit të veprimtarisë akademike, në përputhje me kuadrin rregullator dhe standardet për sigurimin e cilësisë. Rregullorja e Universitetit të Tiranës përcakton të drejtat e studentëve për të kontribuar në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe për të qenë të përfaqësuar në strukturat vendimmarrëse dhe këshilluese. Në nivel të programit të masterit, kjo përfshihet në instrumentet e brendshme të sigurimit të cilësisë, ku studentët plotësojnë pyetësorë vlerësues për pedagogët, të cilët përpunohen nga strukturat përkatëse dhe përdoren për përmirësimin e praktikave akademike dhe organizative. Për më tepër, një përfaqësues i studentëve merr pjesë në mbledhjet e departamentit, duke shprehur drejtpërdrejt kërkesat dhe sugjerimet e studentëve për procesin akademik. <i>E.1.3. Rregullore e UT-së</i> <i>E.1.6. Rregullore e Programit të Studimit "MP në Gazetari Investigative"</i> <i>E.2.11. Procesverbale të mbledhjeve të departamentit (Shembull)</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributit të tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit siguron përfshirjen aktive dhe të strukturuar të studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, në përputhje me standardet institucionale dhe praktikën e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Studentët kontribuojnë në këtë proces përmes instrumenteve të rregullta dhe të dokumentuara, si pyetësorët e vlerësimit të lëndëve dhe stafit akademik, të cilët përpunohen nga strukturat përgjegjëse dhe ndikojnë në përmirësimin e përmbytjes së moduleve. Përfaqësuesit e studentëve në Këshillin Studentor paraqesin sugjerime konkrete gjatë mbledhjeve të departamentit, ndërsa konsultimet dhe fokus grupet me studentët ofrojnë informacion të vlefshëm për përshtatjen dhe zhvillimin e vazhdueshëm të programit. Gjatë vizitës së grupit të vlerësimit të jashtëm, studentët vetë vlerësojnë pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje si një nga përvojat më pozitive akademike, duke theksuar edhe marrëdhëniet e mira dhe bashkëpunuese me stafin akademik. <i>E.2.11. Procesverbale të mbledhjeve të departamentit (Shembull)</i> <i>E.6.2. Manuali i Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik të UT-së</i> <i>E.6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i>

	<i>E.6.5. Pyetësori i stafit akademik</i> <i>E.6.6. Raporti i vlerësimit të lëndëve nga pyetësori i studentëve</i> <i>E.6.7. NJSBC dhe Karriera – Raporti vjetor 2023-2024</i>			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezulttit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.	Institucioni garanton që studentët e programit “Master Profesional në Gazetari Investigative” të kenë mundësi reale dhe të strukturuar për të shprehur mendimin e tyre mbi barazinë dhe ndershmërinë e procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Studentët informohen në mënyrë të qartë për procedurat dhe kriteret e vlerësimit, si dhe për mekanizmat e ankimit dhe rishikimit të rezultateve. Rregullorja e Universitetit të Tiranës përcakton qartë të drejtën e studentëve për të kërkuar rishikimin e rezultateve dhe mënyrën e paraqitjes së ankesave. Procedurat për ankimin e rezultateve janë transparente, duke mundësuar që studentët të paraqesin kërkesa zyrtare për rishikim pranë njesisë bazë ose njesisë kryesore të fakultetit. <i>E.1.3. Rregullore e UT-së</i> <i>E.6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i> <i>E.6.5. Pyetësori i stafit akademik</i>			
Konkluzione	Institucioni ka siguruar përfshirjen aktive të studentëve të programit “Master Profesional në Gazetari Investigative” në organet vendimarrëse dhe këshilluese, si dhe në proceset e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit. Studentët kontribuojnë edhe në vlerësimin e metodave të mësimdhënies dhe cilësinë e shërbimeve akademike dhe mbështetëse. Nga intervistat dhe komunikimi me studentët rezulton se kjo përfshirje është reale, e strukturuar dhe efektive. Në këtë mënyrë, standardi konsiderohet i përmbushur plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6 Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Institucioni i Arsimit të Lartë ka ngritur njësi të dedikuara dhe ka miratuar procedura të qarta për informimin dhe shërbimin ndaj studentëve të programit “Master Profesional në Gazetari Investigative”, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Në këtë kuadër funksionojnë Zyra e Këshillimit të Karrierës, Sekretariteti Mësimor, si dhe platforma online dhe mjetet digjitale që sigurojnë komunikim efikas dhe të aksesueshëm për studentët.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjimnazit “Qemal Stafa”, Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-13423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

	Këto struktura ofrojnë informacion të detajuar dhe të përditësuar mbi programin e studimit, procesin e regjistrimit, zhvillimin akademik, të drejtat dhe detyrimet e studentëve, si dhe mbështetje për çështje akademike dhe administrative. Studentët kanë mundësi të marrin asistencë si në mënyrë direkte, ashtu edhe përmes mjeteve elektronike <i>E.6.1. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT</i> <i>E.6.7. NJSBC dhe Karriera – Raporti vjetor 2023-2024</i> <i>E.6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i> <i>E.4.3. Rregulla të sekretarisë mësimore</i> <i>E.1.2. Strategjia e zhvillimit të UT-së (2023-2028)</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson se institucioni ka krijuar një sistem të specializuar dhe të strukturuar për informimin, këshillimin dhe ndjekjen e përparimit të studentëve në programin Master Profesional në “Gazetari Investigative”. Mbështetja realizohet përmes njësi të dedikuara si Zyra e Këshillimit të Karrierës, Sigurimi i Cilësisë, koordinatorët e programit dhe sekretaritë mësimore. Për të garantuar një ndjekje të qëndrueshme dhe efektive të progresit të studentëve, përdoren instrumente të qarta të vlerësimit të cilësisë, përfshirë pyetësorët e vlerësimit të programeve dhe mësimdhënies, vlerësimin e stafit akademik nga studentët, analizat vjetore të brendshme dhe monitorimin e treguesve të suksesit akademik dhe punësimit. Institucioni zotëron kapacitete të avancuara për t’u ofruar studentëve mbështetjen e nevojshme për të kuptuar tregun e punës, si dhe mundësitë dhe sfidat që ai paraqet. <i>E.6.1. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT</i> <i>E.6.7. NJSBC dhe Karriera – Raporti vjetor 2023-2024</i> <i>E.6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i> <i>E.2.3. Urdhër për emërimin e koordinatorit të programit të studimit</i> <i>E.6.6. Raporti i vlerësimit të lëndëve nga pyetësi i studentëve</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e Këshillimit të Karrierës në programin Master Profesional në “Gazetari Investigative” ofron mbështetje të strukturuar dhe të vazhdueshme për zhvillimin profesional dhe orientimin në tregun e punës. Zyra siguron informacion të detajuar mbi përfundimin e studimeve dhe kërkesat e diplomimit, ndihmon në organizimin e praktikave profesionale në institucione partnere dhe media, dhe ofron këshilla të ndryshme. Gjithashtu, Zyra organizon takime informuese, forume karriere, ditë të hapura dhe panairë punësimi, duke krijuar lidhje të drejtpërdrejta mes studentëve, tregut të punës dhe alumneve. Duhet theksuar se një pjesë e madhe e punës dhe mbështetjes në këtë fushë realizohet drejtpërdrejt nga vetë Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit. <i>E.6.7. NJSBC dhe Karriera – Raporti vjetor 2023-2024</i>




Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Institucioni i Arsimit të Lartë, përmes strukturave përgjegjëse si Zyra e Karrierës dhe Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, ka ndërmarrë hapa të qëndrueshëm për të monitoruar studentët e programit Master Profesional në "Gazetari Investigative" pas diplomimit, duke mbledhur dhe përpunuar të dhëna të rëndësishme mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të tyre. <i>E.6.7. NJSBC dhe Karriera – Raporti vjetor 2023-2024</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se institucioni i arsimit të lartë ka krijuar dhe funksionalizuar njësi të specializuara për prirjen, orientimin dhe këshillimin e studentëve të programit Master Profesional në "Gazetari Investigative", si dhe për trajtimin e ankesave dhe çështjeve të tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit, në përputhje me rregulloret dhe kuadrin institucional të Universitetit të Tiranës, zbaton mekanizma të strukturuar për sigurimin e cilësisë në programin "Master Profesional në Gazetari Investigative". Kjo përfshin Manualin e Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik dhe Paketën e Instrumenteve të Cilësisë, të cilat mbështesin vlerësimin profesional dhe pedagogjik të stafit akademik, përfshirë anketat e studentëve dhe vetëvlerësimet. Analizat e detajuara mbi objektivat formuese dhe metodat mësimore kanë nxitur integrimin e qasjeve interaktive dhe praktike për të përmirësuar përvetësimin e njohurive nga studentët. <i>E.6.2. Manuali i Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik të UT-së</i> <i>E.6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i> <i>E.6.1. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT</i> <i>E.5.1. Analiza e departamentit për objektivat formuese të programit të studimit</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të	Për realizimin e Kriterit 2, Institucioni i Arsimit të Lartë ka ndërtuar një sistem të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës për monitorimin dhe vlerësimin e aftësive pedagogjike dhe profesionale të stafit akademik në programin e Masterit. Strategjia zhvillimore e UT-së

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjimnazit «Qemal Stafa», Tiranë
Tel:+355 (0) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

personelit akademik dhe ndihmësakademik.	(2023–2028) dhe Manuali i Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik sigurojnë një proces transparent dhe të standardizuar vlerësimi, ndërsa krijimi i Njesisë së Sigurimit të Cilësisë në Fakultetin e Historisë dhe Filologjisë garanton koordinimin efektiv të këtyre proceseve. <i>E.1.2. Strategjia e zhvillimit të UT-së (2023-2028)</i> <i>E.6.2. Manuali i Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik të UT-së</i> <i>E.6.4. Urdhër i Dekanit për krijimin e NJSBC-së në FHF</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Institucioni ka ngritur një mekanizëm të institucionalizuar dhe funksional për përfshirjen aktive të studentëve në vlerësimin periodik të metodave dhe formave të mësimdhënies, si dhe të procesit të vlerësimit të dijeve. Ky proces menaxhohet nga një komision i posaçëm brenda Njesisë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, i përbërë nga përfaqësues të stafit akademik, ndihmësakademik dhe studentëve, që siguron një përfaqësim të balancuar dhe gjithëpërfshirës. Përmes instrumenteve të ndryshme, përfshirë pyetësorë anonimë, sigurohet një mjedis transparent dhe besueshëm ku studentët mund të shprehin lirshëm mendimet dhe shqetësimet e tyre. <i>E.6.4. Urdhër i Dekanit për krijimin e NJSBC-së në FHF</i> <i>E.6.6. Raporti i vlerësimit të lëndëve nga pyetësi i studentëve</i> <i>E.2.11. Procesverbale të mbledhjeve të departamentit (Shembull)</i> <i>E.6.5. Pyetësi i stafit akademik</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Kriteri 4, që lidhet me publikimin e rezultateve të vlerësimit nga strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, është i përcaktuar qartë në kuadrin rregullator të Universitetit të Tiranës, përmes Rregullores për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (Vendimi i Senatit nr. 14/2022). Ky dokument përcakton përgjegjësitë e njësive bazë, kryesore dhe institucionale për monitorimin dhe vlerësimin e vazhdueshëm të cilësisë në procesin mësimor, duke kërkuar publikimin e rezultateve të këtyre vlerësimeve. Megjithatë, për të siguruar zbatimin efektiv, do të ishte e nevojshme që institucioni të sigurojë evidenca të qarta për shpërndarjen e rregullt të rezultateve të vlerësimeve në të gjitha nivelet, duke rritur kështu transparencën dhe informacionin për realizimin e këtij kriteri. https://unitir.edu.al/rregullore-per-organizimin-dhe-funksionimin-e-njesive-te-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-ne-universitetin-e-tiranes/
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për	Universiteti i Tiranës ka krijuar struktura dhe instrumente të dedikuara për sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, duke përfshirë Manualin e Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik, Paketa e Instrumenteve të Cilësisë dhe Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë. Rezultatet e vlerësimeve periodike nga studentët dhe




përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	personeli akademik përdoren për identifikimin dhe shpërndarjen e praktikave të mira mësimore, si dhe për hartimin e politikave që nxisin përmirësimin e vazhdueshëm. Për më tepër, zhvillimi i trajnimeve, pjesëmarrja në konferenca dhe vlerësimi i performancës kontribuojnë në forcimin e kulturës institucionale për mësimdhënie cilësore dhe bashkëpunuese. <i>E.6.2. Manuali i Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik të UT-së</i> <i>E.6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i> <i>E.6.1. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT</i>			
Konkluzione	Universiteti i Tiranës ka zhvilluar dhe zbatuar politika të qarta për garantimin dhe promovimin e cilësisë në mësimdhënie, përmes dokumenteve strategjike si Strategjia e Zhvillimit, Manuali i Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik, Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë dhe Paketa e Instrumenteve të Cilësisë. Janë ngritur struktura të përhershme monitorimi në të tri nivelet institucionale, të cilat sigurojnë vlerësimin dhe përmirësimin periodik të metodave mësimore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Universiteti i Tiranës ka ngritur politika, struktura dhe procedura të qarta për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me legjislacionin dhe aktet institucionale në fuqi. Kjo është e reflektuar në Statutin e UT-së, ku përcaktohen parimet e autonomisë, transparencës dhe rolit të strukturave për cilësinë, si dhe në Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e njësive të SBC, që institucionalizon tre nivelet funksionale: njësitë bazë, njësinë kryesore dhe atë institucionale. Këto njësi kanë përgjegjësi për monitorimin, vlerësimin dhe publikimin e rezultateve të cilësisë. Për më tepër, dokumente mbështetëse si Paketa e Instrumenteve të Cilësisë, Manuali i Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik dhe Strategjia e Zhvillimit të UT-së 2023–2028 ofrojnë udhëzime dhe instrumente praktike për zbatimin e politikave të sigurimit të cilësisë. Të dhënat e grumbulluara nga NJSBC-ja janë përdorur nga Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit për analiza të hollësishme mbi strukturën mësimore, përmbajtjen e moduleve, përvojën e studentëve dhe sfidat që lidhen me regjistrimet dhe diplomimet. Këto analiza janë konsideruar si bazë për

	vendimarrje dhe ndërhyrje në funksion të përmirësimit të cilësisë. <i>E.1.1. Statuti i UT-së</i> <i>E.6.2. Manuali i Vlerësimit të Performancës së Personelit Akademik të UT-së</i> <i>E.6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i> https://unitir.edu.al/rregullore-per-organizimin-dhe-funksionimin-e-njesive-te-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-ne-universitetin-e-tiranes/
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë (SBC) në Universitetin e Tiranës është funksional dhe mbështetet në planifikim periodik, analizë të të dhënave dhe përfshirjen aktive të studentëve përmes pyetësorëve anonimë mbi cilësinë e përvojës akademike dhe administrative. Të dhënat përpunohen nga strukturat përkatëse dhe shërbejnë si bazë për masa konkrete për përmirësim. Për të siguruar vlerësim të paanshëm dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare, në këtë proces janë përfshirë edhe ekspertë të jashtëm nga fusha akademike dhe sektori profesional. Në veçanti, për programin në Gazetari dhe Komunikim është zhvilluar një proces reformimi shumëvjeçar (2018–2021), me mbështetje nga partnerë ndërkombëtarë si OSBE, USAID, Ambasada Britanike dhe institucione akademike nga Anglia dhe Franca. Ekspertët e angazhuar ofruan analiza dhe rekomandime konkrete për ristrukturimin e programit, të cilat janë reflektuar gjerësisht në planin e ri mësimor. Ky proces është shoqëruar me studime empirike dhe anketime me studentë, gazetarë, publik dhe aktorë të tregut të punës, për të siguruar që përmbajtja e programit të jetë në përputhje me nevojat reale të industrisë mediatike dhe të forcojë përgatitjen profesionale të studentëve të ciklit Master Profesional. <i>E.5.1. Analiza e departamentit për objektivat formues të programit të studimit</i> <i>E.6.8. Agjenda e takimeve me bashkëpunëtorë vendas dhe të huaj</i> <i>E.6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i>
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Universiteti i Tiranës ka institucionalizuar përdorimin e një game të gjerë instrumentesh dhe treguesish për sigurimin e cilësisë, të mbështetura në standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë. Proceset e sigurimit të jashtëm të cilësisë realizohen kryesisht përmes akreditimit të programeve të studimit, të mbikëqyrur nga Autoriteti Kombëtar i Akreditimit dhe Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, në përputhje me kriteret ligjore në fuqi. Përveç akreditimit, Universiteti angazhohet në vlerësime të vazhdueshme analitike dhe krahasuese të programeve, duke përdorur tregues cilësorë dhe sasiorë që matin përmbushjen e objektivave mësimore,

	performancën akademike dhe përshtatshmërinë me nevojat e tregut të punës.			
	<i>E.6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i>			
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.	Institucioni ka të miratuar paketën e instrumenteve të cilësisë. Këta tregues përfshijnë indikatorë të performancës në mësimdhënie, rezultatet e studentëve, nivelin e përfshirjes në kërkimin shkencor, si dhe parametrat e përbushjes së standardeve akademike. Përveç pasqyrimin të gjendjes së përgjithshme në proceset mësimore dhe kërkimore, këta tregues duhet të shërbejnë si bazë për vendimmarrje strategjike dhe promovime nxitëse veçanërisht në ato programe studimi ku ka numër të ulët regjistrimesh.			
	<i>E.6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vëren se institucioni ka hartuar instrumente dhe ka zbatuar politika të përgjithshme institucionale për sigurimin e cilësisë.</i>			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Në përputhje me Rregulloren për Sigurimin e Cilësisë në Universitetin e Tiranës, veçanërisht Nenin 26, parashikohet që çdo njësi bazë duhet të kryejë vlerësimin periodik të programeve të studimit dhe të hartojë raporte cilësore vlerësuese për arritjet, mangësitë dhe përmirësimet e mundshme. Këto raporte shërbejnë si bazë për vendimmarrje të informuar nga autoritetet përgjegjëse të institucionit dhe për forcimin e kulturës së përgjegjshmërisë akademike. Megjithatë, në rastin konkret të programit të studimit Gazetari Investigative, situata e numrit të ulët të regjistrimeve, me vetëm një student të regjistruar për vitin akademik 2024–2025, si dhe të dhënat jo inkurajuese për diplomimet në vitet e mëparshme, tregojnë për një problematikë të vazhdueshme. Nuk është e qartë në çfarë mase NJSBC-ja dhe njësia bazë kanë kryer analiza të thelluara apo kanë ndërmarrë masa konkrete për adresimin e kësaj çështje. Kjo situatë thekson domosdoshmërinë për një vlerësim më të plotë të atraktivitetit të programit, rishikimin e tij apo forcimin e strategjive të promovimit dhe orientimit të studentëve drejt këtij cikli studimi. Në këtë kontekst, mund të ishte e vlefshme që NJSBC-ja, veçanërisht në nivel fakulteti, në bashkëpunim me njësinë bazë, të ndërmerrnin një

	vlerësim specifik me 14 studentët e parë të regjistruar në vitin akademik 2021–2022, prej të cilëve në vitin e parë të studimit nuk u diplomua asnjë. Një analizë e tillë do të ndihmonte në identifikimin e faktorëve që kanë ndikuar në përfundimin jo të suksesshëm të studimeve dhe arritjen e objektivave formuese, si dhe do të shërbente si bazë për planifikimin e masave përmirësuese dhe përshtatjen e mëtejshme të programit me nevojat reale të studentëve dhe tregut të punës. Departamenti i GK ka realizuar një analizë SWOT për të vlerësuar objektivat formues të programit të studimit, por nuk ka identifikuar dobësitë që kërkojnë ndërhyrje strategjike për të adresuar çështjet reale që lidhen me këtë program. <i>E.6.1. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT</i> <i>E.5.1. Analiza e departamentit për objektivat formues të programit të studimit</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	GVJ vëren se institucioni ka një paketë të konsoliduar instrumentesh për vlerësimin e cilësisë. Ndërkohë që këto instrumente mund të kenë shërbyer për nxitjen dhe motivimin për arritje më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik, duhet të evidentohet më qartë se si ka ndikuar te studentët. Numrit të ulët të diplomuarve që i shtohet dhe mungesa e analizave dhe raporteve vlerësuese nuk adreson saktësisht se si është realizuar ky kriter. Gjithashtu, edhe në Raportin e Brendshëm të Vetvlerësimit të dorëzuar për akreditimin e programit, raportin e analizës vjetore të Departamentit nuk paraqiten të dhëna të qarta dhe të sakta që lidhen me adresimin e mangësive dhe problematikat aktuale të programit të studimit. <i>E.6.1. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT</i> <i>E.1.7. Raport i analizës vjetore të Departamentit</i> <i>E.6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i>
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarevajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, vlerësimin e didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Në kuadër të strukturave të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, janë ndërtuar mekanizma për vlerësimin periodik të cilësisë së mësimdhënies dhe të të nxënit. Këto përfshijnë: - Vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies nga studentët, përmes pyetësorëve të standardizuar të shpërndarë në fund të çdo semestri; - Vlerësimin e didaktikës dhe kurrikulës nga strukturat përgjegjëse (njësitë bazë dhe departamentet), në përputhje me Rregulloren e Brendshme për Sigurimin e Cilësisë; - Vëzhgime në auditor nga anëtarë të stafit akademik apo nga përfaqësues të NJSBC-së për të analizuar aspektet metodologjike të mësimdhënies dhe angazhimit të studentëve;

	- Analizë e feedback-ut të alumnive dhe punëdhënësve, për të pasur një reflektim të jashtëm mbi cilësinë e përgatitjes profesionale të të diplomuarve. <i>E.6.1. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT</i> <i>E.6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i>			
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.	Në praktikën institucionale, vlerësimi i cilësisë së programit realizohet përmes: - Sondazheve periodike me studentët aktivë, të cilët vlerësojnë përmbajtjen, organizimin, metodat e mësimdhënies, dhe ngarkesën akademike të programit; - Intervistave strukturuara dhe pyetësorëve për alumnit, për të matur koherencën midis aftësive të përfuara gjatë studimeve dhe kërkesave reale të tregut të punës; - Konsultimeve me punëdhënësit dhe institucionet partnere, për të vlerësuar nëse programi akademik përgatit profesionalisht studentët dhe për të marrë sugjerime për përmirësim; - Feedback-ut nga stafi akademik, ndihmësakademik dhe administrativ, në lidhje me menaxhimin institucional, burimet, infrastrukturën, si dhe sfidat e zbatimit të programit; - Tryezave të rrumbullakëta dhe fokus grupeve, që zhvillohen në bashkëpunim me përfaqësues nga komuniteti akademik dhe sektori joakademik, për të marrë mendime mbi efektivitetin e programit. <i>E.5.1. Analiza e departamentit për objektivat formues të programit të studimit</i> <i>E.6.8. Agjenda e takimeve me bashkëpunëtorë vendas dhe të huaj</i> <i>E.6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i>			
Konkluzione	Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson se standardi përmbushet kryesisht. Njësitë e posaçme, ndërsa realizojnë vlerësime periodike për garantimin e përmbushjes së objektivave formuese dhe arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit, në përputhje me kërkesat e standardeve akademike dhe zhvillimet e tregut të punës, duhet të forcojnë bashkëpunimin me njësinë bazë për të identifikuar dhe adresuar në mënyrë konkrete problematikat lidhur me numrin e ulët të diplomuarve dhe arritjet e rezultateve të synuara.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjimnazit "Qemal Stafa", Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Në përmbushje të kriterit për përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm në sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë ka krijuar Njësine e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), e përbërë nga 10 anëtarë me profile të ndryshme profesionale. Në këtë njësi janë përfshirë 2 profesorë me titull akademik Prof. Dr., 3 me titull Prof. As. Dr., 1 doktor, 1 me Master Shkencor, një staf ndihmës administrativ si dhe 2 studentë të nivelit master. Departamenti i GK përfaqësohet me 1 anëtar. Proceset e rishikimit të programeve të studimit kanë përfshirë edhe aktorë të jashtëm. <i>E.6.4. Urdhër i Dekanit për krijimin e NJSBC-së në FHF</i> <i>E.6.8. Agjenda e takimeve me bashkëpunëtorë vendas dhe të huaj</i> <i>E.6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i> <i>E.1.11. Analizë e tregut të punës</i> <i>E.1.12. Studimi i tregut - Media in fokus</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e njësive të sigurimit të brendshëm të cilësisë, miratuar me Vendimin e Senatit Akademik nr. 14, datë 20.07.2022, në nenin 6 përcakton strukturën në tre nivele: njësitë bazë, njësine kryesore dhe atë institucionale. Nenet 7 dhe 8 sanksionojnë detyrat funksionale të këtyre strukturave, duke theksuar rëndësinë e monitorimit dhe vlerësimit të vazhdueshëm të cilësisë në procesin mësimor. <i>E.6.3. Paketa e Instrumenteve të Cilësisë në UT</i> https://unitir.edu.al/rregullore-per-organizimin-dhe-funksionimin-e-njesive-te-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-ne-universitetin-e-tiranes/
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësive bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Në nivel institucional, në Rektoratin e Universitetit të Tiranës funksionon Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSB), e përbërë nga 9 anëtarë: një staf akademik me kohë të plotë i propozuar nga secili prej fakulteteve, një ekspert i jashtëm i caktuar nga Rektori, si dhe një student i përzgjedhur nga Këshilli i Studentëve. Kjo përbërje siguron një përfaqësim të balancuar të interesave akademike, studentore dhe ekspertizës së jashtme në procesin e monitorimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit. https://unitir.edu.al/rregullore-per-organizimin-dhe-funksionimin-e-njesive-te-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-ne-universitetin-e-tiranes/
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset	Institucioni ka përcaktuar qartë në aktet e tij të brendshme se përfshirja e aktorëve të brendshëm përfshirë personelin

ciklike të vlerësimit duhet të respektojnë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	akademik, ndihmësakademik dhe studentët në proceset ciklike të vlerësimit, të realizohet në mënyrë transparente, të paanshme dhe të dokumentuar. <i>E.1.1. Statuti i UT-së</i> <i>E.6.1. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT</i>			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Përmbushja e Kriterit 5 tregohet në angazhimin e Universitetit të Tiranës për përfshirjen aktive të ekspertëve të jashtëm në sigurimin e brendshëm të cilësisë. Në Njësinë Institucionale të Sigurimit të Cilësisë është i përfshirë një ekspert i jashtëm, i emëruar nga Rektori, që sjell një perspektivë të pavarur dhe ndihmon në përmirësimin e cilësisë akademike. Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit ka realizuar një rishikim të thelluar dhe modernizim të programit mësimor, në bashkëpunim me partnerë ndërkombëtarë si Leicester Media School (University of De Montfort). Ky proces përfshiu analiza të sfidave dhe kërkesave të tregut të punës, si dhe konsultime me grupe interesi, duke rezultuar në një kurrikulë të përditësuar dhe të përshtatur me standardet ndërkombëtare dhe nevojat lokale. <i>E.5.1. Analiza e departamentit për objektivat formues të programit të studimit</i> <i>E.6.8. Agjenda e takimeve me bashkëpunëtorë vendas dhe të huaj</i> https://unitir.edu.al/rregullore-per-organizimin-dhe-funksionimin-e-njesive-te-sigurimit-te-brendshem-te-cilesise-ne-universitetin-e-tiranes/			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se Universiteti i Tiranës përfshin në mënyrë të strukturuar dhe funksionale njësitë akademike, personelin akademik dhe studentët në proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë, ekspertë të jashtëm si në nivel institucional ashtu edhe në nivelin e programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi VI.5 Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Rregullorja për Sigurimin e Cilësisë parashikon detyrimin për transparencë në veprimtarinë e Njërive të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Informacionet lidhur me përbërjen, detyrat, aktivitetet monitoruese dhe masat e ndërmarra për përmirësim bëhen të njohura nëpërmjet takimeve informuese me aktorët e brendshëm, përdorimit të platformave elektronike dhe përmes

	përfaqësimit të studentëve në strukturat përkatëse, duke siguruar përfshirje dhe akses të gjerë në procesin e sigurimit të cilësisë. <i>E.6.1. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Institucioni i jep prioritet menaxhimit të kujdesshëm të të dhënave konfidenciale që rrjedhin nga proceset e monitorimit dhe vlerësimit të programeve të studimit. Të dhënat e mbledhura përmes anketimeve dhe mekanizmeve të tjerë të sigurimit të brendshëm të cilësisë trajtohen në mënyrë konfidenciale dhe administrohen brenda një strukture të qartë hierarkike vendimmarrjeje, ku përfshihen autoritetet më të larta institucionale, si Rektori, Administratori dhe dekanët e fakulteteve përkatëse. <i>E.1.1. Statuti i UT-së</i> <i>E.6.1. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Universiteti i Tiranës raporton se aplikon një proces të integruar ku rezultatet e vlerësimeve të programeve të studimit shoqërohen me plane konkrete veprimi, të cilat synojnë adresimin e dobësive dhe mangësive të identifikuara. Analiza e detajuar e Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit dhe plani i masave për përmirësim tregojnë qartë angazhimin institucional për të adresuar dobësitë dhe për të rritur cilësinë e programit. <i>E.1.2. Strategjia e zhvillimit të UT-së (2023-2028)</i> <i>E.1.4. Plani i Zhvillimit të Departamentit të Gazetarisë 2024-2029</i>
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	UT ka vendosur mekanizma të qëndrueshëm dhe të sistematizuar për të vlerësuar efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë në programet e studimit. Përmes analizave periodike dhe raporteve të detajuara, institucioni identifikon se në ç'mënyrë rezultatet e këtyre veprimtarive kontribuojnë në përmirësimin konkret të përmbajtjes, metodologjisë dhe organizimit të mësimdhënies. Ky proces përfshin rikthimin e informacionit tek njësitë përgjegjëse dhe aktorët kyç, si dhe përshtatjen e planifikimeve dhe politikave të cilësisë. <i>E.6.1. Rregullore për Sigurimin e Cilësisë në UT</i>
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	UT organizon në mënyrë të rregullt veprimtari dhe takime informative me pjesëmarrjen aktive të personelit akademik, ndihmësakademik dhe studentëve, me qëllim ndërgjegjësimin dhe përfshirjen e tyre në proceset e sigurimit dhe përmirësimit afatgjatë të cilësisë së programeve të studimit. Këto veprimtari përfshijnë seminare, trajnime, prezantime të rezultateve të vlerësimeve dhe konsultime të hapura, duke siguruar kështu një

	dialog konstruktiv dhe transparent midis të gjitha palëve të përfshira. <i>E.6.7. NJSBC dhe Karriera – Raporti vjetor 2023-2024</i> <i>E.3.9. Listë trajnimesh prej Zyrës së Këshillimit të Karrierës</i>			
Konkluzione	<i>Duke u bazuar në informacionin e ofruar dhe në vëzhgimet e kryera gjatë vizitës në institucion, GVJ konkludon se standardi konsiderohet i përmbushur në mënyrë të plotë. Universiteti i Tiranës ka zhvilluar politika, procese dhe veprimtari të strukturuar për sigurimin e brendshëm të cilësisë së programeve të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Gazetari Investigative” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universitetit i Tiranës”

Pika të forta:

- **Program unik në nivel kombëtar**
Masteri Profesional në “Gazetari Investigative” është programi i parë i këtij lloji në Shqipëri që ofron një formim të specializuar në gazetarinë investigative në nivel të dytë universitar. Kjo e bën atë një profil të veçantë dhe pionier në përgatitjen e profesionistëve të kësaj fushe, duke e pozicionuar programin si një standard referimi për zhvillimin e mëtejshëm të arsimit mediatik në vend.
- **Kontribut i drejtpërdrejtë në forcimin e demokracisë dhe transparencës**
Përmes formimit të gazetarëve të specializuar në investigimin e çështjeve publike, programi kontribuon në mënyrë të qenësishme në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe funksionimit të shtetit të së drejtës në Shqipëri. Ky rol i veçantë e shndërron programin në një aset me vlerë për interesin publik dhe zhvillimin demokratik të vendit.
- **Staf akademik me profil të lartë profesional dhe shkencor**
Programi mbështetet nga një trupë pedagogjike me kualifikime të avancuara akademike (gradë shkencore dhe tituj akademikë), si dhe me përvojë të gjatë në praktikën e gazetarisë dhe kërkimit në fushën e komunikimit. Kjo garanton cilësi të lartë në procesin e mësimdhënies dhe një ndërthurje efektive të teorisë me praktikën profesionale.
- **Angazhim i drejtpërdrejtë i profesionistëve të fushës**
Programi pasurohet me pjesëmarrjen aktive të gazetarëve profesionistë nga mediat kryesore kombëtare, si dhe me ftuar të huaj dhe vendas me ekspertizë në fushat e drejtësisë, të drejtave të njeriut, investigimit dhe etikës mediatike. Kjo përfshirje krijon një mjedis të gjallë, praktik dhe të orientuar drejt realitetit të tregut.
- **Bashkëpunim institucional ndërkombëtar dhe reforma e kurrikulës**
Programi ka përfutur nga eksperiencat ndërkombëtare nëpërmjet bashkëpunimeve me institucione të njohura si Leicester Media School (University of De Montfort), OSBE, USAID dhe Ambasada Britanike. Kjo ka ndikuar në përmirësimin e strukturës mësimore dhe përputhjen e saj me standardet akademike globale.
- **Kurrikulë e përditësuar dhe relevante**
Përmbajtja e kurrikulës është konceptuar për të reflektuar zhvillimet më të fundit në fushën e gazetarisë dhe komunikimit, me fokus të veçantë në teknikat e investigimit, etikën profesionale, gazetarinë digjitale dhe zhvillimet mediatike bashkëkohore. Programi ofron module që i përgjigjen nevojave të tregut dhe dinamizmit të profesionit.
- **Infrastrukturë dhe logjistikë moderne për mësimdhënie cilësore**
Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë siguron kushte optimale për zhvillimin e procesit mësimor, përfshirë ambiente të përshtatshme, mjete audio-vizuale, qasje në laboratorë të pajisur dhe teknologji të nevojshme për simulim praktik dhe trajnime profesionale.
- **Perspektiva të favorshme për punësim dhe karrierë**
Të diplomuarit nga ky program kanë akses të lartë në tregun e punës në media kombëtare dhe ndërkombëtare, në organizata të shoqërisë civile, institucione publike dhe struktura që kanë nevojë për aftësi të avancuara në investigim dhe raportim

profesional. Profili i specializuar rrit konkurrueshmërinë e tyre në sektorin mediatik dhe përtej.

Pika të dobta: (Shënim: Këto nuk përbëjnë mangësi thelbësore në funksionimin e programit, por janë aspekte të rëndësishme që duhet të adresohen për të rritur cilësinë dhe për të garantuar përputhjen me praktikën më të mirë në arsimin e lartë).

▪ **Standardi VI.3 – Kriteri 1 dhe 2**

Situata me vetëm një student të regjistruar për vitin 2024–2025 dhe diplomime të pakta në vitet e mëparshme nuk është shoqëruar me analiza përkatëse nga NJSBC-ja. Rekomandohet realizimi i një vlerësimi retrospektiv për studentët e regjistruar në vitin 2021–2022 (14 në total), për të kuptuar shkaqet e mosdiplomimit dhe për të ndërmarrë masa të synuara për përmirësim. Mbetet e nevojshme që raportet/analizat e NJSBC-së të jenë të individualizuara veçanërisht për programet strategjike dhe me ndikim të madh social, si Gazetaria Investigative. Në thelb të këtij programi qëndron përkushtimi ndaj vlerave të gazetarisë etike, së vërtetës dhe shërbimit publik, të cilat janë themelore për funksionimin e një demokracie të shëndetshme dhe për mbrojtjen e interesit publik. Aktualisht, ky program studimi nuk duket se tërheq studentët në numër të mjaftueshëm, gjë që nënvizon nevojën për një qasje më të targetuar dhe përmirësuese të adresimit të mangësive dhe planin e masave konkrete nga NJSBC-ja në nivel fakulteti së pari, por edhe në nivel universiteti.

Rekomandime:

- Analizë e thelluar institucionale mbi krizën aktuale të programit, duke përfshirë identifikimin e faktorëve që lidhen me numrin shumë të ulët të regjistrimeve dhe diplomimeve dhe hartimin e një plani ndërhyrjeje të qartë dhe të dokumentuar.
- Realizimi i një vlerësimi retrospektiv me 14 studentët e regjistruar në vitin akademik 2021–2022, me qëllim analizimin e faktorëve që kanë ndikuar në mosdiplomim dhe përdorimin e gjetjeve për përmirësime të drejtuara.
- Rritja e transparencës dhe dokumentimi sistematik i kontributit të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në përmirësimin e programit, përfshirë analiza të ndikimit dhe masa konkrete për cilësinë akademike.
- NJSBC-ja duhet të shtrihet përtej funksionit raportues, duke u angazhuar në mënyrë më aktive në monitorimin e zbatimit të rekomandimeve, si dhe nxitjen dhe koordinimin e aktiviteteve për zhvillimin e metodave inovative të mësimdhënies. Një angazhim i tillë do të siguronte që roli i NJSBC-së të jetë më i dukshëm, efektiv dhe i matshëm në përmirësimin e proceseve akademike dhe të cilësisë së përgjithshme institucionale.
- Përditësimi i literaturës bazë dhe ndihmëse, duke përfshirë botime dhe tekste shkencore të viteve të fundit, në përputhje me zhvillimet në fushën e gazetarisë investigative dhe standardet ndërkombëtare.
- Dokumentimi i procedurës së miratimit të materialeve mësimore, përfshirë ciklet e leksioneve të përdorura nga stafi akademik, për të garantuar përputhshmëri me rregulloret dhe kontrollin e cilësisë.

- Formalizimi i ndarjes së grupeve lëndore dhe përforcimi i funksionit të tyre për zhvillimin e moduleve dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies.
- Dokumentimi dhe publikimi i rezultateve të vlerësimeve të brendshme, për të forcuar transparencën, llogaridhënien dhe aksesin e barabartë të aktorëve të interesuar (studentë, staf, partnerë institucionalë).
- Zgjerimi i bashkëpunimeve ndërinstitucionale, përtej AMA, me organizata ndërkombëtare, agjenci kërkimore dhe organizata joqeveritare që operojnë në fushën e medias dhe gazetarisë investigative.
- Rritja e promovimit të programit përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit, aktiviteteve orientuese për maturantët dhe bashkëpunimeve me mediat për të rritur interesin dhe aplikimet.
- Përmirësimi i efikasitetit në përdorimin e burimeve njerëzore dhe financiare, duke vlerësuar qëndrueshmërinë e programit në raport me raportin staf/student dhe kostot aktuale të operimit.
- Harmonizimi i analizës SWOT me standardet ndërkombëtare, duke ndarë qartë dobësitë e brendshme nga kërcënimet e jashtme, në mënyrë që analiza të shërbejë si mjet i vërtetë për planifikim strategjik.
- Dokumentimi dhe arkivimi i plotë i dosjes së programit në gjuhën angleze, në përputhje me standardet e kërkuara.

Conclusions of the Evaluation of the Bachelor's Study Program in "Journalism and Communication" Offered by the Higher Education Institution "University of Tirana"

Strengths:

- **A unique program at the national level**
The Professional Master's program in Investigative Journalism is the first of its kind in Albania to offer specialized education in investigative journalism at the second cycle of university studies. This makes it a distinctive and pioneering profile in the training of professionals in the field, positioning the program as a reference standard for the further development of media education in the country.
- **Direct contribution to strengthening democracy and transparency**
Through the specialized training of journalists in investigating public affairs, the program significantly contributes to enhancing transparency, accountability, and the functioning of the rule of law in Albania. This specific role transforms the program into a valuable asset for the public interest and the democratic development of the country.
- **Highly qualified academic staff with professional and scientific credentials**
The program is supported by a teaching staff with advanced academic qualifications (scientific degrees and academic titles), as well as long-standing experience in journalism practice and research in communication. This ensures high-quality teaching and an effective blend of theory and professional practice.
- **Active engagement of field professionals**
The program is enriched by the active participation of professional journalists from leading national media, as well as guest lecturers, both local and international, who bring expertise in areas such as law, human rights, investigative techniques, and media

ethics. This inclusion fosters a dynamic, practical learning environment oriented toward market realities.

- **International institutional cooperation and curriculum reform**

The program has benefited from international experiences through partnerships with well-known institutions such as Leicester Media School (University of De Montfort), OSCE, USAID, and the British Embassy. These collaborations have contributed to the improvement of the curriculum structure and its alignment with global academic standards.

- **Updated and relevant curriculum**

The program content is designed to reflect the latest developments in journalism and communication, with special emphasis on investigative techniques, professional ethics, digital journalism, and contemporary media trends. It offers modules that respond to market needs and the dynamic nature of the profession.

- **Modern infrastructure and logistics for quality teaching**

The Faculty of History and Philology provides optimal conditions for the teaching process, including appropriate facilities, audiovisual equipment, access to equipped labs, and technologies necessary for practical simulations and professional training.

- **Favorable employment and career prospects**

Graduates from this program have high employability in national and international media, civil society organizations, public institutions, and other structures that require advanced skills in investigative reporting and professional communication. The specialized profile increases their competitiveness within and beyond the media sector.

Weaknesses: (Note: *These do not constitute fundamental shortcomings in the functioning of the program, but they are important aspects that should be addressed to enhance quality and ensure alignment with best practices in higher education*).

- **Standard VI.3 – Criteria 1 and 2**

The situation, with only one student enrolled for the 2024–2025 academic year and a few graduates in previous years, has not been accompanied by relevant analyses from the Internal Quality Assurance Unit (NJSBC). It is recommended to carry out a retrospective evaluation for students enrolled in 2021–2022 (14 in total) to understand the reasons for non-graduation and to implement targeted measures for improvement. It remains necessary that NJSBC reports/analyses are individualized, particularly for strategic programs with significant social impact, such as Investigative Journalism. At the core of this program lies a commitment to the values of ethical journalism, truth, and public service, which are fundamental for the functioning of a healthy democracy and the protection of the public interest. Currently, this study program does not appear to attract a sufficient number of students, highlighting the need for a more targeted and improvement-oriented approach in addressing deficiencies and implementing concrete action plans by NJSBC, first at the faculty level and also at the university level.

Recommendations:

- Conduct an in-depth institutional analysis of the current crisis of the program, identifying factors contributing to very low enrollment and graduation rates, and develop a clear and documented intervention plan.
- Implement a retrospective evaluation of the 14 students enrolled in the academic year 2021–2022, to analyze the reasons for non-completion and use the findings for targeted improvements.
- Increase transparency and systematic documentation of the Internal Quality Assurance Unit's (IQAU) contribution to program improvement, including impact analysis and concrete quality enhancement measures.
- The Internal Quality Assurance Unit (IQAU) should extend beyond its reporting function by engaging more actively in monitoring the implementation of recommendations, as well as in promoting and coordinating activities for the development of innovative teaching methods. Such an engagement would ensure that the role of the NJSBC becomes more visible, effective, and measurable in improving academic processes and the overall institutional quality.
- Update the core and supplementary literature, incorporating recent scientific publications aligned with developments in investigative journalism and international standards.
- Ensure the documentation of the approval process for teaching materials, including lecture cycles used by academic staff, to guarantee compliance with regulations and quality assurance.
- Formalize the distribution of academic course groups and strengthen their role in curriculum development and improving teaching quality.
- Document and publish internal evaluation results to strengthen transparency, accountability, and equal access for all stakeholders (students, staff, institutional partners).
- Expand institutional collaborations beyond AMA, engaging with international organizations, research agencies, and NGOs operating in the fields of media and investigative journalism.
- Increase program promotion through various communication channels, orientation activities for high school graduates, and collaborations with the media to boost interest and enrollment.
- Improve the efficiency in using human and financial resources by evaluating the sustainability of the program about the staff/student ratio and current operational costs.
- Align the SWOT analysis with international standards, clearly distinguishing internal weaknesses from external threats, so that the analysis serves as a genuine tool for strategic planning.
- Ensure the complete documentation and archiving of the English version of the program file, by standards of transparency and international partnership.




Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X